



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në subjektin “Prefektura e Qarkut Vlorë”

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT
(Auditim Përputhshmërie)

Tiranë, Shtator 2024

Përmbajtja

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
I.1.Konkluzionidhe Opinioni i Auditimit.....	7
II. HYRJA	9
OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA.....	9
b. Identifikimi i çështjes.....	9
c. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....	10
d. Përgjegjësitë e audituesve.....	10
e. Kriteret e vlerësimit.....	11
f. Standardet e auditimit.....	12
g. Metodat e auditimit.....	12
h. Dokumentimi i auditimit.....	13
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.....	14
1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin “Prefektura e Qarkut Vlorë”.....	14
2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	15
2.1. Auditim mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit të vitit 2022-2023.	15
2.2 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, për periudhën 01.01.2022-31.12.2023.	29
2.3 Auditim mbi verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhërësive me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore.....	36
IV. GJETJE DHE REKOMANDIME.....	63
V. ANEKSET.....	70

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

a. Përshkrim i shkurtër i institucionit dhe një informacion mbi buxhetin:

Prefektura Qarkut Vlorë, është një institucion qendrorë në nivel vendor i cili funksionon në zbatim të ligjit nr. 107/2016 “Për prefektin e qarkut” dhe akteve ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e administratës shtetërore dhe nëpunësve civil. Misioni i prefektit është përmbushja e detyrimeve për të garantuar zbatimin e programit politik të Këshillit të Ministrave në nivel qarku. Prefekti për veprimtarinë e vet përgjigjet përpara Këshillit të Ministrave, Kryeministrit dhe Ministrave.

Nëpunës autorizues për periudhën e auditimit (2021-2023) është z. F.M deri në Mars 2024 e në vijim z. V. T, ndërsa nëpunës zbatues për të gjithë periudhën e auditimit është znj. L. S.

Projekt raporti i Auditimit është i strukturuar në pesë kapituj: përmbledhja ekzekutive; hyrja, me çështjet e objektivave dhe qëllimi i auditimit, përgjegjësitë e strukturave drejtuese dhe të Audituesve, kriteret, identifikimi i çështjeve etj.; përshkrimi i auditimit, në të cilin paraprin një informacion i përgjithshëm mbi subjektin e audituar dhe vazhdon me trajtimin e rezultateve të auditimit për secilin prej 3 drejtimeve të auditimit; në kapitullin e katërt jepen gjetjet dhe rekomandimet dhe në fund janë anekset.

b. Rëndësia e institucionit dhe e auditimit të tij.

Rëndësia e auditimit të përputhshmërisë të Prefektit të Qarkut Vlorë për periudhën e aktivitetit 2022 - 2023, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor, konsiston dhe në kontrollin e përdorimit sa më efektiv e transparent të fondeve të akorduara, të burimeve në përdorim të këtij institucioni, si dhe verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore dhe të ndihmojë nëpërmjet rekomandimeve të dhëna për përmasimin e sistemeve.

Pra prefekturat janë subjekt i auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien dhe administratës publike.

c. Qëllimi i auditimit ku përcaktohet dhe periudha nën auditim, paraqitja e objektivave të cilat janë të njëjta me drejtimit e auditimit të tij:

Qëllimi është dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, lidhur me përdorimin e fondeve publike dhe verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore.

Prefektura e Qarkut Vlorë funksionon në bazë ligjit nr. 107/2016 datë 27.11.2016 “Për Prefektin”; Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe Ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore”, akteve ligjore/nënligjore dhe rregullores së brendshme.

Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- *Auditim mbi planifikimin dhe zbatimin e buxhetit.*
- *Auditim mbi zbatimin e procedurave të prokurimit periudha 2022 – 2023*
- *Auditim mbi verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore, viti 2022 – 2023.*

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Është përdorur metoda me auditim të njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u

fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetit. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

Në dhënien e opinionit kemi marrë parasysh nivelin e materialitetit i cili është llogaritur mbi zërin e shpenzimeve.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimi si: Kontrolli aritmetik. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese, Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese, kontrolli i vlerësimit, konfirmim nga të tretët. Kontrolli sipas një treguesi, Verifikimi i transaksioneve Intervistimi, Raporte dhe informacione, Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

e. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve.

Nga shqyrtimi i evidencave rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 13 gjetje dhe ka dhënë 13 rekomandime.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore.

Gjetjet më të rëndësishme shpjegohen shkurtimisht sipas drejtimeve më poshtë:

-Institucioni i Prefektit të Qarkut Vlorë nuk ka identifikuar dhe hartuar një strategji për menaxhimin e riskut, nuk ka hartuar rregjistër risku për gjithë sektorët (vetëm sektori i financës dhe shërbimeve të brendshme), dhe nuk ka regjistër përmbledhës të riskut. Kjo mangësi ka sjellë mungesën e vlerësimit si duhet dhe raportimit të riskut, për rrjedhojë dhe mangësi të aktiviteteve të kontrollit për minimizimin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave të sektorëve, zyrave.

-Institucioni i Prefektit të Qarkut Vlorë, për veprimtarinë e Emergjencave dhe Mbrojtjes Civile nuk ka hartuar për vitin 2022 dhe vitin 2023 raport mbi bashkërendimin dhe bashkëpunimin e veprimtarisë me degët territoriale që veprojnë në qark, raport të cilin duhet t'ia paraqiste ministrisë përgjegjëse dhe kryeministrisë pra Komitetit të Mbrojtjes Civile. Mungojnë gjithashtu raportet periodike të cilat duhet të paraqiteshin në institucionet raportuese dhe Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile.

-Nga auditimi i dokumentacionit të procedurave të blerjeve me vlera të vogla konstatohet se: Nga titullari i Autoritetit Kontraktor nuk është caktuar person përgjegjës për prokurimet i cili administron në mënyrë të vazhdueshme procesin dhe procedurat e prokurimit që kryhen nga institucioni i Prefektit të Qarkut Vlorë, në cilësinë e personit përgjegjës për menaxhimin e fondeve.

-Rezulton se në 6 procedura prokurimi për periudhën 01.01.2022-31.12.2022 dhe në 14 procedura për periudhën 01.01.2023-31.12.2023, është caktuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, Prefekti i Qarkut Vlorë, zj. L. S si Kryetare e komisionit të procedurave blerje me vlerë të vogël, e cila është me pozicion pune Përgjegjëse e Sektorit të Financës në cilësinë e nëpunësit zbatues. Zj. S. kryen kontrollet pas faktit bazuar në dokumentacionin mbështetës për kryerjen e një transaksioni financiar. Pra veprimtaria e kontrollit pas faktit nuk duhet të kryhet nga persona të cilët kanë marrë pjesë në kontrollet para faktit, e cila është njëkohësisht dhe anëtar dhe sekretar i Grupit të Menaxhimit Strategjik të institucionit. Çdo urdhër i titullarit për caktimin në komisione të nëpunësit zbatues i cili bie ndesh me veprimtarinë, duhet të refuzohet nga ky i fundit, gjë e cila nuk rezulton të jetë kundërshtuar në asnjë rast.

-Për periudhën 2022-2023 nga bashkitë dhe Këshilli i Qarkut Vlorë i janë përcjellë Prefektit një total prej 793 vendime, për të cilat rezulton se 778 janë konfirmuar si në përputhje me kuadrin rregullator, kur nga të cilat rezulton se:

Nga 93 vendime të audituara, nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Vlorë, është dhënë vlerësim pozitiv për ligjshmërinë e vendimeve edhe në rastet kur këta të fundit:

a) -Në 60 raste, Vendimet e Këshillit Bashkiak (të konfirmuara), kanë bashkëlidhur projekt-vendimin si dhe relacionin përkatës por nuk dokumentohet që të jenë shoqëruar me procesverbalin e mbledhjes.

b) -Në 28 raste, Vendimet e Këshillit Bashkiak (të konfirmuara), rezulton se janë vendime me karakter individual dhe jo normativ, duke vlerësuar dhe dhënë vlerësim pozitiv për ligjshmërinë e tyre, në mungesë të kompetencës.

c) -Në 9 raste, Vendimet e Këshillit Bashkiak (të konfirmuara), përveçse Prefekti, në disa raste, ka konfirmuar ligjshmërinë e tyre në mungesë të kompetencës, e ka kryer atë edhe pse vendimet rezultojnë në kundërshtim me nenin 91 të Kodit Zgjedhor;

ç) -Në 3 raste, Vendimet e Këshillit Bashkiak (të konfirmuara), janë në kundërshtim me ligjin material.

-Nga auditimi është konstatuar se, pranë institucionit të Prefektit të Qarkut Vlorë nuk ka një regjistër shkresor apo elektronik në të cilin të pasqyrohet në mënyrë të detajuar periodike apo të pëgjithshme aktiviteti i Prefektit në funksion të verifikimit të ligjshmërisë së akteve.

-Nga auditimi mbi verifikimin e ligjshmërisë së akteve me karakter normativ drejtpërdrejt dhe sistematikisht në organin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, në zbatim të nenit 17 të ligjit nr. 107/2016, “Për Prefektin e Qarkut”, për vitet 2022-2023 është konstatuar se:

-Grupi i punës nuk ka dokumentuar kryerjen e verifikimit mbi dokumentacionet shoqëruese që duhet të përmbajnë vendimet e këshillit të cilat depozitohen pranë Prefektit të Qarkut, siç janë: procesverbalet e dëgjësive publike, në ato raste kur kërkohet nga ligji; relacionet përkatëse që shpjegojnë respektimin e procedurave ligjore; pasqyrat përkatëse (në rastin e vendimmarrjes me karakter financiar) etj.

-Në përfundim të procedurës së kryerjes së verifikimit në vend të akteve, prefekti i qarkut nuk ka dërguar konkluzionet së bashku me rekomandimet përkatëse pranë NJVV-së objekt verifikimi.

h. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:

-Prefekti i Qarkut Vlorë, të marrë masat e duhura që, të hartojë dhe miratojë regjistrin e riskut me përgjegjësi për çdo sektor dhe në rang Institucioni dhe të kryhet raportimi hierarkik për funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të sistemit të kontrollit të brendshëm institucional.

-Prefekti i Qarkut Vlorë, Sektori i Emergjencave dhe Mbrojtjes Civile, të marrë masat e duhura që, të hartojë raportet periodikë dhe vjetor dhe ti dërgojë pranë institucioneve raportuese me qëllim bashkërendimin dhe rritjen e efektivitetit në funksion të misionit dhe përmbushjes së detyrave Institucionale.

-Institucioni i Prefektit të Qarkut Vlorë, të marrë masat e duhura që:

a- Të caktojë personin përgjegjës për prokurimet me qëllim përmirësimin në planifikimin e nevojave, rritjen e efikasitetit dhe efikasitetit në procedurat e prokurimit publik.

b- Të krijojë komisionet e blerjeve me vlera të vogla me anëtarë të cilët nuk kryejnë kontrole pas faktit dhe ekzekutimin e shpenzimeve duke bërë një ndarje të qartë të detyrave respektive, në përputhje me kuadrin ligjor të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

-Institucioni i Prefektit të Qarkut Vlorë, Sektori i Prokurimeve të marrë masat e duhura, në hartimin e regjistrave të prokurimit dhe të analizojnë dhe grupojnë emërtimin e procedurave, me qëllim shmangien e copëzimit të fondeve.

-Prefekti i Qarkut Vlorë, në të ardhmen, të japë vlerësim pozitiv për ligjshmërinë e vendimeve të dërguara nga Këshillat Bashkiakë vetëm pasi të sigurojë dhe konkludojë se këta të fundit:

a) -Janë të shoqëruar me: Procesverbalin e mbledhjes së këshillit; Procesverbalin e dëgjësës publike, në ato raste kur kërkohet nga ligji; Relacioni përkatës që shpjegon respektimin e procedurës ligjore; Projektvendim; Çertifikatën e pronësisë në mungesë të saj statusin juridik nga ASHK-ja (në vendimmarrjet e pronave), plan vendosjet, etj.

b) - Janë akte me karakter normativ dhe jo individual, në përputhje me nenin 3 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”.

c) - Referuar periudhës së marrjes (vendimmarrjes) së tyre, nuk janë në kundërshtim me nenin 91 të Kodit Zgjedhor.

ç) - Duke i vlerësuar, rast pas rasti, nuk janë në kundërshtim me ligjin material, në mospërputhje me nenin 109 “Paligjshmëria e aktit administrativ” të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”.

- Prefekti i Qarkut Vlorë, të krijojë një regjistër shkresor apo elektronik në të cilin të pasqyrohet në mënyrë të detajuar periodike apo të pëgjithshme aktiviteti i Prefektit në funksion të verifikimit të ligjshmërisë së akteve. Regjistri duhet të ketë në përbërjen e tij të gjithë elementët bazë me anë të të cilëve të sigurohet dokumentimi i të gjitha veprimtarive dhe gjurma e duhur e auditimit për vijueshmërinë dhe monitorimin.

I.1.Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit.

OPINIONI I AUDITIMIT

Për auditimin e përputhshmërisë ¹:

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së subjektit “Prefektura Qarkut Vlorë” për periudhën 01.01.2022 deri më 31.12.2023, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë nga subjekti të ligjeve, vendimeve rregullave dhe rregulloreve, udhëzimeve politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord, nëpërmjet: a) auditimit të sistemeve financiare dhe transaksioneve, duke përfshirë edhe vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret; b) auditimit të integritetit dhe përputhshmërisë së vendimeve administrative të marra nga subjekti i audituar, c) raportimin e të gjitha çështjeve të tjera që dalin nga apo që lidhen me auditimin, të cilat Kontrolli i Lartë i Shtetit i konsideron të rëndësishme për t’u bërë publike.

Opinion:

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e kërkuar dhe të vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e subjektit Prefektura e Qarkut Vlorë janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit të kualifikuar, e shprehur kjo në bazën për opinion.

Baza për opinionin e kualifikuar:

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit, mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë të ushtruar nga subjekti i audituar. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, duke marrë në konsideratë vlerësimin e riskut dhe materialitetit për subjektin e audituar. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për dhënien e opinionit të modifikuar/kualifikuar të përputhshmërisë. Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë dhe vlerën e materialitetit prej 1.185 mijë lekë, llogaritur mbi shpenzimet faktike të vitit 2023, si dhe anomalitë e mëposhtme:
-Nuk ka identifikuar dhe hartuar një strategji për menaxhimin e riskut, nuk ka hartuar regjistër risku për gjithë sektorët (vetëm sektori i financës dhe shërbimeve të brendshme), dhe nuk ka regjistër përmbledhës të riskut. Kjo mangësi ka sjellë mungesën e vlerësimit si duhet dhe raportimit të riskut, për rrjedhojë dhe mangësi të aktiviteteve të kontrollit për minimizimin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave të sektorëve, zyrave.

-Për veprimtarinë e Emergjencave dhe Mbrojtjes Civile nuk ka hartuar për vitin 2022 dhe vitin 2023 raport mbi bashkërendimin dhe bashkëpunimin e veprimtarisë me degët territoriale që veprojnë në qark, raport të cilin duhet t’ia paraqiste ministrisë përgjegjëse dhe kryeministrisë pra Komitetit të Mbrojtjes Civile. Mungojnë gjithashtu raportet periodike të cilat duhet të paraqiteshin në institucionet raportuese dhe Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile.

¹Sipas Manualit të Auditimit, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së, “Opinion i kualifikuar” jepet kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë, ose kur audituesi nuk është në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi llogaritë vjetore apo transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale por jo të përhapura.

-Në 6 procedura prokurimi për periudhën 01.01.2022-31.12.2022 dhe në 14 procedura për periudhën 01.01.2023-31.12.2023, është caktuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, Prefekti i Qarkut Vlorë, zj. L. S si Kryetare e komisionit të procedurave blerje me vlerë të vogël, e cila është me pozicion pune Përgjegjëse e Sektorit të Financës në cilësinë e nëpunësit zbatues. Zj. S. kryen kontrollet pas faktit bazuar në dokumentacionin mbështetës për kryerjen e një transaksioni financiar. Pra veprimtaria e kontrollit pas faktit nuk duhet të kryhet nga persona të cilët kanë marrë pjesë në kontrollet para faktit, e cila është njëkohësisht dhe anëtar dhe sekretar i Grupit të Menaxhimit Strategjik të institucionit. Çdo urdhër i titullarit për caktimin e në komisione të nëpunësit zbatues i cili bie ndesh me veprimtarinë, duhet të refuzohet nga ky i fundit, gjë e cila nuk rezulton të jetë kundërshtuar në asnjë rast.

-Në 3 procedura prokurimi rezulton të jenë shmangur zhvillimi i procedurave standard të prokurimit blerje me vlerë të vogël me shpallje në buletin e APP dhe nuk janë kryer nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimeve, duke copëzuar fondet dhe duke kryer me procedura blerje me vlera të vogla në mënyrë shpresore sipas modelit për shpenzimet deri në 100,000 lekë. Nga sa më sipër rezulton se të dhënat e regjistrimit të parashikimeve të miratuara nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, nuk janë siguruar në mënyrë të tillë që, të analizoheshin sipas nevojave të paraqitura, me qëllim shmangien e copëzimit të fondeve për grupmallrat/shërbimet e ngjajshme dhe kryerjen e tyre me procedura të rregullta konkurrese sipas kufijve monetarë.

-Në 14 (katërbëdhjetë) raste të audituara për procedurat e prokurimit të zhvilluara në vitet 2022-2023, nga Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël, në cilësinë e KVO-së nuk janë plotësuar deklaratat mbi konfliktin e interesave.

-Për periudhën 2022-2023 nga bashkitë dhe Këshilli i Qarkut Vlorë i janë përcjellë Prefektit një total prej 793 vendime, për të cilat rezulton se 778 janë konfirmuar si në përputhje me kuadrin rregullator, kur nga të cilat rezulton se:

Nga 93 vendime të audituara, nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Vlorë, është dhënë vlerësim pozitiv për ligjshmërinë e vendimeve edhe në rastet kur këta të fundit:

a) -Në 60 raste, Vendimet e Këshillit Bashkiak (të konfirmuara), kanë bashkëlidhur projekt-vendimin si dhe relacionin përkatës por nuk dokumentohet që të jenë shoqëruar me procesverbalin e mbledhjes.

b) -Në 28 raste, Vendimet e Këshillit Bashkiak (të konfirmuara), rezulton se janë vendime me karakter individual dhe jo normativ, duke vlerësuar dhe dhënë vlerësim pozitiv për ligjshmërinë e tyre, në mungesë të kompetencës.

c) -Në 9 raste Vendimet e Këshillit Bashkiak (të konfirmuara), përveçse Prefekti, në disa raste, ka konfirmuar ligjshmërinë e tyre në mungesë të kompetencës, e ka kryer atë edhe pse vendimet rezultojnë në kundërshtim me nenin 91 të Kodit Zgjedhor;

ç) -Në 3 raste, Vendimet e Këshillit Bashkiak (të konfirmuara), janë në kundërshtim me ligjin material.

-Nga auditimi është konstatuar se, pranë institucionit të Prefektit të Qarkut Vlorë nuk ka një regjistër shkresor apo elektronik në të cilin të pasqyrohet në mënyrë të detajuar periodike apo të pëgjithshme aktiviteti i Prefektit në funksion të verifikimit të ligjshmërisë së akteve.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr.154/14, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të projektit dhe programit të auditimit nr.564/2prot., datë 31.5.2024 “Mbi auditimin e përputhshmërie” (i ndryshuar), të miratuara nga Kryetari i KLSH, nga data 31.5.2024 deri më datën 26.7.2024, në subjektin Prefektura e Qarkut Vlorë për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2022 deri më datën 31.12.2023, u krye “Auditimi i Përputhshmërie” nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. K. T., Kryeauditues, Përgjegjës Grupi,
2. E. M., Auditues i Lartë,

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMIDHEMETODOLOGJIA.

a. Objektivat qëllimi i auditimit: Objekti i auditimit të përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve të aktivitetit të subjektit për periudhën e aktivitetit të audituar.

Qëllimi është të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi për fushat e veprimtarisë së subjektit të audituar, i cili do të realizohet vetëm pas analizës së implementimit të kërkesave të menaxhimit financiar dhe kontrollit, për të vlerësuar drejt nivelin e riskut në subjekt.

Në përfundim të auditimit, do hartohet Raporti Përfundimtar i auditimit, i cili përfshin dhënien e opinionit mbibazënevlerësimeve dhetëgjetjeve, sidhedhënienerekomandimevepër përmirësimin e veprimtarisë së Prefektit të Qarkut Vlorë.

b. Identifikimi i çështjes.

Të përcaktojë nivelin e duhur të materialitetit, duke i mundur kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t’i shërbej subjektit në marrjen e masave në përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.

Sipas përcaktimit të ISSAI 100 “Auditimi i përputhshmërisë, përcakton se deri në çmasë subjekti i audituar ndjek rregullat, legjislacionin dhe aktet normative, politikat, kodet e miratuara apo kushtet e përcaktuara si, kushtet e kontratës apo klauzolat e një marrëveshjeje financimi”, duke ofruar raporte të besueshme për fondet nëse janë administruar dhe të drejtat e qytetarëve për një proces të rregullt, nëse janë respektuar siç kërkohet nga kuadri ligjor, rregullator në fuqi.

Projekt raporti i auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të prefekturës dhe përgjegjësisë së saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Prefektit të Qarkut Vlorë.

Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara përsa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të

mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko-financiare të Prefektit të Qarkut Vlorë.

c. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.

Prefekti i Qarkut Vlorë (Administratori i Përgjithshëm), në cilësinë dhe të Nëpunësit Autorizues (NA) dhe Drejtori i Financës, në cilësisë e Nëpunësit Zbatues (NZ), janë përgjegjës për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësisve publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, si dhe shprehjen e ligjshmërive të vendimeve të këshillave bashkiak.

Prefekti nëpërmjet konfirmimit ose jo të vendimeve të Këshillave Bashkiak, me vendim të veçantë, miraton të ardhurat dhe fondet buxhetore vjetore fondet speciale të tyre, administrimin e pronave publike të bashkive, etj.

Strukturat drejtuese të subjekteve të audituara kanë përgjegjësi që t'i dorëzojnë dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionin e kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH.

d. Përgjegjësitë e audituesve.

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së subjektit "Prefektura Qarkut Vlorë" për periudhën 01.01.2022 deri më 31.12.2023, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë nga subjekti të ligjeve, vendimeve rregullave dhe rregulloreve, udhëzimeve politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord, nëpërmjet: a) auditimit të sistemeve financiare dhe transaksioneve, duke përfshirë edhe vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret; b) auditimit të integritetit dhe përputhshmërisë së vendimeve administrative të marra nga subjekti i audituar, c) raportimin e të gjitha çështjeve të tjera që dalin nga apo që lidhen me auditimin, të cilat Kontrolli i Lartë i Shtetit i konsideron të rëndësishme për t'u bërë publike.

Gjithashtu, janë zbatuar pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim, si përkatësia, plotësia, saktësia dhe vlerësimi, periudha, klasifikimi dhe kuptueshmëria, ligjshmëria dhe rregullsia, ekzistenca, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, vlerësimi dhe alokimi, transaksionet, të drejtat dhe detyrimet.

Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik, kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e Prefektit të Qarkut Vlorë është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH kanë aplikuar gjykimin dhe skepticizmin profesional gjatë veprimtarisë audituese.

Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Audituesit kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, paragrafi 44-51.

e. Kriteret e vlerësimit

Auditimi është bazuar në ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe në referenca të tjera ligjore sa më poshtë:

- Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar: Ligji nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021” dhe Ligji nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, si dhe aktet normative që ndryshojnë këto ligje; Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” i ndryshuar; Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” etj.; Udhëzimit i MF nr. 2, datë 02.06.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar; Udhëzimi MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar; Udhëzimi i MF nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” i ndryshuar; Udhëzimin MF nr. 1, datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit e vitit 2022”, pikat 95-122.

- Në fushën e prokurimeve publike: Ligji nr. 162/202, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe akteve të tjera nënligjore të prokurimit publik”, i ndryshuar; Udhëzim i Agjencisë Prokurimit Publik nr. 1, datë 01.2.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, i ndryshuar; Urdhri i MF nr. 33, datë 11.07.2013 “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”.

- Në fushën e vlerësimit të vlefshmërisë së akteve: Ligji nr. 107/2016 datë 27.10.2016 “Për Prefektin”, ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 8 pika 2, neni 9 pika 1.1/n, neni 54; ligji nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile” ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, etj.

- Në fushën e marrëdhënieve të punësimit dhe pagave: Ligji nr. 10296/2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar; Ligj Nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar; Ligji nr. 7961 /1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar; Urdhri nr. 50 datë 12.04.2017 të Kryeministrit “Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut”; VKM nr. 117/2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit” i ndryshuar; VKM nr. 707/2009 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore” i ndryshuar; Urdhri nr. 14, datë 12.01.2016 “Për miratimin e strukturës organizative të Prefektit të Qarkut Vlorë” dhe VKM për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Institucionit të Prefektit.

- Në fushën e emergjencave dhe Mbrojtjen Civile: Ligji nr. 45 datë 18.07.2019 “Për Mbrojtjen civile”; Ligji nr. 107 dt. 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”; VKM nr. 923 datë 25.11.2020 “Për funksionimin e organizimin e komitetit të mbrojtjes civile dhe bashkëpunimin ndërinstytucional të institucioneve dhe të strukturave të sistemit të mbrojtjes civile”; VKM nr. 345 datë 26.05.2022 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë”; VKM nr. 414 datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”; Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

f. Standardet e auditimit.

ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm”; ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë; ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200 “Udhëzime për auditimin e përputhshmërisë”; INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë” etj.; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së; Manuali i Auditimit të Brendshëm etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualet e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.; Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH.

g. Metodat e auditimit.

Është përdorur metoda me auditim të njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

*Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin*². Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerësojnë si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:

- *Kontrolli aritmetik*. Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)

- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese*. Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar.

² *ISSAI 1320 (ISA 320) trajtojnë përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korrigimit të anomalive. Një trajtim i tillë i ngjashëm mund të përdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.*

- *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.* Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.
 - *Kontrolli i vlerësimit.* Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.
 - *Konfirmim nga të tretët.* Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.
 - *Kontrolli sipas një treguesi.* Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsisve kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.
 - *Verifikimi i transaksioneve* – është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.
 - *Intervistimi* – është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.
 - *Raporte dhe informacione* – janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.
- Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm* – grupi i auditimit ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm të subjektit.

h. Dokumentimi i auditimit.

Është mbështetur në kërkesa të Manualeve të Auditimit të Përputhshmërisë, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 “*Dokumentimi i Auditimit*”, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirje në procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesa të zbatueshme ligjore dhe rregullatore.

Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përfundim të auditimit në terren, nga grupi i auditimit janë dorëzuar në zyrën e protokollit Prefektura Vlorë 3 akt konstatime nr. 395/5 prot, datë 25.7.2024, nr. 395/6 prot, datë 26.7.2024, nr. 395/7 prot, datë 26.7.2024, të mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara. Nga subjekti i audituar janë paraqitur kundërshtitë të cilat pasi u analizuan me kujdes dhe profesionalizim nga grupi i auditimit, duke marrë në konsideratë ato kundërshtitë të cilat kishin mbështetje ligjore dhe

me dokumentacion, u përgatit dhe u dërgua në subjekt Projektraporti i Auditimit me shkresën nr. 564/7 prot, datë 9.8.2024 për njohje dhe paraqitjen e kundërshtive rreth gjetjeve të tij. Në përfundim të afatit 30 ditor, nga subjekti audituar (Prefektura e Qarkut Vlorë), nuk janë paraqitur kundërshti (observacione) mbi Projekt Paportin e Auditimit, dhe në këto kushte nga grupi i auditimit, u përgatit ky Raport Përfundimtar Auditimi.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin “Prefektura e Qarkut Vlorë”.

Misioni i prefektit të qarkut është përmbushja e detyrimeve për të garantuar zbatimin e programit politik të Këshillit të Ministrave, në nivel qarku. Prefekti i Qarkut është përfaqësues i Këshillit të Ministrave, në nivel qarku.

Prefektura e Qarkut Vlorë funksionon në bazë ligjit nr. 107/2016 datë 27.11.2024 “për Prefektin”; ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore”, akteve ligjore/nënligjore dhe rregullores së brendshme.

Prefektura e Qarkut Vlorë:

- a) Kujdeset, ndjek dhe merr masa për plotësimin nga të gjitha institucionet në nivel qarku të detyrimeve që ata kanë për të garantuar sovranitetin, rendin kushtetues dhe shëndetin publik;
- b) Mbikëqyr, kontrollon dhe bashkërendon veprimtarinë e institucioneve qendrore në nivel vendor;
- c) Drejton veprimtarinë e strukturave administrative shtetërore, të cilat, me akte ligjore e nënligjore të veçanta, janë caktuar në varësinë e tij të drejtpërdrejtë;
- ç) Bashkërendon veprimtarinë e institucioneve qendrore në nivel vendor, si dhe të këtyre me organet e qeverisjes vendore në komuna, bashki e qark;
- d) Është i vetmi institucion administrativ që verifikon ligjshmërinë e akteve të miratuara nga organet e qeverisjes vendore në komuna, bashki e qark, në përputhje me dispozitat e kreut III të këtij ligji. Prefekti ushtron kontroll financiar mbi këto organe në mënyrën dhe limitet e përcaktuara me ligj.

• 1912-1924

Pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, Qeveria shqiptare bëri organizimin administrativ të sanksionuar në “Kanunin e Përtashëm të Administratës Civile të Shqipërisë” të shpallur më 22 nëntor 1913. Vendi u nda në prefektura dhe krahina. Prefekturat ishin tetë: Berati, Dibra, Durrësi, Gjirokastra, Elbasani. Korça Shkodra dhe Vlora.

• 1925-1945

Organizimi dhe funksionimi i Administratës vendore u përcaktua sipas Ligjit organik të Bashkisë, të miratuar më 1921 dhe më pas me Kodin Civil të miratuar gjatë vitit 1928. Nënprefektura ishte Njësia administrativo-territoriale, me funksione administrative. Prefektura ishte njësia më e madhe e Qeverisjes vendore e drejtuar nga Prefekti, i cili emërohej nga Ministri i Brendshëm dhe aprovohej nga Kryeministri dhe më pas nga Mbreti. Nënprefekti propozohej nga Prefekti.

Prefekti kishte funksione ekzekutive. Në Prefekturë e Nënprefekturë mungonin organet e zgjedhura. Këshilli Administrativ i Prefekturës përbëhej nga shefat e zyrave dhe nga disa (si rregull 2) anëtarë të zgjedhur nga populli për dy vjet.

Në vitin 1927 Shqipëria kishte 10 Prefektura, 39 Nënprefektura dhe 69 krahina me 2351 fshatra. Në vitin 1934 kishte 10 Prefektura, 30 Nënprefektura, 160 komuna, me 2351 fshatra. Në vitin 1940 kishte 10 Prefektura 30 Nënprefektura, 23 Bashki, 136 komuna dhe 2551 fshatra.

- **1945-1992**

Pas vitit 1945, u bënë shumë ndryshime në strukturën e ndarjes administrative. Në këtë periudhë kishte 10 Prefektura dhe 61 Nënprefektura. Në vitin 1946 u bë ndarja e re Administrative me 10 Prefektura, 39 Nënprefektura. Në vitin 1947 u suprimuan nënprefekturat dhe në vitin 1953 Qarku zëvendësoi Prefekturën.

- **Prefektët 1992 – ne vijim:**

Më pas në bazë të ligjit 7608, datë 22.09.1992 “Për Prefekturat” u krijuan 12 Prefektura si Njësi që drejtohen nga Këshilli i Ministrave.

- **Fushat e veprimtarisë së Institucionit të Prefektit të Qarkut:**

- + Marrëdhëniet e prefektit të qarkut me degët territoriale;
- + Verifikim i ligjshmërisë së akteve;
- + Verifikim i përgjegjësive të deleguara;
- + Shqyrtim i ankesave dhe zgjidhja e konflikteve;
- + Emergjencat Civile.

Prefektura e Qarkut të Vlorë është një nga 12 prefekturat në Shqipëri. Prefektura e Qarkut Vlorë përfshin bashkitë Vlorë, Himarë, Selenicë, Finiq, Sarandë, Delvinë dhe Konispol.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit

2.1. Auditim mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit të vitit 2022-2023.

1.1. Programimi realizimi i buxhetit vjetor;

1.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve normative. Auditimi i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura;

1.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit. Vlerësimi i risqeve buxhetore;

1.4. Burimi i krijimit të të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi, përdorimi i tyre;

1.5. Verifikim i masave të programit të emergjencave dhe mbrojtjes civile për masat e marra për fatkeqësitë natyrore si tërmetet, përmytjet, dëmtimet nga zjarri, vlerësimet e dëmeve nga fatkeqësitë e ndryshme për përmirësimin e cilësisë së jetës së njeriut duke promovuar përvojat më të përparuara dhe shërbime të sigurta dhe efikase.

Në zbatim të pikës 1 të programit të auditimit “Nr. 564/2 prot, datë 31.05.2024 u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- a) Dokumentacioni i hartimit të PBA-ve për periudhën objekt auditimi, urdhrat për krijimin e grupeve të punës për hartimin e buxhetit, miratimi i tyre dhe korrespondenca me Ministrinë e Linjës;
- b) Dokumentacioni i programimit të buxhetit vjetor për periudhën objekt auditimi, i miratuar, fondet e miratuara dhe detajimi i shpenzimeve, si dhe korrespondenca zyrtare për ndryshimet në buxhet gjatë kësaj periudhe buxhetore;

- c) Dokumentacioni mbi çeljen e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative;
- d) Shkresat përcjellëse në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për detyrimet e papaguara të institucionit ndaj të tretëve, si fatura të palikuiduara dhe vendimeve gjyqësore;
- e) Dokumentacioni mbi transferimin e fondeve buxhetore gjatë periudhës objekt auditimi, si dhe saktësia e pasqyrimit të ndryshimeve në shtesa dhe pakësim me planin përfundimtar.
- f) Dokumentet e hartuara në mënyrë periodike për monitorimin e zbatimit të buxhetit për periudhën objekt auditimi;
- g) Dokumentacioni mbi aktivitetin e Sektorit të Emergjencave dhe Mbrojtjes Civile, planet e marra dhe masat vjetore për fatkeqsitë e ndryshme natyrore si dhe bashkëpunimi me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, dokumentacion mbi evidencat e rasteve të ndodhura nga fatkeqsitë natyrore si dhe raportimet periodike në insitucionet raportuese.

Nga auditimi i dokumentacionit të sipërcituar, u konstatua si më poshtë vijon:

1.1. Programimi realizimi i buxhetit vjetor;

-Hartimi e dorëzimi i projekt buxhetit dhe realizimi i tij, kryhet sipas kërkesave të përcaktuara në ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.2, datë 6.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar me Udhëzimin nr.9, datë 20.07.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimit të Ministrit të Punëve të Brendshme nr.459, datë 16.08.2013 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit në sistemin e Ministrisë së Brendshme”. Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet e bëra gjatë vitit buxhetor janë të regjistruara dhe të rakorduar me Degën e Thesarit Vlorë. Ndjekja e zbatimi i buxhetit bëhet nëpërmjet evidencave të cilat plotësohen dhe raportohen periodikisht çdo muaj. Situacionet e zbatimit të buxhetit janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor.

Në auditimin për procedurat e hartimit të buxhetit për periudhën e audituar u konstatua se projekt buxheti i vitit 2023, është hartuar në zbatim të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RSH” i ndryshuar, udhëzimit standard të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm nr.7 datë 28.02.2018 dhe udhëzimit të MFE nr.9 datë 28.02.2022 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2023–2025 dhe 2024-2026”. Janë zbatuar afatet e caktuara për përgatitjen dhe raportimin e projekt buxheteve vjetore dhe afatmesme.

Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm, është ngritur grupi i punës sipas urdhrit të titullarit “Për ngritjen e grupeve të punës për përgatitjen e PBA”, përkatësisht menr.24 datë 01.08.2022, për vitin 2023 – 2025 dhe nr.38 datë 30.12.2022, për vitin 2024 – 2026, me përbërje nga nëpunës të Prefektit të Qarkut Vlorë, konkretisht zj. L. S kryetar, me detyrë përgjegjës i sektorit të financës dhe anëtarët z. D. H me detyrë Sekretar i Përgjithshëm, z. B. S. me detyrë specialist i IT, z. R. S. me detyrë përgjegjës i mbrojtjes civile, z. O. Z. me detyrë përgjegjës i sektoritjuridik, z. E. A. me detyrë përgjegjës i zhvillimit urban dhe zj. F. L. me detyrë përgjegjës i SMKVF. Nga ana e sektorëve të institucionit, në bashkëpunim me sektorin e financës, janë paraqitur kërkesat të argumentuara dhe të shoqëruara me relacion sqarues. Në hartimin e projekt buxhetit vjetor dhe afatmesëm, janë marrë në konsideratë kërkesat e dokumentuara, por për planifikimin e buxhetit vjetor afatmesëm 2024 - 2026, kryesisht janë marrë si bazë realizimet e llogarive buxhetore për vitin buxhetor paraardhës. Mbi bazën e dokumentacionit të grumbulluar, nëpunësi zbatues i institucionit, ka plotësuar të gjitha pasqyrat shoqëruese “Tip” të projekt buxhetit për programet që menaxhohen nga Prefekti Qarkut Vlorë.

Këto pasqyra financiare shoqëruese “Tip”, së bashku me relacionet sqaruese për zërat e shpenzimeve, janë konfirmuar nga drejtuesi i njësisë shpenzuese, (nëpunësi autorizues) dhe janë dërguar në MB, (drejtorisë së buxhet financës), me shkresën nr. 757 datë 11.08.2023, “Dërgohet parashikimi i PBA për vitet 2024 – 2026”.

1.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve normative. Auditimi i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura;

Për vitin buxhetor 2022, akordimi fillestar i fondeve (buxhetit), është dërguar me shkresën e Sekretarit të Përgjithshëm në MB nr.10084/4 datë 27.01.2022, “Dërgohet detajimi i fondit për shpenzime për mallra dhe shërbime për vitin 2022. Mbi bazën e buxhetit të dërguar me shkresën e mësipërme, është bërë detajimi i nën zërave të buxhetit të miratuar për vitin 2022, me fondin total në shumën 1,960,300 lekë, i ndarë;

- Llogaria 600 “Paga, shpërblime dhe të tjera shpenzime personeli” shuma 24,000,000 lekë.
- Llogaria 601 “Kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësore”, shuma 4,086,000 lekë.
- Llogaria 602 “Mallra dhe shërbime të tjera”, shuma 8,112,000 lekë.
- Llogaria 606 “Transferuar për buxhetet familjare dhe individët”, shuma 0 lekë.

Nga auditimi i kryer në drejtim të ndryshimeve që kanë pësuar zërat e buxhetit gjatë viteve, rezulton se këto ndryshime (shtesa dhe pakësimi), janë bërë mbi bazën e kërkesave të njësisë shpenzues dhe miratimit të organit qendror. Të gjitha ndryshimet e bëra në buxhet, janë të regjistruara e të rakorduar me degën e thesarit dhe janë të raportuara periodikisht, në situacionet mujore e progresive të miratuara nga dega e thesarit të rrethit.

Për çdo ndryshim të zërave të buxhetit, (në shtesë apo në pakësim), bashkëlidhur janë kërkesat e institucionit për shtesa ose pakësim dhe shkresat e institucionit qendror, për ndryshimin e buxhetit. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit duke argumentuar edhe ndryshimet e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit.

Analiza e realizimit të buxhetit është bërë mbi bazën e urdhër shpenzimeve të plotësuara, miratuara, kontrolluara, likuiduara dhe të regjistruara në librat e llogarisë, komfor klasifikimit buxhetor, (ditari shpenzimeve). Konfirmimi i urdhërpagesave është bërë nga nëpunësi autorizues, nëpunësi zbatues, kjo në zbatim të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin“, i ndryshuar. Të gjitha urdhërpagesat janë të konfirmuara nga dega e thesarit të rrethit.

Referuar periudhës objekt auditimi po analizojmë disa prej të dhënave të evidencave të aktivitetit të realizimit buxhetor për vitin 2022 dhe vitin 2023 e konkretisht:

✓ Për vitin 2022;

Planifikimi i buxhetit, akordimi fillestar, ndryshimet (shtesa e pakësim fondesh), dhe realizimi, paraqitet si vijon:

000/lekë							
Nr. rendor	Llogaria	Kërkesa për fonde (PBA)	Plani vjetor në fillim viti	Ndryshime gjatë vitit	Plani vjetor (plan fillestar + ndryshimet)	Realizimi i planit vjetor dt.31.12.2022	Realizimi (në %)
1	Llog. 600	28,086,000	24,000,000	-960,000	23,040,000	22,734,751	99%

2	Llog. 601		4,086,000	-110,000	3,976,000	3,766,798	95%
3	Llog. 602	8,112,000	8,112,000	-840,000	7,272,000	5,878,482	81%
4	Llog. 606		0	+438,400	438,400	390,000	88%
5	Llog. 231	1,000,000	1,000,000	0	1,000,000	811,848	81%
	Shuma	37,198,000	37,198,000	-1,471,600	35,726,400	33,581,879	93%

Në total, realizimi i shpenzimeve të planifikuara për vitin buxhetor 2022, është në masën 93%.

Analizuar në nivel Llogaria dhe nën Llogaria:

Llogaria 600 “Paga dhe shpenzime personeli”: Planifikimi i buxhetit (sipas kërkesave të PBA) në nivel Llogaria për vitin 2022 ka qenë 24,000,000 lekë. Akordimi fillestar për vitin është në shumën 24,000,000 lekë, gjatë vitit është bërë pakësim në vlerën 960,000 lekë, ose 4% e fondit fillestar, plani me ndryshimet 23,040,000 lekë, realizimi 22,734,751 lekë, ose 99 %.

Llogaria 601 “Kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore”: Planifikimi i buxhetit (sipas kërkesave të PBA) në nivel Llogaria për vitin 2022 ka qenë 4,086,000 lekë. Akordimi fillestar për vitin është në shumën 4,086,000 lekë. Gjatë vitit janë bërë pakësim në vlerën 110,000 lekë, ose 2% e fondit fillestar. Plani me ndryshimet 3,976,000 lekë, realizimi 3,766,798 lekë, ose 95 %.

Llogaria 602 “Mallra dhe shërbime”: Planifikimi i buxhetit (sipas kërkesave të PBA) në nivel Llogaria për vitin 2022 ka qenë 8,112,000 lekë. Akordimi fillestar për vitin është në shumën 8,112,000 lekë. Gjatë vitit janë bërë pakësim fondesh në vlerën 840,000 mijë lekë, ose 10 % e fondit fillestar. *Plani me ndryshimet 7,272,000 lekë, realizimi 5,878,482 lekë, ose 81 %.*

Bazuar në kërkesën për buxhet dhe buxhetin e akorduar, rezulton se fondi është çelur, për blerje dokumentacioni, pagesë energjie elektrike, ujë, shërbime printimi dhe publikimi, karburant dhe vaj, shpenzime mjeteve transporti, shpenzime udhëtimi i brendshëm, shpenzime mirëmbajtje mjeteve transporti, etj. Nga analiza e kryer në lidhje me respektimin e disiplinës buxhetore në artikuj, n/artikuj për mallra e shërbime gjatë vitit 2022, rezultoi se ka disa pakësim të fondeve të planifikuara si dhe disa raste mos realizim të nën llogarive, e konkretisht;

-*Nën Llogaria 602.3 “Shpenzime transporti”*:plani fillestarë 2,080,000 lekë, janë bërë pakësim në vlerën 750,000 lekë. Plani vjetor me ndryshimet 1,330,000 lekë, realizimi 1,187,102 lekë, ose 89% e fondit të parashikuar.

-*Nën Llogaria 602.4 “Shpenzime udhëtimi”*:plani fillestarë 1,200,000 lekë, janë bërë pakësim në vlerën 90,000 lekë. Plani vjetor me ndryshimet 1,010,000 lekë, realizimi 918,760 lekë, ose 90% e fondit të parashikuar.

-*Nën Llogaria 602.5/300 “Shpenzime Mirëmbajtje objekte ndërtimore”*: plani fillestar 420,000 lekë. Plani vjetor me ndryshimet 320,000 mijë lekë, *fond i cili nuk ishte realizuar.*

-*Nën Llogaria 602.9/003 “Shpenzime Gjyqësore”*: plani fillestar 12,000 lekë. Plani vjetor me ndryshimet 12,000 mijë lekë, *fond i cili nuk ishte realizuar.*

-*Nën Llogaria 602.9/008 “Shpenzime për tatim taksa”*: plani fillestar 150,000 lekë. Plani vjetor me ndryshimet 150,000 mijë lekë, *fond i cili nuk ishte realizuar.*

-*Llogaria 606 “Transferta për buxhetet familjare dhe individët”*:Planifikimi i buxhetit (sipas kërkesave të PBA) në nivel Llogaria për vitin 2022 nuk kishte të planifikuar transferta për buxhetet familjare dhe individët dhe nuk është akorduar fond fillestar për këtë vite ushtrimor. Gjatë vitit është bërë shtesë fondi me vlerë 438,400 lekë. *Plani me ndryshimet 438,400 lekë, realizimi është 390,000 lekë, ose 88 % e fondit të akorduar.*

Llogaria 231 “Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuar”: Planifikimi i buxhetit (sipas kërkesave të PBA) në nivel Llogaria për vitin 2022 ka qenë 1,000,000 lekë.

Akordimi fillestar për vitin është në shumën 1,000,000 lekë, nuk ka shtesa apo pakësim gjatë periudhës. Plani vjetor 1,000,000 lekë dhe realizimi 811,848 mijë lekë, ose 81 % e fondit.

Për shtesat e pakësimit e bëra nga organi qendror, për vitin buxhetor 2022, ndryshimet janë bërë sipas shkresave të pasqyrës bashkëlidhur këtij raportit auditimi.

Për vitin buxhetor 2023, akordimi fillestar i fondeve (buxhetit), është dërguar me shkresën e Sekretarit të Përgjithshëm në MB nr.12851/20 datë 30.01.2023, “Dërgohet për detaj imi i fondit për shpenzime për mallra dhe shërbime për vitin 2023. Mbi bazën e buxhetit të dërguar me shkresën e mësipërme, është bërë detaj imi i nën zërave të buxhetit të miratuar për vitin 2023, me fondin total në shumën 35,949,000lekë, i ndarë ;

- Llogaria 600 “Paga, shpërblime dhe të tjera shpenzime personeli” shuma 24,640,000 lekë.
- Llogaria 601 “Kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësore”, shuma 4,186,000 lekë.
- Llogaria 602 “Mallra dhe shërbime të tjera”, shuma 7,000,000 lekë.
- Llogaria 606 “Transferta për buxhetet familjare dhe individët”, shuma 123,000 lekë.

Nga auditimi i kryer në drejtim të ndryshimeve që kanë pësuar zërat e buxhetit gjatë viteve, rezulton se këto ndryshime (shtesa dhe pakësim), janë bërë mbi bazën e kërkesave të njësisë shpenzues dhe miratimit të organit qendror. Të gjitha ndryshimet e bëra në buxhet, janë të regjistruara e të rakorduar me degën e thesarit dhe janë të raportuara periodikisht, në situacionet mujore e progresive të miratuara nga dega e thesarit të rrethit.

Për çdo ndryshim të zërave të buxhetit, (në shtesë apo në pakësim), bashkëlidhur janë kërkesat e institucionit për shtesa ose pakësim dhe shkresat e institucionit qendror, për ndryshimin e buxhetit. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit duke argumentuar edhe ndryshimet e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit.

Analiza e realizimit të buxhetit është bërë mbi bazën e urdhër shpenzimeve të plotësuara, miratuara, kontrolluara, likuiduara dhe të regjistruara në librat e llogarisë, konfirmo klasifikimit buxhetor, (ditari shpenzimeve). Konfirmimi i urdhërpagesave është bërë nga nëpunësi autorizues, nëpunësi zbatues, kjo në zbatim të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin“, i ndryshuar. Të gjitha urdhërpagesat janë të konfirmuara nga dega e thesarit të rrethit.

✓ **Për vitin 2023;**

Planifikimi i buxhetit, akordimi fillestar, ndryshimet (shtesa e pakësim fondesh), dhe realizimi, paraqitet si vijon:

000/lekë							
Nr. rendor	Llogaria	Kërkesa për fonde (PBA)	Plani vjetor në fillim viti	Ndryshime gjatë vitit	Plani vjetor (plan fillestar +ndryshimet)	Realizimi i planit vjetor dt.31.12.2023	Realizimi (në %)
1	Llog. 600	28,826,000	24,640,000	+4,800,000	29,440,000	28,320,988	96%
2	Llog. 601		4,186,000	+1,050,000	5,236,000	4,675,588	89%
3	Llog. 602	7,123,000	7,000,000	0	7,000,000	6,238,938	89%
4	Llog. 606		123,000	+50,000	173,000	173,000	100%
5	Llog. 231	0	0	+200,000	200,000	186,000	93%

	Shuma	35,949,000	35,949,000	+6,100,000	42,049,000	39,594,514	94%
--	--------------	-------------------	-------------------	-------------------	-------------------	-------------------	------------

Në total, realizimi i shpenzimeve të planifikuara për vitin buxhetor 2023, është në masën 94%.

Analizuar në nivel Llogaria dhe nën Llogaria:

Llogaria 600 “Paga dhe shpenzime personeli”: Planifikimi i buxhetit (sipas kërkesave të PBA) në nivel Llogaria për vitin 2023 ka qenë 24,640,000 lekë. Akordimi fillestar për vitin është në shumën 24,640,000 lekë, gjatë viti janë bërë shtesa në vlerën 4,800,000 lekë, ose 19 % e fondit fillestar, plani me ndryshimet 29,440,000 lekë, realizimi 28,320,988 lekë, ose 96 % e fondit të akorduar.

Llogaria 601 “Kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore”: Planifikimi i buxhetit (sipas kërkesave të PBA) në nivel Llogaria për vitin 2023 ka qenë 4,186,000 lekë. Akordimi fillestar për vitin është në shumën 4,186,000 mijë lekë. Gjatë vitit janë bërë shtesa në vlerën 1,050,000 mijë lekë, ose 25 % e fondit fillestar. Plani me ndryshimet 5,236,000 lekë, realizimi 4,675,588 lekë, ose 89 %.

Llogaria 602 “Mallra dhe shërbime”: Planifikimi i buxhetit (sipas kërkesave të PBA) në nivel Llogaria për vitin 2023 ka qenë 7,000,000 lekë. Akordimi fillestar për vitin është në shumën 7,000,000 mijë lekë. Gjatë vitit janë shtuar 560,000 lekë dhe janë pakësuar 560,000 lekë nga fondi fillestar. Plani me ndryshimet 7,000,000 lekë, realizimi 6,238,938 lekë, ose 89 %.

Bazuar në kërkesën për buxhet dhe buxhetin e akorduar, rezulton se fondi është çelur, për blerje dokumentacioni, pagesë energjie elektrike, ujë, shërbime printimi dhe publikimi, karburant dhe vaj, shpenzime udhëtim i brendshëm, shpenzime mirëmbajtje mjeteve transporti, etj. Nga analiza e kryer në lidhje me respektimin e disiplinës buxhetore në artikuj, n/artikuj për mallra e shërbime gjatë vitit 2023, rezultoi se ka disa shtesa dhe pakësim të fondeve të planifikuara si dhe në disa raste mos realizim të nën llogarive, e konkretisht;

-Nën Llogaria 602.0 “Mallra dhe shërbime zyre të përgjithshme”: plani fillestar 640,000 lekë, ka pakësim 100,000 lekë, ose 15% të planit fillestar. Plani me ndryshimet 540,000 lekë, realizimi 487,923 lekë, ose 90 % e planit fillestar.

-Nën Llogaria 602./100 “Kancelari”: plani fillestar 300,000 lekë, ka pakësim 80,000 lekë, ose 26% të planit fillestar. Plani me ndryshimet 220,000 mijë lekë, realizimi 207,744 lekë, ose 94% e planit fillestar.

-Nën Llogaria 602./900 “Furnizim dhe materiale të tjera zyre”: plani fillestar 120,000 lekë, ka pakësim 20,000 lekë, ose 16% të planit fillestar. Plani me ndryshimet 80,000 lekë, realizimi 55,760 lekë, ose 69% e planit fillestar.

-Nën Llogaria 602.2 “Shërbime nga të tretët”: plani fillestar 2,170,000 lekë, ka pakësim 200,000 lekë, ose 9.2% të planit fillestar. Plani me ndryshimet 2,070,000 lekë, realizimi 1,736,595 lekë, ose 83% e planit fillestar.

-Nën Llogaria 602.4 “Shpenzime udhëtimi”: plani fillestarë 1,100,000 lekë, ka shtesa 500,000 lekë dhe janë pakësuar 200,000 lekë nga fondi fillestar. Plani me ndryshimet 1,400,000 lekë, realizimi 1,364,700 lekë, ose 97% e planit fillestar.

-Nën Llogaria 602.4/200 “Shpenzime Udhëtim i jashtëm”: plani fillestar 200,000 lekë. Plani vjetor me ndryshimet 200,000 mijë lekë, *fond i cili nuk ishte realizuar*.

-Nën Llogaria 602.5/300 “Shpenzime për mirëmbajtje objekte ndërtimore”: plani fillestar 300,000 lekë. Plani vjetor me ndryshimet 200,000 mijë lekë, *fond i cili nuk ishte realizuar*.

-Llogaria 606 “Transferta për buxhetet familjare dhe individët”: Planifikimi i buxhetit (sipas kërkesave të PBA) në nivel Llogaria për vitin 2023 nuk kishte të planifikuar transferuar për

buxhetet familjare dhe individët. Akordimi fillestar për vitin është në shumën 123,000 lekë. Gjatë vitit është bërë shtesë fondi me vlerë 50,000 lekë. Plani me ndryshimet 173,000 lekë, realizimi është 173,000 lekë, ose 100 % e fondit të akorduar.

Llogaria 231 “Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara”: Planifikimi i buxhetit (sipas kërkesave të PBA) në nivel Llogaria për vitin 2023 nuk kishte të planifikuar shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe nuk është akorduar fond fillestar për këtë vite ushtrimor. Gjatë vitit është bërë shtesë fondi me vlerë 200,000 lekë. Plani me ndryshimet 200,000 lekë, realizimi është 186,000 lekë, ose 93 % e fondit të akorduar.

Për shtesat e pakësimit e bëra nga organi qendror, për vitin buxhetor 2023, ndryshimet janë bërë sipas shkresave të pasqyrës bashkëlidhur këtij raporti auditimi.

Nga sa më sipër rezulton se nga Prefekti i Qarkut nuk kanë dalë urdhrat për ngritjen e grupit të punës për hartimin e PBA për çdo fazë të tij; Nuk ka të dokumentuar kërkesat për nevojat buxhetore nga secili sektor; PBA-të dhe Plani vjetor është hartuar mbi realizimin e zërave buxhetorë të dy vitete pararendëse; Nuk ka dalë Urdhri i Prefektit për ngritjen e GMS; Nuk ka takime të dokumentuara të GMS mbi diskutimet e tavanëve buxhetore dhe nevojave të institucionit për investime; Nuk janë realizuar fazat e përgatitjes së PBA-ve, si dhe mosngritja e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) është shoqëruar edhe me mosngritjen e Ekipeve të Menaxhimit të Programeve (EMP).

- Në auditimin e procedurës së ndjekur në drejtim të planifikimit dhe realizimit të buxhetit të akorduar për institucionin e Prefektit për periudhën e audituar (2022-2023) evidentojmë se, institucioni nuk ka ndjekur dhe zbatuar si duhet kërkesat ligjore për buxhetin e shtetit në drejtim të planifikimit të nevojave për mallra e shërbime dhe realizimit të fondeve të nevojshme për plotësimin e këtyre nevojave që ka institucioni. Nga fondet e akorduara nga buxheti sipas planifikimit dhe ndryshimeve të kërkuar në periudha të ndryshme nga vetë institucioni, për 5 nënzëra buxhetor për mallra e shërbime nuk janë realizuar 882 mijë lekë fonde të akorduara, si rezultat i mosplanifikimit të drejtë të nevojave për mallra e shërbime dhe fondeve buxhetore në funksion të përmbushjes së veprimtarisë së institucionit, siç përcaktohet në kërkesat e udhëzimeve të MFE “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”. Nga verifikimi i dokumentacionit të kryer në lidhje me respektimin e disiplinës buxhetore në artikuj, n/artikuj për mallra e shërbime gjatë periudhës së audituar rezulton se, fondet e akorduara në planin financiar dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, nuk janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, llogarinë dhe nën llogarinë sipas shërbimeve, pasi në pesë raste rezultoi mos realizim i fondeve të planifikuara sipas n/llogarive, (për nën llogaritë 602.5/300 “Shpenzime Mirëmbajtje objekte ndërtimore”, 320,000 mijë lekë, fond i pa realizuar; nën llogarinë 602.9/003 “Shpenzime Gjyqësore” 12,000 mijë lekë, fond i pa realizuar; nën llogarinë 602.9/008 “Shpenzime për tatim taksa”, 150,000 mijë lekë, fond i cili nuk ishte realizuar; nën llogarinë 602.4/200 “Shpenzime Udhëtim i jashtëm”, 200,000 mijë lekë, fond i pa realizuar dhe nën llogarinë 602.5/300 “Shpenzime për mirëmbajtje objekte ndërtimore”, 200,000 mijë lekë, fond i pa realizuar). Veprime të cilat nuk janë në përputhje me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; Udhëzimi MF nr.2, datë 06.02.2012 dhe nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, si dhe Udhëzimi MB nr.459, datë 16.08.2013 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit në sistemin e MB”.

-

1.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit. Vlerësimi i risqeve buxhetore;

➤ ***Auditimi të ardhurave.***

-Furnizimi me pulla nga Drejtoria Rajonale Tatimore (DRT), furnizimi i zyrave vendore të gjendjes civile, arkëtimi i vlerave të shitura dhe derdhja e vlerave për DRT dhe buxhetin e shtetit. Rakordimi midis sektorit të financës, zyrave vendore dhe DRT. Furnizimi me mallra dhe materiale furnizuara pa pagesë nga MB, për programin buxhetor të Zyrave të Gjendjes Civile (ZGJC).

Institucioni i Prefektit Qarku Vlorë është një njësi shpenzuese me dy programe buxhetore “*Prefektura dhe funksione të deleguara*” dhe “*Gjendja civile*”.

Gjatë vitit 2022 Institucioni i Prefektit Qarku Vlorë ka furnizuar gjendjet civile në Vlorë, Sarandë dhe Delvinë me pulla. Për çdo muaj është bërë rakordomi mbi furnizimin, shpërndarjen, dhe gjendjen në fund me pulla nga çdo përgjegjës sektori i gjendjeve civile. Në fund të periudhës ushtrimore është mbajtur akt-rakordomi me Drejtorinë Rajonale Tatimore Vlorë mbi të gjithë hyrjet dhe daljet e pullave me bazë mujore, përkatësisht; për vitin 2022 akt-rakordomi me datë 31.12.2022 dhe për vitin 2023 akt-rakordomi me datë 31.12.2023.

Gjatë periudhës 1 Janar- 31 Dhjetor 2022 janë arkëtuar gjithsej 1,220,000 lek, të cilat janë derdhur pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë.

Gjatë periudhës, zyrat e gjendjeve civile Vlorë, Sarandë dhe Delvinë janë furnizuar direkt nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile bazë materiale dhe certifikata. Institucioni i Prefektit Qarku Vlorë/sektori i financës ka kryer veprimet përkatëse duke hartuar fletë hyrjet e fletë daljet, *pa akt-konfirmim me Drejtorinë e buxhetit dhe menaxhimin financiar në Ministrinë e Brendshme.*

Gjatë vitit 2022 Institucioni i Prefektit Qarku Vlorë ka furnizuar gjendjet civile në Vlorë, Sarandë dhe Delvinë me pulla. Për çdo muaj është bërë rakordomi mbi furnizimin, shpërndarjen, dhe gjendjen në fund me pulla nga çdo përgjegjës sektori i gjendjeve civile si më lart cituar.

Në fund të periudhës rezulton se ka gjendje pullash 1,980 copë, në vlerë 99,000 lekë, të cilat janë përdorur në vitin pasardhës.

Për çdo muaj janë mbajtur akt -rakordimet përkatëse mes Institucionit të Prefektit Qarku Vlorë dhe Degës së Thesarit Vlorë.

Gjatë periudhës 1 Janar- 31 Dhjetor 2023 janë arkëtuar gjithsej 778,300 lek, të cilat janë derdhur pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë.

Gjatë periudhës, zyrat e gjendjeve civile Vlorë, Sarandë dhe Delvinë janë furnizuar direkt nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile bazë materiale dhe certifikata. Institucioni i Prefektit Qarku Vlorë/sektori i financës ka kryer veprimet përkatëse duke hartuar fletë hyrjet e fletë daljet, *por që nuk kishte akt-konfirmim me Drejtorinë e buxhetit dhe menaxhimin financiar në Ministrinë e Brendshme.*

Gjatë vitit 2023 Institucioni i Prefektit Qarku Vlorë ka furnizuar gjendjet civile në Vlorë, Sarandë dhe Delvinë me pulla. Për çdo muaj është bërë rakordomi mbi furnizimin, shpërndarjen, dhe gjendjen në fund me pulla nga çdo përgjegjës sektori i gjendjeve civile si më lart cituar.

Në fund të periudhës rezulton se ka gjendje pullash 7,114 copë, në vlerë 355,700 lekë, të cilat janë përdorur në vitin pasardhës.

Për çdo muaj janë mbajtur akt -rakordimet përkatëse mes Institucionit të Prefektit Qarku Vlorë dhe Degës së Thesarit Vlorë.

Administrimi i dokumentacionit nga ana e zyrave të gjendjes civile:

Nga auditimi i dokumentacionit, mbi të cilat bazohet formulimi i akteve të gjendjes civile, rezultoi se; nga ana e zyrave të gjendjes civile, në NJVV në Prefekturën e Vlorës, aktet e lindjeve, të martesave e të vdekjeve, dorëzoheshin në arkivin e zyrave të arkivit të gjendjes civile pranë

Prefektit të Qarkut, brenda datës 20 janar e vitit pasardhës, në përputhje me nenin 32, të Ligjit 10129, datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile” i ndryshuar.

-Për periudhën 2022-2023 Institucioni Prefektit (3 ZGJC Vlorë, Sarandë dhe Delvinë) është furnizuar direkt nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile me bazë materiale dhe me certifikata të cilat janë të dokumentuara me hyrje/dalje malli nga sektori financës në Institucionin e Prefektit, por nuk ka dokumentuar me Drejtorinë e buxhetit dhe menaxhimit financiar në MB, aktin e rakordimit dhe të konfirmarrjes së këtyre mallrave. Pra konstatohet një mungesë rakordimi dhe konfirmimi me Drejtorinë e buxhetit dhe menaxhimit financiar në MB për furnizimin e 3 ZGJC me bazë materiale dhe me certifikata. Në përfundim të auditimit të procedurës së ndjekur nga institucioni për zbatimin e buxhetit dhe të ardhurave të realizuara nga ZGJC vlerësojmë se, sektori financës dhe shërbimeve nuk ka marrë masat e nevojshme për planifikimin e saktë të nevojave për mallra e shërbime si dhe nuk ka rakorduar e konfirmuar procesin e furnizimit të ZGJC me mallra pa pagesë nga MB, në zbatim të funksionimit sa e si duhet të kontrollit të brendshëm. *Këto veprime nuk janë në përputhje me Ligjin nr.10296, datë 26.06.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar dhe Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.*

1.4. Burimi i krijimit të të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi, përdorimi i tyre;

Llogaritë 468 “Debitorë të ndryshëm”.

Në fund të periudhës 2022-2023 pasqyrohet vlera 309,061 lekë e pa ndryshuar nga viti 2018. Kjo vlerë përfaqëson detyrimet debitore të 4 personave ish punonjës të institucionit të krijuara 3 persona me vlerën 159,884 lekë në vitin 2014 dhe 1 person me vlerë 149,177 lekë krijuar në vitin 2018, pa u arkëtuar, të pasqyruara analitikisht si më poshtë;

Nr	Emër mbiemër/ Ish punonjës	Viti i krijimit	Shuma në lekë	Arsyet e krijimit të tyre	Me shprese arketimi
1.	M. B.	2014	44,528	Paguar me tepër	Në gjykim
2.	A. N.	2014	64,467	Paguar me tepër	Në gjykim
3.	E. B.	2014	50,889	Paguar me tepër	Në gjykim
4.	P. J.	2018	149,177	Paguar me tepër	Në gjykim
	Shuma		309,061		

Për 4 debitorët e mbartur në bilanc nga viti 2014 me vlerë 309,061 lekë detyrime, institucioni ka kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e tyre e konkretisht;

Për debitorët (M. B., A. N. dhe E. B.) është kërkuar arkëtimin në Gjykatë ne Rrethit Gjyqësor Vlorë me kërkesë padi në nr.4394 datë 23.11.2015, çështja është shqyrtuar dhe aktualisht vendimi i gjykatës është ankimuar nga institucioni prefektit në gjykatë ne Apelit Vlorë me nr.1032, datë 07.06.2018 e cila është në proces.

Ndërsa për debitorin P. J. është bërë kërkesë padia nr.1703/2, datë 24.10.2018, është shqyrtuar çështja në Gjykatë ne Shkallës së Parë Vlorë dhe nga institucioni i Prefektit është apeluar në Gjykatëne Apelit Vlorë me shkresën nr.227, datë 07.02.2019 për ankim të vendimit nr.53, datë 18.01.2019. Ende nuk është marrë vendimi përfundimtar.

Detyrime për furnitorët

Llogaria në aktiv	Zërat	Fund viti 2022	Fund viti 2023	Fatura e vitit /objekti detyrimit	Të rakorduara në pasiv në llogaritë
4342	Detyrime të mbartura	86,969	86,969	Të mbartura	401-408

-Analiza e detyrimeve të mbartura ndër vite e vlerës 86,969 lekë e detajuar.

Emëri furnitorit	Lloji i detyrimit	Data e lind detyrimit	Vlera detyrimit	Arsyja e mos likujdimit
Q.I. D.	Pjesë këmbimi	12.09.2001	18,700	Subjekti është mbyllur
F. K	Blerje tonera	28.12.2001	2,291	Subjekti ska paraqitur faturë
Diference e mbartur	E panjohur		2,741	Ska të dhëna
A. L	Pjesë këmbimi	26.02.2007	3,200	Subjekti është mbyllur.
A. L	Pjesë këmbimi	29.06.2008	60,000	Subjekti është mbyllur.
K.	Karburant	2015	37	Diferencë likujdimi
		Shuma	86,969	

Nga analiza e detyrimeve të mësipërme përveç detyrimeve për shpenzime funksionimi të faturuara në muajin dhjetor të vitit ushtrimor institucioni katë pasqyruar në llogarinë 4342 edhe një detyrimin për 86,969 lekë e cila përfaqëson një detyrim të mbartur ndër vite dhe e analizuar sipas përkatësisë. Për këto detyrime kreditore të mbartura në bilanc, sektori financës nuk administron faturat justifikuese të detyrimeve.

1.5. Verifikim i masave të programit të emergjencave dhe mbrojtjes civile për masat e marra për fatkeqësitë natyrore si tërmetet, përmbytjet, dëmtimet nga zjarri, vlerësimet e dëmeve nga fatkeqësitë e ndryshme për përmirësimin e cilësisë së jetës së njeriut duke promovuar përvojat më të përparuara dhe shërbime të sigurt dhe efikase.

Në lidhje me këtë drejtim të auditimit rezulton se;

I. Baza ligjore ku mbështetet auditimi mbi zbatimin e dispozitave ligjore mbi Emergjencat dhe Mbrojtjen Civile është:

- ✓ Ligji nr.45 datë 18.07.2019 “Për Mbrojtjen civile”,
- ✓ Ligji nr. 107 dt. 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”;
- ✓ VKM nr. 923 datë 25.11.2020 “Për funksionimin e organizimin e komitetit të mbrojtjes civile dhe bashkëpunimin ndërinstitucional të institucioneve dhe të strukturave të sistemit të mbrojtjes civile”
 - ✓ VKM nr. 345 datë 26.05.2022 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë”
 - ✓ VKM nr. 414 datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”
- ✓ Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”

Drejtimet kryesore të auditimit mbi procedurën e inventarizimit janë:

- Njohja dhe zbatimi i Ligji nr.45 datë 18.07.2019 “Për Mbrojtjen civile”, mbi rolin, përgjegjësitë dhe detyrat e Prefektit të Qarkut;
- Përgjegjësitë kryesore të Prefektit të Qarkut dhe në veçanti mbi EMC dhe të strukturës përkatëse të EMC të PQ Vlorë për:

- drejtimin e strukturave për parandalimin, menaxhimin, rehabilitimin e pasojave në rastet e emergjencave civile;
 - drejtimin e task-forcave, krijimin e organizmave të përkohshëm, të komiteteve, të grupeve të punës dhe të komisioneve për çështje të caktuara;
 - Referuar Ligjit nr. 45 dt.18.07.2019 “Për mbrojtjen civile”, theksohet se objekti dhe qëllimi i tij është:
 - Zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe realizimin e mbrojtjes civile për të garantuar mbrojtjen e jetës së njerëzve, të gjësë së gjallë, të pronës, të trashëgimisë kulturore e të mjedisit, nëpërmjet forcimit të sistemit të mbrojtjes civile;
 - Rregullon funksionimin e sistemit të mbrojtjes civile, duke përcaktuar përgjegjësitë e institucioneve dhe të strukturave të këtij sistemi, bashkëpunimin ndërkombëtar, të drejtat dhe detyrimet e shtetasve dhe të subjekteve private, edukimin, trajnimin dhe inspektimin, janë përcaktuar sipas përgjegjësisë, Institucionet dhe strukturat qendrore të mbrojtjes civile që janë: a) Kuvendi;
 - b) Këshilli i Ministrave;
 - c) Komiteti Ndërmintor i Emergjencave Civile;
 - ç) Komiteti i Mbrojtjes Civile (KMC) dhe zyra përgjegjëse për situatën;
 - d) Ministri përgjegjës për mbrojtjen civile;
 - dh) Ministrinë dhe institucionet qendrore;
 - e) Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile;
 - ë) Komisioni teknik këshillimor;
 - f) Qendrat e mbrojtjes civile në qark (QMCQ).
 - Institucionet dhe strukturat vendore të mbrojtjes civile Institucionet dhe strukturat e mbrojtjes civile, në nivel vendor, janë:
 - a) Prefekti i qarkut;
 - b) Komisioni i mbrojtjes civile në nivel qarku dhe bashkie;
 - c) Bashkitë;
 - ç) Strukturat e decentralizuara të institucioneve dhe të strukturave qendrore të mbrojtjes civile.
- Struktura përgjegjëse për Emergjencat Civile në Institucionin e Prefektit të Qarkut Vlorë është e përbërë sipas të dhënave më poshtë:

Nr	Emër Mbiemër	Pozicioni në Strukturë	Formimi Arsikor	Emerimi në pozicion
1	R. S.	Përgjegjës i Sektorit	Ushtarak	02.08.2024
2	A. F.	Specialist i Sektorit	Ushtarak	24.12.2020
3	B. S.	Specialist i Sektorit	Inxhinier ndertimi	24.12.2020

Stafi i Sektorit të Emergjencave Civile [SEC] ka në përbën e tij aktualisht 2 (dy) punonjës (specialisti Bledar Selmanaj është larguar te sektori i Zhvillimit Urban), për periudhën e auditimit 3(tre) punonjës, referuar dhe në zbatim të Strukturës organizative miratuar me Urdhrin nr. 14 datë 12.01.2016.

Fondet për emergjencat Civile dhe konfirmimet me ligjshmërinë të VKB-ve të miratuara nga Këshillat Bashkikë të 7 Bashkive: Vlorë, Selenicë, Himarë, Sarandë, Delvinë, Finiq dhe Konispol.

Prefekti i Qarkut Vlorë - viti 2022/ në mijë lekë				
Emërtimi	VKB	Planifikim i fondeve	Vlera e fondit të realizuar/ pa përdorur	Konfirmimi nga Prefekti Vlorë

		për EC	Realizuar	Pa përdorur	
Bashkia Vlorë	Nr.84 datë 16.12.2021	33,789	4,614	29,175	Nr. 999/3 prot., dt. 10.01.2022
Bashkia Selenicë	Nr.71 datë 23.12.2021	10,110	3,038	7,072	Nr. 1018//1 prot., dt.10.01.2022
Bashkia Himarë	Nr.62 datë 23.12.2021	17,829	1,134	16,694	Nr. 1008/2 prot., dt. 10.01.2022
Bashkia Sarandë	Nr.225 datë 22.12.2021	10,055	2,727	7,328	Nr.1022/1 prot., dt. 10.01.2022
Bashkia Delvinë	Nr.51 datë 22.12.2021	23,394	-	23,394	Nr. 1009/2 prot dt. 10.01.2022
Bashkia Finiq	Nr.51 datë 24.12.2021	6,457	1,078	5,378	Nr.2/1 prot., dt. 17.01.2022
Bashkia Konispol	Nr.33 datë 22.12.2021	5,005	2,453	2,552	Nr. 3/1 prot, datë 17.01.2022
Totali	6	106,642	15,046	91,595	

Prefekti i Qarkut Vlorë - viti 2023/ në mijë lekë					
Emërtimi	VKB	Planifikim i fondeve për EC	Vlera e fondit të realizuar/ pa përdorur		Konfirmimi nga Prefekti Vlorë
			Realizuar	Pa përdorur	
Bashkia Vlorë	Nr.1 datë 18.01.2023	25,294	4,906	20,388	Nr97/1 prot., dt. 25.01.2023
Bashkia Selenicë	Nr.53 datë 27.12.2022	32,481	27,232	5,149	Nr. 24/1 prot., dt. 17.01.2023
Bashkia Himarë	Nr.70 datë 23.12.2022	7,499	0	7,499	Nr.1213/1 prot., dt. 06.01.2023
Bashkia Sarandë	Nr.179 datë 27.12.2022	11,651	2,706	10,650	Nr.32/1 prot., dt. 18.01.2023
Bashkia Delvinë	Nr.59 datë 22.12.2022	13,356	7,719	3,392	Nr.2/1 prot., dt. 11.01.2023
Bashkia Finiq	Nr.48 datë 29.12.2022	5,633	3,600	2,033	Nr.31/1 prot., dt. 18.01.2023 /
Bashkia Konispol	Nr.53 datë 27.12.2022	4,419	1,917	2,501	Nr.60/1 prot datë 20.01.2023
		99,696	48,081	51,614	

Në lidhje me vlerësimin e riskut dhe planin e masave.

Me urdhrin nr. 1163 prot, datë 25.06.2018 është miratuar Plani i përballimit të emergjencave civile në Qarkun Vlorë. Ky plan ka funksionuar deri në fund të vitit 2022. Me urdhrin nr. 18, administruar me shkresën nr. 355prot, datë 05.04.2023 është miratuar Plani i përballimit të emergjencave civile në Qarkun Vlorë.

Në hartimin e dokumentit për planin e përballimit të emergjencave për periudhën objekt auditimi janë parashikuar dhe skenarët e riskut, është bërë analiza dhe vlerësimi i parashikimit të tyre. Dokumenti është hartuar nga Përgjegjësi i Sektorit të të planifikimit dhe përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave dhe është miratuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë. Në këtë dokument janë paraqitur gjithashtu edhe institucionet me kontaktet dhe kapacitetet e tyre për përballimin e planit të masave.

Për vitin 2022 me dokumentin nr. 71 prot, datë 26.01.2022 është miratuar plani i emergjencave për reagimin ndaj ndotjeve detare me përfaqësues nga flotilja Detare Pashaliman, Drejtoria Rajonale e Mjedisit vlorë dhe Institucioni i Prefektit të Qarkut Vlorë. Për vitin 2023 me dokumentin nr. 50 prot, datë 12.01.2023 është miratuar plani i emergjencave për reagimin ndaj ndotjeve detare me përfaqësues nga flotilja Detare Pashaliman, Drejtoria Rajonale e Mjedisit Vlorë dhe Institucioni i Prefektit të Qarkut Vlorë.

Në lidhje me dokumentimin për raportet periodike dhe vjetore për situatat e emergjencave civile në Qarkun Vlorë për vitet 2022 dhe 2023 rezulton se, nga Prefekti i Qarkut Vlorë, nuk është dërguar në AKMC raport mbi bashkërendimin dhe bashkëpunimin e veprimtarisë me degët territoriale që veprojnë në qark, raport të cilin duhet t’ia paraqiste ministrisë përgjegjëse dhe kryeministrisë pra Komitetit të Mbrojtjes Civile. Gjithashtu rezulton se nuk janë dërguar raporte periodikë në AKMC për të dhëna nga Bashkitë dhe struktura të tjera publike të Qarkut Vlorë për risqet ekzistuese e potenciale si dhe masat e marra për zvogëlimin e tyre, në raport me planin e masave të miratuara. *Veprim i cili nuk është në përuthje me Ligjin nr. 45 datë 18.07.2019 “Për Mbrojtjen civile”, nenin 20, Ligjin nr. 107/2016, datë 27.10.2016, “Për Prefektin e Qarkut”, neni 8, pika c, nenin 10 pika 1/d. .*

Aktualisht për të 7 bashkitë e Qarkut Vlorë është duke u punuar për përpilimin e dokumentave strategjike, nga ekspertë kombëtar të mbështetur nga UNDP dhe me asistencë të AKMC në kuadër të projektit RESEAL. Prefektura e Qarkut Vlorë si dhe gjashtë bashkitë e këtij qarku janë përzgjedhur nga AKMC për implemetimin e këtij projekti pilot për hartimin e dokumenteve strategjike të Zvogëlimit të Riskut nga Fatkeqësitë.

Nga auditimi dhe informacioni i vënë në dispozicion nga SEC se Baza e të dhënave Kombëtare Krijohet dhe mirëmbahet nga AKMC sipas rregullave të VKM nr. 345/2022 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë”. Referuar pikes 11 të VKM nr. 345/2022, Bashkitë kanë detyrim hedhjen dhe përditësimin e të dhënave parësore në Bazën e të Dhënave të Humbjeve nga Fatkeqësitë, ndërsa Prefekturat kanë detyrimin të sigurojnë që bashkitë nën juridiksionin e vet të hedhin dhe përditësojnë të dhënat në lidhje me dëmet e shkatëruara nga fatkeqësitë. Më poshtë paraqiten informacionet dhe të dhënat për dëmet e shkaktuara gjatë vitit 2022 dhe vitit 2023 në formë përmbledhëse e konkretisht;

Për vitin 2022 dëmet e shkaktuara;

NR	BASHKITË	Ullinj/rrenj	Dru/frutor	Vresht	Kullot/ha	Shkurre/ha
1	VLORE	580	115	2.5 ha	375 (355 b+100p)	311

2	SELENICË	5149	427	1.5 ha	Ska info	260
3	HIMARË	920	200		85	56
4	DELVINË	1070	50		28	40
5	SARANDË	300			23.5(18.5 b+5p)	4
6	FINIQ	1395	198	200		45
7	KONISPOL		5.5		70	12.5
8	TOTALI	9414	990+5.5ha	200+4ha	633.5	728.5

Për vitin 2023 dëmet e shkaktuara;

NR	BASHKITË	Ullinj/rrenj	Dru/frutor	Vresht	Kullot/ha	Shkurre/ha
1	VLORË	600	70	0.5 ha	100	210
2	SELENICË	2500	350	0.7 ha	30	160
3	HIMARË	520	100		170	80
4	DELVINË	900	50	0.2	30	40
5	SARANDË	70			20	40
6	FINIQ	6000	500	300	150	45
7	KONISPOL	300	1.5		50	30
8	TOTALI	10.890	1070+1.5ha	300+1,4ha	550	685

Informacion për vitin 2022								
Bashkite	F.zjarrfikese	M.zjarr	F.Polic	Forc.Armat	F.Bashki	Forca Vullnet	Sh. pyjore	ADZM
Vlorë	736	214	74	278	63	118	37	42
Selenicë	313	59	24		29	209	15	2
Himarë	107	26	17	125	2	19	2	5
Sarandë	54	15	8		5	17		
Delvinë	125	28	8		20		9	
Finiq	169	44	6	85	37	89	20	
Konispol	46	9	1			10	1	
Totali	1550	395	138	488	157	462	84	49

Nga auditimi dhe informacioni i pasqyruar në tabelë, rezulton se *për vitin 2022*, numri total i forcave që kanë marrë pjesë në përmirësimin e situatave të krijuar nga zjarret janë:

- 1550 forca zjarrfikës, ku numrin më të lartë e ka bashkia Vlorë me 736 ose 47.5% dhe numrin më të vogël bashkia Konispol me 46 ose 3% të numrit total të kësaj kategorie;
- 1244 mjete zjarrfikës, ku numrin më të lartë e ka bashkia Vlorë me 214 ose 54.2% dhe numrin më të vogël bashkia Konispol me 9 mjete ose 2.3% të totalit;
- 138 forca policore
- 488 forca të armatosura
- 157 forca të bashkisë
- 462 forca vullnetare
- 84 forca të Shërbimeve Pyjore
- 49 forca nga ADZM

Informacion për vitin 2023								
Bashkite	F.zjarrfikese	M.zjarr	F.Polic	Forc.Armat	F.Bashki	Forca Vullnet	Sh. pyjore	ADZM
Vlorë	733	238	98	17	196	49	18	15
Selenicë	202	50	9		5	34	2	

Himarë	146	42	43	42				
Sarandë	75	21	10		4		9	
Delvinë	131	28	11	17	38	19	8	
Finiq	122	24	9	17	62	15	25	
Konispol	80	17	3		5	14		
Totali	1489	420	183	93	308	131	62	15

Nga auditimi dhe informacioni i pasqyruar në tabelë, rezulton se *për vitin 2023*, numri total i forcave që kanë marrë pjesë në përmirësimin e situatave të krijuar nga zjarret janë:

- 1489 forca zjarrfikës, ku numrin më të lartë e ka bashkia Vlorë me 733 ose 49.2% dhe numrin më të vogël bashkia Sarandë me 75 ose 5% të numrit total të kësaj kategorie;
- 420 mjete zjarrfikës, ku numrin më të lartë e ka bashkia Vlorë me 238 ose 56.7% dhe numrin më të vogël bashkia Konispol me 17 mjete ose 4% të totalit;
- 183 forca policore
- 93 forca të armatosura
- 308 forca të bashkisë
- 131 forca vullnetare
- 62 forca të Shërbimeve Pyjore
- 15 forca nga ADZM

Gjatë periudhës objekt auditimi rezulton se janë kryer monitorime në teren si dhe është përpiluar tabela e kapaciteteve për përballimin e Emergjencave Civile të cilat janë të paraqitura në Planin e Emergjencave për secilin vit.

Për veprimet e mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

- 1) Z. F. M, me detyrë Prefekt i Qarkut Vlorë, në cilësinë e nëpunësit autorizues,
- 2) Zj. L. S, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Financës në cilësinë e nëpunësit zbatues,
- 3) Z. R. S, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave.

2.2 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, për periudhën 01.01.2022-31.12.2023.

Në zbatim të pikës 2 të programit të auditimit me nr. 564/2, datë 31.05.2024 u kërkua për shqyrtim dokumentacioni si më poshtë:

1. *Shkresat e titullarit të Autoritetit Kontraktor për caktimin e personit/personave përgjegjës për prokurimin;*
2. *Regjistri i realizimeve të prokurimeve blerje me vlera të vogla për periudhën 01.01.2022-31.12.2023;*
3. *Dokumentacioni i vënë në dispozicion nëpërmjet dosjeve fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), në lidhje zhvillimin e procedurave si dhe me fazën e vlerësimit të ofertave;*
4. *Shpenzimet e kryera për procedurat e realizuara dhe marrja në dorëzim sipas rastit;*
5. *Urdhrat për krijimin e komisioneve të prokurimeve për procedurat blerje me vlera të vogla.*

Nga procedurat e audituara me përzgjedhje nga grupi i auditimit u konstatuan disa parregullsi në shkelje apo mospërputhje të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Për periudhën objekt auditimi, nga data 01.01.2022 deri me datë 31.12.2023, titullari i Autoritetit Kontraktor (AK), ka qenë z. F. M, në cilësinë e nëpunësit autorizues (NA) të Prefektit të Qarkut Vlorë.

Me urdhrin nr. 6, administruar me shkresën nr. 79 prot, datë 27.01.2022 nga titullari i AK është krijuar komisioni i blerjeve me vlerë të vogël me përbërje znj. L. S me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Financës, si kryetar i komisionit dhe anëtarët znj. T. T me detyrë specialist i sektorit të financës dhe znj. Z. B. me detyrë specialiste e sektorit juridik. Ky urdhër ka funksionuar deri në fund të vitit 2022.

Me urdhrin nr. 6, administruar me shkresën nr. 13 prot, datë 09.01.2023 nga titullari i AK është krijuar komisioni i blerjeve me vlerë të vogël me përbërje znj. L. S me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Financës, si kryetar i komisionit dhe anëtarët znj. T. T me detyrë specialist i sektorit të financës dhe znj. I. D me detyrë specialiste e sektorit juridik. Ky urdhër ka funksionuar deri në fund të vitit 2023.

Në lidhje me caktimin e personit përgjegjës për prokurimet konstatohet se nga titullari i Autoritetit Kontraktor nuk është caktuar person përgjegjës për prokurimet i cili administron në mënyrë të vazhdueshme procesin dhe procedurat e prokurimit që kryhen nga institucioni i Prefektit të Qarkut Vlorë, në cilësinë e personit përgjegjës për menaxhimin e fondeve. Veprim i cili nuk është në përputhje me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 21, pika 2 dhe 4, sipas të cilit:

2. Autoriteti ose enti kontraktor administron të gjithë dokumentacionin për procedurën e prokurimit, duke filluar nga planifikimi deri te zbatimi i kontratës, me qëllim kontrollin e zbatimit të ligjit.

4. Në autoritetin ose entin kontraktor caktohet personi përgjegjës për prokurimin, i cili administron në mënyrë të vazhdueshme procesin e prokurimit, si dhe ngrihet njësi prokurimi për çdo objekt që prokurohet. Personi përgjegjës duhet të kenë minimalisht një kualifikim sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik.

Vendimin e Këshillit të Minsitrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 74, pika 1, sipas të cilit:

1. Titullari i autoritetit/entit kontraktor, në fillim të vitit, cakton me urdhër të veçantë personin/personat përgjegjës për prokurimin dhe dërgon emrin/emrat respektivë, me kontaktet përkatëse, në Agjencinë e Prokurimit Publik.

Në lidhje me mosveprimet e konstatuara më sipër, të cilat bien në kundërshtim me LPP, ngarkohet me përgjegjësi: z. F. M, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor.

Për periudhën e auditimit nga data 01.01.2022 deri më 31.12.2022 Autoriteti Kontraktor Prefekti i Qarkut Vlorë ka realizuar gjithësej 6 procedura prokurimi blerje me vlera të vogla, me fond limit në shumën 2,576,666 lekë pa TVSH, me vlerë kontrate në shumën 1,874,342 lekë pa TVSH.

Për periudhën e auditimit nga data 01.01.2023 deri më 31.12.2023 Autoriteti Kontraktor Prefekti i Qarkut Vlorë ka realizuar gjithësej 14 procedura prokurimi blerje me vlera të vogla, me fond limit në shumën 2,164,815 lekë pa TVSH, me vlerë kontrate në shumën 1,818,252 lekë pa TVSH. Konkretisht, të dhënat e detajuara mbi procedurat e prokurimit paraqiten si me poshtë vijon:

Prokurime të realizuara për periudhën objekt auditimi nga data 01.01.2022 deri 31.12.2022			
Lloji i procedurës së prokurimit të përdorur nga AK	Procedura gjithësej të realizuara nga data 01.01.2022 deri 31.12.2022	Totali i fondit limit (në lekë pa tvsh) për procedurat përkatëse.	Vlera e kontratës së lidhur (në lekë pa tvsh) për procedurat përkatëse.
“blerje me vlerë të vogël”	6 procedura	2,443,332	1,874,342
“blerje nën vlerën 100,000 lekë”	12 procedura	1,278,333	1,024,741
“procedurë e hapur ”	1 procedurë (realizuar nga ABP)	1,250,000	625,000
“Me negociim, pa shpallje paraprake”			
TOTALI	19 procedura	4,971,665	3,524,083

Në mënyrë të detajuar prokurimet e llojit “blerje me vlerë të vogël” të realizuara gjatë vitit 2022 rezultojnë si vijon:

Prokurime BVV të realizuara për periudhën objekt auditimi nga data 01.01.2022 deri 31.12.2022			
Objekti i Prokurimit	Numri dhe data e Urdhrit të Prokurimit	Fondi limit (në lekë pa tvsh) për procedurën përkatëse.	Vlera e kontratës së lidhur (në lekë pa tvsh) për procedurën përkatëse.
Sigurim me roje private	UP. Nr.01 date 21.02.2022	666,666	550,000
Siguracion TPL kasko	UP.Nr. 02 date 13.05.2022	160,000	117,200
Mirembajtje mjete transporti	UP. Nr.03 date 30.06.2022	200,000	156,000
Pjese kembimi goma bateri etj	UP. Nr.04 date 13.07.2022	250,000	172,400
Kancelari ,leter	UP. Nr.05 date 19.08.2022	333,333	202,202
Blerje orendi zyre, mobilje	Up. Nr.06 date 13.10.2022	833,333	676,540
TOTALI	6procedura	2,443,332	1,874,342

Prokurime të realizuara për periudhën objekt auditimi nga data 01.01.2023 deri 31.12.2023			
Lloji i procedurës së prokurimit të përdorur nga AK	Procedura gjithësej të realizuara nga data 01.01.2023 deri 31.12.2023	Totali i fondit limit (në lekë pa tvsh) për procedurat përkatëse.	Vlera e kontratës së lidhur (në lekë pa tvsh) për procedurat përkatëse.
“blerje me vlerë të vogël”	5 procedura	1,381,482	1,168,722
“blerje nën vlerën 100,000 lekë”	12 procedura	1,083,333	878,068
“procedurë e hapur ”	1 procedurë (realizuar nga ABP)	716,666	716,514
“Me negociim, pa shpallje paraprake”			
TOTALI	15 procedura	3,181,481	2,763,304

Në mënyrë të detajuar prokurimet e llojit “blerje me vlerë të vogël” të realizuara gjatë vitit 2023 rezultojnë si vijon:

Në mënyrë të detajuar

Prokurime BVV të realizuara për periudhën objekt auditimi nga data 01.01.2023 deri 31.12.2023			
Objekti i Prokurimit	Numri dhe data e Urdhrit të Prokurimit	Fondi limit (në lekë pa tvsh) për	Vlera e kontratës së lidhur (në lekë pa

		procedurën përkatëse.	tvsh) për procedurën përkatëse.
“Sherbimi me roje fizike “	UP. Nr.01 date 23.03.2023	636,482	630,180
“Siguracion TPL kasko”	UP. Nr.02 date 12.05.2023	120,000	117,142
“Blerje pjese kembimi auto”	UP. Nr.03 date 31.05.2023	208,333	181,400
“kancelari”	UP. Nr.04 date 21.02.2023	250,000	85,000
“Blerje orendi zyre, mobilje	UP. Nr.05 date 23.11.2023	166,667	155,000
TOTALI	5procedura	1,381,482	1,168,722

Për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël nga NA kanë dalë urdhrat e krijimit dhe funksionimit komisionit të përlogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike, njësia e prokurimit, komisioni i vlerësimit të ofertave, komisioni i blerjeve të vogla, komisioni i marrjes në dorëzim të mallrave/punimeve/shërbimeve.

-Nga auditimi i dokumentacionit të procedurave të prokurimit rezulton se në 6 procedura prokurimi për periudhën 01.01.2022-31.12.2022 dhe në 14 procedura për periudhën 01.01.2023-31.12.2023, është caktuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, Prefekti i Qarkut Vlorë, znj. L. S si Kryetare e komisionit të procedurave blerje me vlerë të vogël, hartimit të specifikimeve teknike, llogaritjes së fondit limit dhe hartimit të ftesave për ofertë. Znj. S. është me pozicion pune Përgjegjëse e Sektorit të Financës në cilësinë e nëpunësit zbatues, e cila kryen kontrollat pas faktit bazuar në dokumentacionin mbështetës për kryerjen e një transaksioni financiar. Pra, veprimtaria e kontrollit pas faktit nuk duhet të kryhet nga persona të cilët kanë marrë pjesë në kontrollat para faktit, e cila është njëkohësisht anëtar dhe sekretar i Grupit të Menaxhimit Strategjik të institucionit. Vendosija e zj. L. S me detyrë nëpunës zbatues i institucionit të Prefektit të Qarkut Vlorë, si kryetari i komisionit të prokurimit me vlerë të vogël, nuk është në përputhje me kuadrin ligjor rregullator të nëpunësit zbatues. Çdo urdhër i titullarit për caktimin në komisione të nëpunësit zbatues i cili bie ndesh me veprimtarinë, duhet të refuzohet nga ky i fundit, gjë e cila nuk rezulton të ketë ndodhur në asnjë rast. Veprime të cilat nuk janë në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 4, pikat 16, 17 e 18, ku citohet se;

“Veprimtari të kontrollit”, përkufizohen si kontrolle para faktit dhe pas faktit. Ato përfshijnë kontrollin e ligjshmërisë dhe të rregullshmërisë dhe marrin parasysh parimet e ekonomizimit, të efikasitetit dhe të efektivitetit.

“Kontrolle para faktit” janë kontrollet e bëra, me qëllim që të garantohet ligjshmëria dhe rregullshmëria e vendimeve financiare. Ato duhet të kryhen në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha fazat e procesit, para marrjes së vendimit për përdorimin e fondeve publike, pra, para se të ndodhë një transaksion i caktuar.

“Kontrolle pas faktit” janë kontrolle të herëpashershme, që ushtrohen pas përfundimit të transaksionit, sipas një plani apo në vijim të një kërkesë. Kontrollet pas faktit verifikojnë nëse fondet publike arkëtohen e shpenzohen me ligjshmëri, sipas qëllimit dhe afateve të përcaktuara, në përputhje me detyrimet e marra përsipër, si dhe për arritjen e rezultateve të pritshme nga përdorimi i fondeve publike.

neni 12, pika 3, gërma e),

pranimin ose jo të dokumentacionit, bazuar në kontrollet pas faktit, në përputhje me kërkesat e legjisllacionit në fuqi;

neni 22, pika 5, e cila ndër të tjera përcaktohet se:

Kontrollet pas faktit nuk kryhen nga personat përgjegjës apo personat që marrin pjesë në kontrollet para faktit.

Rregulloren e brendshme TIP të Prefektit të Qarkut Vlorë miratuar me urdhrin nr. 175, datë 09.07.2020 nga Ministri i Brendshëm, dërguar me shkresën nr. 3825/2prot, datë 16.07.2020, administruar nga PFV me praktikën nr. 763 prot, datë 20.07.2020, neni 14 pika i),

Kryen veprimet financiare në zbatim të planit të buxhetit dhe shpenzimet faktike progresive përmes institucioneve të shpenzimeve.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi: titullari i AK z. F.M dhe znj. L. S.

Nga verifikimi i regjistrimit të realizimeve dhe dosjeve të marra për shqyrtim, për vitin 2022 u audituan 6 procedura me fond limit në shumën 2,576,666 lekë dhe vlerë kontrate në shumën 1,874,342 lekë, ndërsa për vitin 2023 u audituan 8 procedura me fond limit në shumën 1,614,815 lekë dhe vlerë kontrate në shumën 1,285,222 lekë, ose në total në masën 88% të fondeve të prokuruar, bashkëlidhur aneksi nr. 1, për procedurat e audituara.

Nga auditimi i dokumentacionit dhe të dhënave të vëna në dispozicion u konstatua se:

Në 3 procedura prokurimi rezulton të jenë shmangur zhvillimi i procedurave standard të prokurimit blerje me vlerë të vogël me shpallje në buletin e APP dhe nuk janë kryer nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimeve, duke copëzuar fondet dhe duke kryer procedura blerje me vlera të vogla në mënyrë shkresore sipas modelit për shpenzimet deri në 100,000 lekë, konkretisht:

-Në 3 procedura në shumën totale të fondit limit në vlerën 233,333 lekë pa Tvsh, dhe vlerë kontrate në shumën 186,167 lekë, procedura të cilat duhet të kryheshin me procedurë normale të blerjeve me vlera të vogla pasi kanë objekt prokurimi të ngjajshëm dhe gjenden lehtësisht në treg nga OE që i ofrojnë këto mallra apo shërbime konkretisht:

1. Procedura me objekt “Blerje softe me karakter të përgjithshëm” me fond limit 50,000 lekë pa Tvsh dhe vlerë kontrate 45,000 lekë pa Tvsh me OE fitues “F S”,

2. Procedura me objekt “Materiale për funksionin e pajisjeve të zyrës (tonera për fotokopje)” me fond limit 83,333 lekë pa Tvsh dhe vlerë kontrate 42,500 lekë pa Tvsh, e ndarë në dy fatura shpenzimi e konkretisht njëra me OE “F. S” me vlerë 28,500 dhe tjetra me “Sh L” me vlerë 14,000 lekë.

3. Procedura me objekt “Mirëmbajtje e pajisjeve kompjuterike” me fond limit 100,000 lekë pa Tvsh dhe vlerë kontrate 98,667 lekë pa Tvsh, e ndarë në 4 fatura shpenzimi e konkretisht 1. me “Sh L” me vlerë 43,000 lekë, 2. me “Sh L” me vlerë 10,000 lekë, 3. me OE “F S” me vlerë 15,667 lekë dhe 4. me “Sh L” me vlerë 30,000 lekë.

-Nga sa më sipër rezulton se të dhënat e regjistrimit të parashikimeve të miratuara nga Titullari i Autoritetit kontraktor, nuk janë siguruar në mënyrë të tillë që, të analizoheshin sipas nevojave të paraqitura, me qëllim shmangien e copëzimit të fondeve për grupmallrat/shërbimet e ngjajshme dhe kryerjen e tyre me procedura të rregullta konkurruese sipas kufijve monetarë. Pra, nëse do të përlllogariteshin drejt nga personat përgjegjës të prokurimeve të dhënat e administruara, procedurat e blerjeve me vlera të vogla ku natyra dhe sasia e planifikuar kanë të njëjtin funksion apo të ngjajshëm këto procedura do të kryheshin me procedura normale prokurimi nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimeve.

Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenin 11, pika 5 në të cilën citohet se:

Asnjë kontratë publike nuk mund të ndahet për shmangien e kufirit monetar apo të procedurave, të parashikuara nga LPP-ja.

neni 12, “Metoda të zbatueshme në përllogaritjen e vlerës së kontratës, pika 3, sipas të cilit:

Përzgjedhja e metodës që përdoret për përllogaritjen e vlerës së prokurimit nuk bëhet me qëllim për ta përjashtuar atë nga fusha e zbatimit të LPP-së dhe këtyre rregullave, apo për të copëzuar kontratën me qëllim shmangien e procedurave sipas kufijve monetarë.

nenin 56, pika 2 paragrafi i II-të, sipas të cilit:

2. Autoriteti/enti kontraktor planifikon natyrën, sasi të dhe llojet e kontratave, që do të prokurohen me këtë procedurë prokurimi.

Për përcaktimin e kufirit monetar për këtë procedurë llogariten grup - mallrash apo shërbimesh të ngjashme, të cilat zakonisht prokurohen njëherësh dhe, në asnjë rast, nuk duhet të ndahen për përdorimin e kësaj procedure.

Udhëzimin nr. 05, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, pika 3 në të cilën citohet ndër të tjera se:

Kjo lloj procedure do të përdoret për blerjen e një grupi mallrash, kryerjen e shërbimeve apo punëve të ngjajshme, që kanë të njëjtin funksion kryesor apo kanë të njëjtin emërtim në planin e shpenzimeve. Përdorimi i kësaj procedure nuk duhet parë si mundësi për shmangien e procedurave konkurruese të prokurimit. Në asnjë rast, autoritetet kontraktore ose entet kontraktore nuk duhet të prokurojnë veçmas mallra, shërbime apo punë që përfshihen në një grup për shkak të ngjajshmërisë së tyre, apo për shkak të funksionit kryesor.

Nenin 74 “Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit”, pika 3 ku ndër të tjera citohet se:

a) Sigurimin e të dhënave të nevojshme nga strukturat përkatëse në institucion dhe përgatitjen e regjistrit të parashikimit dhe regjistrit të realizimit të procedurave të prokurimit publik;
b) Përzgjedhjen e llojit të procedurës së prokurimit (dhe justifikimin, kur është rasti) kur kjo nuk bëhet nga struktura të tjera të posaçme;

Në lidhje me veprimet dhe mosveprimet e konstatuara më sipër, të cilat bien në kundërshtim me LPP, ngarkohen me përgjegjësi: znj. L. S, znj. T. T, znj. I. D, në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël si dhe, referuar nenit 21 të LPP, z. F. M, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor.

Në lidhje me fazën paraprake dhe dokumentacionin e nevojshëm për vijimin e procedurës:

Nga procedurat e audituara rezulton se, nga Komisioni i Prokurimit për blerjet e vogla janë përcaktuar fondet limite duke hartuar procesverbalet përkatës bazuar në testimin e tregut, sipas mesatares së 3 ofertave të paraqitura.

Si konkluzion, në rastin konkret, komisioni për përcaktimin e fondit limit ka vepruar në përputhje me nenin 34 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe nenin 12, 13 dhe 76, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

AK (NjP) në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve”:

- Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, dosjeve fizike, procesverbaleve “për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikimi” dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatua se, nga njësia e prokurimit, në lidhje me procedurat e audituara, përgjithësisht kriteret e pjesëmarrjes (kërkesat e veçanta të kualifikimit) janë përcaktuar në

përputhje me kërkesat e përcaktuara në Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

AK (personi përgjegjës) në lidhje me “Administrimin e Dokumentacionit”:

Referuar procedurave të audituara, konstatohet dosjet fizike të prokurimit, të cilat ndër të tjera përmbajnë procesverbalet për përgatitjen e procesit të prokurimit, dokumentet e tenderit, procedurat e përcaktimit të fituesit, procesverbalet e mbledhjeve etj., janë të pajisura me inventarin e brendshëm të dosjes.

Grupi i auditimit konstaton se, në dosjen e prokurimit nuk janë administruar, në përputhje me kërkesat e LPP-së, të gjitha deklaratat e anëtarëve të komisionit mbi konfliktin e interesave, mosveprim i cili bie në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 13, pika 5, ku ndër të tjera përcaktohet: “Në çdo rast, duhet të shmanget rreptësisht çdo konflikt interesi, apo edhe shfaqja e një konflikti interesi, në marrëdhëniet e punonjësit të angazhuar në procesin e prokurimit dhe operatorit ekonomik. Zyrtarët e përfshirë në studimin e tregut duhet të plotësojnë deklaratën për situatën e konfliktit të interesit”; neni 73, pika 4, ku ndër të tjera përcaktohet: “Çdo nëpunës, që merr pjesë në procesin e prokurimit, nënshkruan një deklaratë, përmes së cilës deklaron se nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit”;

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi: znj. L. S, znj. T. T, znj. I. D, në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël si dhe, referuar nenit 21 të LPP, z. F. M, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor.

Observacion:

Për sa më sipër subjekti i audituar nëpërmjet adresës së emailit, ka paraqitur komente dhe shpjegime për konstatimet në lidhje Projektraportin, datë 26.07.2024 konkretisht, nga z. F. M, është paraqitur observacion lidhur me;

Pretendimi i subjektit:

-Konstatimet e bëra nga grupi i auditimit në lidhje me planifikimin e fondeve, caktimin e personit përgjegjës për prokurimet, se misioni i Prefektit nuk ka lidhje me misionin e administratës dhe nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi. Pretendohet se është caktuar personi përgjegjës për prokurimet me urdhër të brendshëm. Pretendohet për procedurë shërbimesh dhe jo blerje mallrash në lidhje me copëzimin e fondeve. Gjithashtu pretendohet se nëpunësi zbatues nuk është në konflikt interesi për marrjen pjesë në procedurat e prokurimit, etj.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me observacionet e dërguara sqaron se;

-Për sa i përket pretendimeve të obsrvuesve sqarojmë se përgjegjësia e Prefektit të Qarkut nuk i nënshtrohet vetëm ligjit organik të këtij institucioni por edhe një kuadri ligjor më të gjerë, sikurse janë cituar në konstatimet e grupit të auditimit. Gjithashtu sjellim në vëmendjen e pretenduesit se nuk na është vënë asnjë dokumentacion në lidhje me caktimin e personit përgjegjës për prokurimet dhe nuk është dërguar në APP asnjë shkresë zyrtare apo email për këtë qëllim. Sa i përket pretendimeve për procesin e prokurimeve, nuk paraqitet asnjë provë apo dokumentacion shterues për konstatimet e bëra nga grupi i auditimit. Caktimi i nëpunësit zbatues në procedura prokurimi shprehet qartë në referencat ligjore roli dhe funksioni i këtij pozicioni sikurse dhe përcaktimet e bëra nga kuadri ligjor rregullator nga grupi në lidhje me konstatimet për këtë çështje.

Për këto arsye grupi i auditimit nuk merr në konsideratë pretendimet e paraqitura në hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

2.3 Auditim mbi verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore.

Në zbatim të pikës 3 të programit të auditimit nr. 564/2 prot., datë 31.05.2024, u shqyrtua dokumentacioni mbi verifikimet nga ana ligjore e vendimeve të Këshillave Bashkiak, të vetëqeverisjes vendore brenda afatit kohor dhe verifikimet në vend të vendimeve të Këshillave Bashkiak për periudhën 01.01.2022-31.12.2023.

Nga praktikat e audituara me përzgjedhje nga grupi i auditimit “mbi verifikimin e ligjshmërisë së akteve”, u konstatuan disa parregullsi në shkëlqe apo mospërputhje të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”; Ligjit nr.107/2016, “Për Prefektin e Qarkut”; Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”; Rregullores së brendshme të funksionimit të Institucionit të Prefektit të miratuar me urdhër të MB nr.175, datë 09.07.2020.

Në analizë dhe referuar bazës ligjore të sipërcituar, parapraakisht, theksojmë se:

Marrëdhëniet e Prefektit të Qarkut me organet e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore (NJVV) bazohen në ligjin nr.107/2016, “Për Prefektin e Qarkut” dhe në ligjin nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”.Në ushtrim të funksionit të tij, prefekti ka përgjegjësi të shprehur për:

-“Verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”, e përcaktuar kjo në pikën (a) të nenit 16 të ligjit nr. 107/2016, “Për Prefektin e Qarkut”;

-“Verifikimin e ligjshmërisë së akteve me karakter normativ drejtpërdrejt dhe sistematikisht në organin e njësive të vetëqeverisjes vendore, kur nuk përcaktohet ndryshe në akte të tjera ligjore, jo më pak se një herë në 3 muaj”, e përcaktuar kjo në nenin 17 të ligjit nr. 107/2016, “Për Prefektin e Qarkut”;

Grupi i auditimit thekson se objekt i veprimtarisë së prefektit janë aktet me karakter normativ dhe jo ato me karakter individual. Përkufizimi i secilit prej tyre është i përcaktuar në nenin 3 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, konkretisht si më poshtë:

“Akti administrativ individual” është çdo shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, **kundrejt një apo më shumë subjektsh të përcaktuara individualisht të së drejtës**, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete;

“Akt normativ nënligjor” është çdo shprehje e vullnetit nga një organ publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, **që rregullon një apo disa marrëdhënie juridike, duke vendosur rregulla të përgjithshme të sjelljes dhe nuk është i shteruar në zbatimin e tij.**

Për zbatimin e kësaj përgjegjësie, institucioni prefektit shprehur nëpërmjet strukturës përgjegjëse që është sektori juridik, i cili, sipas urdhrimit të Kryeministrit nr. 14, datë 12.01.2016 “Për miratimin e strukturës e organikës të administratës së Prefektit të Qarkut Vlorë”, është i miratuar me 4 punonjës (1 përgjegjës sektori dhe 3 specialistë) me status të nëpunësit civil, organikë e plotësuar. Ky sektor, si strukturë përgjegjëse, kasi detyrë kryesore “verifikimin e ligjshmërisë së akteve të nxjerra nga organet e njësive të vetëqeverisjes vendore dhe përpilon dokumentacionin e nevojshëm duke u shprehur për ligjshmërinë e këtyre akteve, brenda afateve kohore”, e përcaktuar kjo në nenin 15 të rregullores së brendshme të funksionimit të Institucionit të Prefektit të miratuar me urdhër të MB nr.175, datë 09.07.2020.

Në thelb, baza ligjore mbi të cilën do të duhet të verifikohet ligjshmëria e akteve të nxjerra nga organet e njësive të vetëqeverisjes vendore, përcaktohet në nenin 109 “Paligjshmëria e aktit

administrativ” të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”. Konkretisht, kjo dispozitë ligjore përcakton se një akt administrativ është i paligjshëm nëse:

- a) organi publik që e ka nxjerrë ka vepruar në mungesë të kompetencës;
- b) është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative;
- c) është në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ;
- ç) është nxjerrë në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas pikës 2, të nenit 4, të këtij Kodi;
- d) është në kundërshtim me ligjin material;
- dh) është rezultat i diskrecionit të ushtruar në mënyrë jo të ligjshme; apo
- e) nuk është në përputhje me parimin e proporcionalitetit”.

Referuar Rregullores së Brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 nenit 4 (aneksi I) “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i qarkut”, ndër të tjera, rezulton se, Prefekti i qarkut bën verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhërësive me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore, pa penguar zbatimin e tyre, duke respektuar procedurën e mëposhtme:

a. Çdo organ i njësisë së vetëqeverisjes vendore është i detyruar të depozitojë te prefekti i qarkut të gjitha aktet me karakter normativ, brenda 10 ditëve nga data e shpalljes së tyre. Marrja bëhet nga prefekti i qarkut për aktin e depozituar nga organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore vërtetohet me regjistrimin e tij në zyrën e protokollit të prefektit. Një prej kopje e aktit i kthehet njësisë së qeverisjes vendore e vulosur me datën e dorëzimit;

b. Akti i depozituar duhet detyrimisht të shoqërohet nga dokumentet e mëposhtme:

- i. Procesverbali i mbledhjes së këshillit,
- ii. Procesverbali i dëgjësës publike, në ato raste kur kërkohet nga ligji,
- iii. Relacioni përkatës që shpjegon respektimin e procedurës ligjore,
- iv. Projektvendim,
- v. Çertifikatën e pronësisë në mungesë të saj statusin juridik nga ASHK-ja (në vendimmarrjet e pronave), plan vendosjet,
- vi. Pasqyrat përkatëse (në rastin e vendimmarrjes me karakter financiar),
- vii. Dokumentacionin përkatës sipas standardit të kërkuar (në rastin e vendimmarrjes për emergjencat civile), etj.

c. Në rast se, akti i paraqitur nuk është i shoqëruar nga dokumentacioni i nevojshëm për shqyrtimin e ligjshmërisë (i mësipërm), prefekti i qarkut ja kthen menjëherë aktin NJVV, duke e informuar se verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ do të bëhet vetëm pas paraqitjes së dokumentacionit.

d. Prefekti i Qarkut ka të drejtë të kërkojë edhe dokumente të tjera, të cilat argumentojnë ligjshmërinë e vendimmarrjes sipas natyrës së vendimmarrjes.

Nga ana tjetër, një nga kriteret kryesore që Prefekti i Qarkut duhet të mbajë në konsideratë gjatë verifikimit të ligjshmërisë së akteve të organeve të vetëqeverisjes vendore janë detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak, të cilat janë të mirëpërcaktuara në nenin 54 të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” dhe janë konkretisht si vijon:

- a) zgjedh nga përbërja e vet komisionet e këshillit dhe miraton rregulloren e brendshme të funksionimit të vet;
- b) zgjedh, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore, kryetarin dhe zëvendëskryetarët e këshillit dhe i shkarkon ata;

- c) emëron dhe shkarkon sekretarin e këshillit bashkiak;
- ç) miraton nivelin e pagave e të shpërblimeve të punonjësve e të personave të tjerë, të zgjedhur ose të emëruar, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- d) miraton aktet e themelimit të ndërmarrjeve, shoqërive tregtare, si dhe të personave të tjerë juridikë që krijon vetë ose me të cilët është bashkëthemelues;
- dh) miraton buxhetin dhe ndryshimet e tij. Në vendimin për miratimin e buxhetit miraton, gjithashtu, edhe numrin e maksimal të punonjësve të bashkisë, si dhe të njësive e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë;
- e) miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve;
- ë) organizon dhe mbikëqyr kontrollin e brendshëm të bashkisë;
- f) vendos për taksat e tarifat vendore, sipas këtij ligji dhe legjislacionit tjetër në fuqi;
- g) vendos për marrjen e kredive dhe shlyerjen e detyrimeve ndaj të tretëve;
- gj) vendos për krijimin e institucioneve të përbashkëta me njësi të tjera të vetëqeverisjes vendore, përfshirë subjektin e kompetencave të përbashkëta ose me persona të tretë;
- h) vendos për fillimin e procedurave gjyqësore për çështje të kompetencës së vet;
- i) zgjedh përfaqësuesit e këshillit bashkiak në këshillin e qarkut, të cilët, në jo më pak se 50 për qindtë tyre, duhet t'i përkasin gjinisë më pak të përfaqësuar;
- j) vendos për dhënien ose deklarimin e mbarimit të mandatit të këshilltarit, kur ekzistojnë kushtete parashikuara në nenin 49 të këtij ligji;
- k) miraton norma, standarde e kritere për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë atij me ligj, si dhe për mbrojtjen e garantimin e interesit publik;
- l) vendos për simbolet e bashkisë;
- ll) vendos për emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e bashkisë;
- m) jep tituj nderi dhe stimuj;
- n) vendos për rregullat, procedurat dhe mënyrat e realizimit të funksioneve të deleguara, në bazë dhe për zbatim të ligjit, me të cilin bëhet ky delegim të bashkia”.

Një tjetër element i rëndësishëm që Prefekti i Qarkut duhet të mbajë në konsideratë gjatë verifikimit të ligjshmërisë së akteve të organeve të vetëqeverisjes vendore është mënyra e votimit të këshillit bashkiak për vendimet të cilat kanë objekt elementët e përcaktuar në nenin 54. Mënyra e votimit të këshillit bashkiak është e përcaktuar në nenin 55 të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, konkretisht si vijon:

1. Votimi në këshill bëhet i hapur ose i fshehtë. Këshilli, me kërkesë të jo më pak se 1/3 të anëtarëve të tij, vendos për rastet kur votimi bëhet i fshehtë. Votimi i buxhetit dhe i akteve të tjera financiare që kanë lidhje me të bëhet kurdoherë i hapur.
2. Vendimet e këshillit merren me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të këshillit, me përjashtim të rastit kur ky ligj parashikon ndryshe.
3. Vendimet merren me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të këshillit për rastet e parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “d”, “dh”, “f”, “g”, “gj”, “i” dhe “j”, të nenit 54, të këtij ligji.
4. Vendimet merren me jo më pak se tre të pestat e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit për rastin e parashikuar në shkronjën “e”, të nenit 54, të këtij ligji.

5. Në rastet e votimit për kryetarin, zëvendës-kryetarin dhe sekretarin e këshillit, kur nuk sigurohet shumica e kërkuar, votimi ribëhet midis dy kandidatëve që në raundin e parë kanë fituar numrin më të madh të votave. Në këtë rast fitues shpallet kandidati që ka numrin më të madh të votave dhe, nëse votat janë të barabarta, fituesi caktohet me short.

6. Aktet e këshillit shpallen brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre dhe hyjnë në fuqi 10 ditë pas shpalljes. Aktet me karakter individual hyjnë në fuqi në datën e njoftimit të tyre subjekteve që përfshihen në to”.

-Mbi verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore, në zbatim të pikës (a) të nenit 16 të ligjit nr. 107/2016, “Për Prefektin e Qarkut”.

Me ndarjen e re administrative në territorin e Qarkut Vlorë veprojnë Bashkitë Vlorë, Selenicë, Himarë, Sarandë, Delvinë, Finiq, Konispol dhe Këshilli i Qarkut.

Në mënyrë të përmbledhur, nga të dhënat mbi verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore, nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Vlorë, për periudhën objekt auditimi 01.01.2022-31.12.2023, situata paraqitet si më poshtë vijon:

Nga auditimi i dokumentacionit për periudhën 01.01.2022-31.12.2023 rezulton senë protokollin e institucionit janë depozituar (të hyra) gjithsej **793** akte administrative, nga të cilat janë konfirmuar për bazueshmëri ligjore **778** vendime të këshillave bashkiakë, janë kthyer për pabazueshmëri ligjore **15** vendime. Sipas periudhave vjetore dhe njësisive vendore, statusi trajtimit të vendimeve nga Institucioni i Prefektit (akteve administrative) për vitin 2022 dhe 2023, të paraqitura si më poshtë:

Viti 2022

Nr.	Njësi të vetëqeverisjes vendore	Akte	Të konfirmuara	Të pa konfirmuara
1	Këshilli i Qarkut Vlorë	24	24	0
2	Bashkia Vlorë	80	77	3
3	Bashkia Himarë	55	51	4
4	Bashkia Selenicë	44	42	2
5	Bashkia Sarandë	65	64	1
6	Bashkia Konispol	29	28	1
7	Bashkia Delvinë	40	40	0
8	Bashkia Finiq	63	63	0
	TOTALI	400	389	11

Burimi: Sektori Juridik, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Viti 2023

Nr.	Njësi të vetëqeverisjes vendore	Akte	Të konfirmuara	Të pa konfirmuara
1	Këshilli i Qarkut Vlorë	21	21	
2	Bashkia Vlorë	89	88	1
3	Bashkia Himarë	57	56	1
4	Bashkia Selenicë	35	33	2
5	Bashkia Sarandë	71	71	
6	Bashkia Konispol	33	33	
7	Bashkia Delvinë	34	34	
8	Bashkia Finiq	53	53	
	TOTALI	393	389	4

Burimi: Sektori Juridik, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se, një pjesë e vendimeve të këshillave bashkiakë (pjesa më e madhe) janë akte me karakter individual, kryesisht me objekt (ndihma ekonomike,

fondi 6%, dhënie tituj nderi, emërtim rrugësh, bulevardi sheshi, dhënie/heqje mandati, listë përfitim bursash, zgjedhje kryetar/zv kryetar apo sekretar këshilli etj.), **akte të cilat nuk duhet të përcillen për konfirmim ligjshmërie pranë prefektit pasi marrin fuqi dëten e njoftimit të subjektit/subjekteve që i drejtohet.**

Në mënyrë të detajuar, për një pjesë të praktikave, të audituara me përzgjedhje mbi bazë risku nga grupi i auditimit, për secilin organ vendor për vitet (2022-2023), nga të dhënat mbi verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore, situata paraqitet si më poshtë vijon:

Bashkia Himarë (2022-2023)

Për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2023, Bashkia Himarë, rezulton senë protokollin e institucionit janë depozituar (të hyra) gjithsej **112** akte administrative, nga të cilat janë konfirmuar për bazueshmëri ligjore **107** vendime të këshillit bashkiak, janë kthyer për pabazueshmëri ligjore **5** vendime.

Grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej për verifikimin e ligjshmërisë së akteve me karakter normativ të depozituara në Prefektin e Qarkut Vlorë nga Bashkia Himarë, përzgjodhi për auditim **23** Vendime të Këshillit Bashkiak (të konfirmuara) dhe **5** vendime (të pa konfirmuara) për periudhën 01.01.2022-31.12.2023, të paraqitura si më poshtë:

VKB (të konfirmuara) Bashkia Himarë

Nr. Rendor	Objekti i vendimit	Konfirmuar (po/jo)	Nr. Prot/Dt. e paraqitjes	Nr. Prot/Dt. e dhënies së verifikimit
1	Vendimi nr. 4 datë 28.01.2022 “Për përjashtimin nga taksa e ndikimit në infrastrukturë të disa projekteve të infrastrukturës publike ku Bashkia Himarë është bashkëfinancues dhe përfitues”.	PO	Nr.508.Prot, datë 01.02.2022	Nr. 107/1.Prot, datë 08.02.2022
2	Vendimi nr. 10 datë 24.02.2022 “Për miratimin e tavanëve të shpenzimeve buxhetore të programit buxhetor afatmesëm 2023-2025”.	PO	Nr.1034.Prot, datë 24.02.2022	Nr. 185/2.Prot, datë 02.03.2022
3	Vendimi nr. 11 datë 24.02.2022 “Për miratimin e dhënies në përdorim të sipërfaqes prej 210 m2 për ndërtimin e stacionit “V”, SH.A. për vënie antene si dhe linjë elektrike në territorin e Bashkisë Himarë”.	PO	Nr.1035.Prot, datë 24.02.2022	Nr. 185/2.Prot, datë 02.03.2022
4	Vendimi nr. 26 datë 27.05.2022 “Për dhënien e miratimit për riorganizimin e Shoqërisë Aksionere “Ujësjellës Kanalizime Himarë SH.A”.	PO	Nr.2614.Prot, datë 30.05.2022	Nr. 531/1.Prot, datë 10.06.2022
5	Vendimi nr. 33 datë 27.05.2022 “Për dhënie me qira të sipërfaqes së zënë me ndërtime prej 5.1. HA, në ngastrën nr.51 ekonomia pyjore “Mali i çikës Himarë” për instalim të një projekti fotovoltai, shoqërisë N P sh.p.k”	PO	Nr.2621.Prot, datë 30.05.2022	Nr. 531/1.Prot, datë 10.06.2022
6	Vendimi nr. 34.datë 27.05.2022 “Për shprehjen e pëlqimit në parim për dhënien me qira shoqërisë “K A E” sh.p.k të një sipërfaqjeje prej 10000 m2, në ngastrën nr.7, ekonomi pyjore Gjomoll”	PO	Nr.2622.Prot datë 30.05.2022	Nr. 531/1.Prot, datë 10.06.2022
7	Vendimi nr. 35 datë 05.07.2022 “Për miratimin e ndryshimeve buxhetore qershor 2022 dhe PBA 2023-2025”.	PO	Nr.3252.Prot datë 06.07.2022	Nr.643/1.Prot datë 20.07.2022
8	Vendimi nr. 48 datë 22.09.2022 “Për disa ndryshime në vendimin nr.22, datë 28.04.2022 “Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë Himarë për vitin 2022”.	PO	Nr.4268.Prot.datë 22.09.2022	Nr. 915/2.Prot.datë 03.10.2024
9	Vendimi nr. 50 datë 24.10.2022 “Për disa ndryshime në vendimin nr.22, datë 22.09.2022 “Për miratimin e	PO	Nr.4822.Prot.datë 24.10.2022	Nr. 992/1.Prot, datë 28.10.2022

	<i>nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë Himarë për vitin 2022</i> ".			
10	Vendimi nr. 53 datë 24.10.2022 "Për dhënie me qira të sipërfaqes prej 6 HA, në ngastrën nr.5, ekonomia pyjore "Gjomollë", për instalim të një projekti fotovoltaik, shoqërisë S.S. E", sh.p.k."	PO	Nr.4825.Prot.datë 24.10.2022	Nr.992/1.Prot, datë 28.10.2022
11	Vendimi nr. 54 datë 24.10.2022 "Për miratimin në parim të kërkesës së shoqërisë "S. S. E", sh.p.k për dhënie me qira të sipërfaqes prej 6 HA, në ngastrës nr. 5, ekonomi pyjore "Gjomollë", për instalim të një projekti fotovoltaik".	PO	Nr.4828.Prot, datë 24.10.2022	Nr. 992/1.Prot, datë 28.10.2022
12	Vendimi nr. 4 datë 27.01.2023 "Për Bashkëfinancimin e restaurimit të banesave shumë të amortizuara të familjeve në nevojë në zbatim të projektit të sistemit social për vitin 2023".	PO	Nr.468.Prot., datë 27.01.2023	Nr. 130/1.Prot, datë 01.02.2023
13	Vendimi nr.7 datë 27.02.2023 "Për miratimin e buxhetit faktik të bashkisë për vitin 2023".	PO	Nr.947.Prot., datë 27.02.2023	Nr. 226/1.Prot, datë 09.03.2023
14	Vendimi nr. 12 datë 27.02.2023 "Për disa shtesa në vendimin nr.4 datë 27.01.2023 të Këshillit Bashkiak Për Bashkëfinancimin e restaurimit të banesave shumë të amortizuara të familjeve në nevojë në zbatim të projektit të sistemit social për vitin 2023".	PO	Nr.978.Prot., datë 27.02.2023	Nr. 226/1.Prot, datë 09.03.2023
15	Vendimi nr. 14 datë 30.03.2023 "Për miratimin e buxhetit faktik mars 2023".	PO	Nr.1572.Prot., datë 30.03.2023	Nr. 364/1.Prot, datë 24.04.2023
16	Vendimi nr. 18 datë 31.03.2023 "Për miratimin në parim të kërkesës së fermerit z. Th B për kullotje për një afat 10-vjeçar të sipërfaqes prej 1 HA, në ngastrën nr.95, ekonomi pyjore "Papadhi-Cipin".	PO	Nr.1565.Prot., datë 03.04.2023	Nr. 364/1.Prot, datë 24.04.2023
17	Vendimi nr. 19 datë 31.03.2023 "Për miratimin në parim të kërkesës së fermerit z. Z B për kullotje për një afat 10-vjeçar të sipërfaqes prej 114 HA, në ngastrën nr.10, ekonomi kullimore Dhërmi-Vuno si dhe 86 ha në ngastrën nr.7 në ekonomi kullimore Pilur-Qeparo".	PO	Nr.1566.Prot., datë 03.04.2023	Nr. 364/1.Prot, datë 24.04.2023
18	Vendimi nr. 22 datë 28.04.2022 "Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë Himarë për vitin 2022buxhetit faktik mars 2023".	PO	Nr.2079.Prot., datë 28.04.2022	Nr. 412/1/1.Prot, datë 06.05.2022
19	Vendimi nr. 23 datë 11.04.2023 "Për miratimin e dokumentit të rishikimit të planit të përgjithshëm vendor Bashkia Himarë me procedurë të thjeshtuar".	PO	Nr.1723.Prot., datë 11.04.2023	Nr. 375/1.Prot, datë 20.04.2023
20	Vendimi nr. 33 datë 28.07.2023 "Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Himarë".	PO	Nr.3542.Prot., datë 31.07.2023	Nr. 717/1.Prot, datë 01.08.2023
21	Vendimi nr. 38 datë 22.12.2023 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 56, datë 24.11.2022 për miratimin e numrit të përgjithshëm dhe nivelin e pagave të punonjësve të Bashkisë Himarë për vitin 2023".	PO	Nr.3623.Prot., datë 07.08.2023	Nr. 748/1.Prot, datë 11.08.2023
22	Vendimi nr. 54 datë 22.12.2023 "Për përcaktimin e numrin maksimal të të punonjësve të policisë bashkiak Himarë".	PO	Nr.5862.Prot., datë 26.12.2023	Nr. 1088/1.Prot, datë 29.12.2023
23	Vendimi nr. 8 datë 27.02.2023 "Për miratimin në parim të kërkesës së shoqërisë "I. D" sh.p.k për dhënie me qira të sipërfaqes prej 5.7HA, në ngastrën nr.5, ekonomi pyjore "Gjomollë për insatlimin e një projekti fotovoltaik".	PO	Nr.975, Prot., datë 27.02.2023	Nr. 226/1.Prot, datë 09.03.2023

Burimi: Sektori Juridik, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Më hollësisht vendimet trajtuar si më poshtë vijon:

-Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se, 23 Vendimet e Këshillit Bashkiak (të konfirmuara), kanë bashkëlidhur projekt-vendimin si dhe relacionin përkatës por nuk dokumentohet që të jenë shoqëruar me procesverbalin e mbledhjes, në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 *“Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”* aneksi nr.1, neni 4, pika b.

Në kushtet si më sipër, bazuar në pikën “c” të së njëjtës dispozitë, prefekti i qarkut duhet të kthente menjëherë aktin NJVV, duke e informuar se verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ do të bëhet vetëm pas paraqitjes së plotë të dokumentacionit.

-Nga auditimi i dokumentacionit 23 Vendimeve të Këshillit Bashkiak (të konfirmuara), rezulton se 8 prej tyre (sipas nr. rendor, në tabelën e mësipërme: 3, 5, 6, 10, 11, 16, 17, 23) janë vendime me karakter individual dhe jo normativ.

Në kushtet si më sipër, duke vlerësuar dhe dhënë vlerësim pozitiv për ligjshmërinë e tyre, prefekti i qarkut Vlorë ka vepruar në mungesë të kompetencës, për sa kohë neni 16 dhe 17 i ligjit nr. 107/2016 *“Për Prefektin e Qarkut”* i njeh institucionit të Prefektit kompetencën për vlerësimin e ligjshmërisë vetëm për aktet me karakter normativ.

-Nga auditimi i dokumentacionit të Vendimeve të Këshillit Bashkiak (të konfirmuara), për vendimet me karakter individual, përveçse Prefekti ka konfirmuar ligjshmërinë e tyre në mungesë të kompetencës, e ka kryer atë edhe pse tre nga vendimet rezultojnë në kundërshtim me frymën e nenit 91 të Kodit Zgjedhor, sipas të cilit *“Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndalohej propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensioneve, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve, etj., përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore”* (sipas nr. rendor, në tabelën e mësipërme: 16, 17, 23).

-Nga auditimi i Vendimit nr. 4 datë 28.01.2022 *“Për përjashtimin nga taksa e ndikimit në infrastrukturë të disa projekteve të infrastrukturës publike ku Bashkia Himarë është bashkëfinancues dhe përfitues”*, rezulton se vendimi është konfirmuar në mospërputhje me nenin (54) të Ligjit nr. 139/2015 *“Për vetëqeverisjen vendore”* i cili përcakton detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak. Gjithashtu vendimi nuk është në përputhje me nenin 46, pika 3 të Ligjit nr. 107/2014 *“Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”*, sipas të cilit: *“Autoriteti vendor i planifikimit nuk e paguan taksën e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja për zhvillimet e veta me fonde publike”*.

Nga auditimi i Vendime të Këshillit Bashkiak, të cilat nuk janë konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë, situara paraqitet si më poshtë:

VKB (të pa konfirmuara) Bashkia Himarë

Nr. Rendor	Objekti i vendimit	Konfirmuar (po/jo)	Nr. Prot/Datav erifikimit	Motivacioni	Rishqyrtuar/konfirmuar
1	Vendimi nr. 12, datë 24.02.2022 <i>“Për miratim në parim të dhënies me qira të ish-godinës së shkollës 9-vjeçre “Hysen Cino” në Njësinë Administrative Horë-Vranisht”</i> .	JO	Nr.185/2.Prot, datë 02.03.2022	Nuk është në përputhje me ligjin nr. 69/2012 mungon urdhëri i ministrit	JO

2	Vendimi nr. 17 datë 30.03.2022 “Për dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës për përfundimin e procesit të kalimit të pronave së trojeve të shtetasve subjekt të V.K.M nr. 329, datë 22.05.2019 për efekt regjistrimi”.	JO	Nr.305/1.Pr ot, datë 11.04.2022	Nuk është në përputhje me pikën 6te V.K.Mnr. 329/2019 Mungon dokumentacioni i plotë	JO
3	Vendimi nr. 45 datë 22.09.2022 “Për dhënie me qira të sipërfaqes të zënë me ndërtime prej 6 HA në ngastrën nr.5 ekonomi pyjore “Gjomollë” për instalim të një projekti fotovoltaiqshoqërisë “S S E”, sh.p.k”.	JO	Nr.915/2.Pr ot.datë 03.10.2022	Nuk është respektuar neni 22 i udhëzimit nr.1 datë 09.06.2016, si dhe neni 18, dhe 54, pika ç e ligjit nr.139/2015	PO
4	Vendimi nr. 50 datë 30.10.2023 “Për miratimin e procesit të zgjedhjes të kryesisë dhe miratimin e kryetarëve të fshatrave në Bashkinë Himarë”.	JO	Nr.953 prot., datë 09.11.2023	Mungesë dokumentacioni	JO
5	Vendimi nr. 47 datë 22.09.2022 “Për miratimin në parim të kërkesës së shoqërisë “S S E”, sh.p.k për dhënien me qira të sipërfaqes prej 6 HA, në ngastrës nr.5,6, ekonomi pyjore “Gjomollë”, për instalim të një projekti fotovoltaiq”.	JO	Nr.915/2Pr ot, datë03.10.2022	Nuk është respektuar neni 22 i udhëzimit nr.1 datë 09.06.2016, si dhe neni 18, dhe 54, pika ç e ligjit nr.139/2015	PO

Burimi: Sektori Juridik, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se, 4 nga 5 vendimet e të kthyera për pabazueshmëri ligjore nuk janë rishqyrtuar nga njësia vendore dhe nuk janë paraqitur në institucionin e Prefektit në mospërputhje kjo të kërkesave të nenit 16 pika 2 germa b, e ligjit nr.107/2016 “Për prefektin e Qarkut”, në të cilin përcaktohet se:

“Prefekti i qarkut bën verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore, pa penguar zbatimin e tyre, duke respektuar procedurën, Për çdo akt të regjistruar, prefekti i qarkut **detyrohet** të shprehet për ligjshmërinë e tij, brenda 10 ditëve nga data e regjistrimit. Në rastet kur vëren papajtueshmëri ligjore të aktit, prefektit të qarkut i **lind e drejta t’ia kthejë atë organit përkatës** të njësisë së vetëqeverisjes vendore, duke argumentuar shkeljet e vërejtura. Në këtë rast, organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore **rishqyrton aktin**; Vendimi, pas rishqyrtimit të aktit të kthyer nga prefekti i qarkut, **depozitohet pranë prefektit** të qarkut me të njëjtën procedurë dhe afat sipas përcaktimit të shkronjës “a”, të kësaj pike.

Vlerësimi ligjor i përputhshmërisë ose jo të aktit sa i përket moskonfirmimit është i rregullt, i shoqëruar me relacionin përkatës të nënshkruar nga punonjësit e sektorit juridik i cili ka kryer edhe argumentimin mbi shkeljet e vërejtura.

Nga ana e institucionit nuk ka vendime të dërguara në Gjykatën Administrative për pavlefshmëri. Sa më sipër arrihet në konkluzionin se, nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Vlorë, në lidhje me vendimet e dërguara nga Këshilli Bashkiak Himarë, është dhënë vlerësim pozitiv për ligjshmërinë e vendimeve edhe në rastet kur këta të fundit:

-nuk kanë të dokumentuar që të jenë shoqëruar me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm të përcaktuar në rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”;

-janë marrë në kundërshtim me ligjin material, çka përbën shkak paligjshmërie sipas nenit 109, germa “d” të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”;

-nuk kanë qenë në kompetencën e prefektit të qarkut Vlorë, për sa kohë neni 16 dhe 17 i ligjit nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i njeh institucionit të Prefektit kompetencën për vlerësimin e ligjshmërisë vetëm për aktet me karakter normativ.

Bashkia Vlorë (2022-2023)

Për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2023, Bashkia Vlorë, rezulton se në protokollin e institucionit janë depozituar (të hyra) gjithsej **169** akte administrative, nga të cilat janë konfirmuar për bazueshmëri ligjore **166** vendime të këshillit bashkiak, janë kthyer për pabazueshmëri ligjore **3** vendime.

Grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej për verifikimin e ligjshmërisë së akteve me karakter normativ të depozituara në Prefektin e Qarkut Vlorë nga Bashkia Vlorë, përzgjodhi për auditim **17** Vendime të Këshillit Bashkiak (të konfirmuara) dhe **1** vendim (të pa konfirmuar) për periudhën 01.01.2022-31.12.2023, të paraqitura si më poshtë:
VKB (të konfirmuara) Bashkia Vlorë

Nr. Rendor	Objekti i vendimit	Konfirmuar (po/jo)	Nr. Prot/Dt. e paraqitjes	Nr. Prot/Dt. e dhënies së verifikimit
1	Vendimi nr. 34 datë 28.04.2022 “Për një ndryshim në V.K.B nr 58 datë 05.08.2020 për miratimin e kriterëve të përdorimit të intensitetit të ndërtimit”.	PO	Nr.4174/1.Prot, datë 04.05.2022	Nr.107/1.Prot, datë 08.02.2022
2	Vendimi nr. 6 datë 31.01.2022 “Për miratimin e procedurës për kontributin e sektorit privat në krijimin e fondit publik të banesave sociale që kalojë në pronësi të bashkisë Vlorë nga ndërtimet e reja”.	PO	Nr.628/1.Prot, datë 07.02.2022	Nr.185/2.Prot, datë 02.03.2022
3	Vendimi nr. 26 datë 28.03.2022 “Për miratimin e rregullores së administrimit të bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit në Bashkinë Vlorë”.	PO	Nr.2959/1.Prot, datë 29.03.2022	Nr.185/2.Prot, datë 02.03.2022
4	Vendimi nr. 60 datë 29.07.2022 “Për miratimin e orarit në të cilën lejohet gjenerimi i zhurmave gjatë sezonit turistik”.	PO	Nr.8604/1Prot, datë 08.08.2022	Nr.531/1.Prot, datë 10.06.2022
5	Vendimi nr. 61 datë 19.08.2022 “Për një shtesë në vendimin nr. 80, datë 02.12.2021 Për caktimin e disa Kundërvajtjeve administrative dhe sanksioneve që vendosen në territorin e Bashkisë Vlorë”.	PO	Nr.9103/1.Prot, datë 23.08.2022	Nr.531/1.Prot, datë 10.06.2022
6	Vendimi nr. 61 datë 19.08.2022 “Për miratimin e orarit në të cilën lejohet gjenerimi i zhurmave gjatë sezonit turistik”.	PO	Nr.8402/2.Prot datë 23.08.2022	Nr.531/1.Prot, datë 10.06.2022
7	Vendimi nr. 76 datë 30.09.2022 “Për një shtesë në vendimin nr. 80, datë 02.12.2021 Për caktimin e disa Kundërvajtjeve administrative dhe sanksioneve që vendosen në territorin e Bashkisë Vlorë”.	PO	Nr.10497/1.Prot datë 06.10.2022	Nr.643/1.Prot datë 20.07.2022
8	Vendimi nr. 95 datë 23.12.2022 “Për disa shtesa dhe saktësime në vendimin nr.79, date 02.12.2021 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore të territorin e Bashkisë Vlorë”.	PO	Nr.137051.Prot.datë 12.01.2023	Nr.915/2.Prot.datë 03.10.2024
9	Vendimi nr. 78 datë 28.09.2023 “Për dhënien e miratimit për zhvillimin e pronës”.	PO	Nr.11198/1.Prot.datë 03.10.2023	Nr.992/1.Prot, datë 28.10.2022
10	Vendimi nr. 17 datë 24.02.2023 “Për rikonstruksionin e pallatit nr.1300 në lagjen 24 Maj”.	PO	Nr.2286/1.Prot.datë 28.02.2023	Nr.992/1.Prot, datë 28.10.2022
11	Vendimi nr. 26 datë 31.03.2023 “Përmiratimin e planit vendor të manaxhimit të të integruar të mbetjeve Bashkia Vlorë”.	PO	Nr.3403/1.Prot, datë 04.04.2023	Nr.992/1.Prot, datë 28.10.2022

12	Vendimi nr. 61 datë 31.07.2023 “Për miratimin e marrëveshjes për krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta të ujësjellës-Kanalizime ndërmjet Bashkisë Vlorë, Bashkisë Selenicë, Bashkisë Himarë dhe Ministrinë së Infrastukturës dhe Energjisë”.	PO	Nr.9080/1.Prot., datë 01.08.2023	Nr.130/1.Prot, datë 01.02.2023
13	Vendimi nr. 62 datë 31.07.2023 “Për kalimin nga përdorimi në pronësi të tokës bujqësore”.	PO	Nr.9146/1.Prot., datë 01.08.2023	Nr.226/1.Prot, datë 09.03.2023
14	Vendimi nr. 70 datë 31.08.2023 “Për shtyrjen e afatit të kontratës për administrimin dhe financimin e shoqërisë Famurtari Football Club Sh.a”.	PO	Nr.10070/1.Prot., datë 31.08.2023	Nr.226/1.Prot, datë 09.03.2023
15	Vendimi nr. 93 datë 23.11.2023 “Për dhënien e mendimit për ndryshimin e nivelit të tarifave për shërbimin e funizimit me ujë të pijshëm largimin dhe përpunimin e ujrave të ndotura”.	PO	Nr.12711/2.Prot., datë 24.11.2023	Nr.364/1.Prot, datë 24.04.2023
16	Vendimi nr. 96 datë 07.12.2023 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë për vitin 2024” .	PO	Nr.14875/1.Prot., datë 07.12.2023	Nr.364/1.Prot, datë 24.04.2023
17	Vendimi nr. 48 datë 22.06.2023 “Për miratimin e korridoreve ujore për subjektet Jet Ski Dejvi dhe Jet Ski Julian”.	PO	Nr.7346/1.Prot., datë 22.06.2023	Nr.364/1.Prot, datë 24.04.2023

Më hollësisht vendimet trajtuar si më poshtë vijon:

-Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se, 17 Vendimet e Këshillit Bashkiak (të konfirmuara), kanë bashkëlidhur projekt-vendimin si dhe relacionin përkatës por nuk janë të shoqëruara me procesverbalin e mbledhjes, në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut” aneksi nr.1, neni 4, pika b.

Gjithashtu vendimi nr. 78 datë 28.09.2023 “Për dhënien e miratimit për zhvillimin e pronës”, në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020, nuk është shoqëruar me çertifikatën e pronësisë apo në mungesë të saj statusin juridik nga ASHK-ja, plan vendosjen, nisur nga fakti se në rastin konkret është një vendimmarrje mbi pronën.

Në kushtet si më sipër, bazuar në pikën “c” të së njëjtës dispozitë, prefekti i qarkut duhet të kthente menjëherë aktin NJVV, duke e informuar se verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ do të bëhet vetëm pas paraqitjes së plotë të dokumentacionit.

-Nga auditimi i dokumentacionit 17 Vendimeve të Këshillit Bashkiak (të konfirmuara), rezulton se 3 prej tyre (sipas nr. rendor, në tabelën e mësipërme: 13, 14, 17) janë vendime me karakter individual dhe jo normativ.

Në kushtet si më sipër, duke vlerësuar dhe dhënë vlerësim pozitiv për ligjshmërinë e tyre, prefekti i qarkut Vlorë ka vepruar në mungesë të kompetencës, për sa kohë neni 16 dhe 17 i ligjit nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i njeh institucionit të Prefektit kompetencën për vlerësimin e ligjshmërisë vetëm për aktet me karakter normativ.

-Nga auditimi i Vendimit nr. 6 datë 31.01.2022 “Për miratimin e procedurës për kontributin e sektorit privat në krijimin e fondit publik të banesave sociale që kalojë në pronësi të bashkisë Vlorë nga ndërtimet e reja”, rezulton se vendimi është konfirmuar në mospërputhje me nenin 19, pika 1, të Ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”, sipas të cilit: “Çdo subjekt privat që, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, aplikon për leje zhvillimi dhe ndërtimi për ndërtime me sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2 000 metra katrorë, siguron kalimin pa shpërblim të të paktën 3 për qind të sipërfaqes funksionale, me kushtet e një strehimi të përshtatshëm, në favor të fondit publik të banesave sociale. Kjo sipërfaqe, në rast pamundësie për t’u dhënë në sipërfaqen ndërtimore të

banimit që ndërtohet, mund të jepet në një sipërfaqe tjetër ndërtimore banimi. Kontrata që nënshkruhet mes palëve për kalimin e sipërfaqes ndërtimore në favor të fondit publik të banesave sociale, regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”.

Sipas dispozitës së mësipërme subjektet private janë të detyruar që të kalojnë pa shpërblim vetëm sipërfaqe funksionale ndërtimi dhe jo vlerë monetare sikundër është përcaktuar në pikën 6 të VKB nr. 6 datë 31.01.2022.

Nga auditimi i Vendime të Këshillit Bashkiak, të cilat nuk janë konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë, situara paraqitet si më poshtë:

VKB (të pa konfirmuara) Bashkia Vlorë

Nr. Rendor	Objekti i vendimit	Konfirmuar (po/jo)	Nr. Prot/Dataverifikimit	Motivacioni	Rishqyrtuar/konfirmuar
1	Vendimnr. 50, datë 01.07.2022, “Për miratimin e listës së familjeve dhe individëve, që përfitojnë banesë me kosto të ulët, nëpërmjet subvencionimit të interesave të kredive nga buxheti i shtetit”.	JO	Nr.185/2.Prot, datë 02.03.2022	Mungese dokumentacioni	JO

-Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se vendimi i kthyer për pabazueshmëri ligjore nuk është rishqyrtuar nga njësia vendore. Vlerësimi ligjor i përputhshmërisë ose jo të aktit sa i përket moskonfirmimit nuk është i rregullt, pasi referuar motivacionit të relacionit përkatës shkelja e vërejtur është “mungesë dokumentacioni”, në kushtet kur në rastin konkret kemi të bëjmë me një vendim individual dhe si i tillë jashë kompetencës së Institucionit të Prefektit të Qarkut Vlorë.

Nga ana e institucionit nuk ka vendime të dërguara në Gjykatën Administrative për pavlefshmëri. Sa më sipër arrihet në konkluzionin se, nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Vlorë, në lidhje me vendimet e dërguara nga Këshilli Bashkiak Vlorë, është dhënë vlerësim pozitiv për ligjshmërinë e vendimeve edhe në rastet kur këta të fundit:

-nuk kanë të dokumentuar që të jenë shoqëruar me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm të përcaktuar në rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”;

-janë marrë në kundërshtim me ligjin material, çka përbën shkak paligjshmërie sipas nenit 109, gërma “d” të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”;

-nuk kanë qenë në kompetencën e prefektit të qarkut Vlorë, për sa kohë neni 16 dhe 17 i ligjit nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i njeh institucionit të Prefektit kompetencën për vlerësimin e ligjshmërisë vetëm për aktet me karakter normativ.

Bashkia Selenicë (2022-2023)

Për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2023, Bashkia Selenicë, rezulton se në protokollin e institucionit janë depozituar (të hyra) gjithsej **79** akte administrative, nga të cilat janë konfirmuar për bazueshmëri ligjore **75** vendime të këshillit bashkiak, janë kthyer për pabazueshmëri ligjore **4** vendime.

Grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej për verifikimin e ligjshmërisë së akteve me karakter normativ të depozituara në Prefektin e Qarkut Vlorë nga Bashkia Selenicë, përzgjodhi për auditim **14** Vendime të Këshillit Bashkiak (të konfirmuara) dhe **4** vendime (të pa konfirmuara) për periudhën 01.01.2022-31.12.2023, të paraqitura si më poshtë:

VKB (të konfirmuara) Bashkia Selenicë

Nr. Rendor	Objekti i vendimit	Konfirmuar (po/jo)	Nr. Prot/Dt. e paraqitjes	Nr. Prot/Dt. e dhënies së verifikimit
1	Vendimi nr. 32 datë 28.04.2022 “Për dhënie konfirmimi për vijim procedurash legalizimi”.	PO	Nr.1132.Prot, datë 28.04.2022	Nr.107/1.Prot, datë 08.02.2022
2	Vendimi nr. 33 datë 28.04.2022 “Miratimin e punonjëve sezonal për pesë punonjës të uitjes verë 2022”.	PO	Nr.1133.Prot, datë 28.04.2022	Nr.185/2.Prot, datë 02.03.2022
3	Vendimi nr. 46 datë 27.06.2022 “Për dhënien e dakordsisë për vijimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor/kullosor “Për shfrytëzim të gurit gëlqeror në objektin Kaninë nga subjekti V sh.p.k”.	PO	Nr.1640.Prot, datë 27.06.2022	Nr.185/2.Prot, datë 02.03.2022
4	Vendimi nr. 50 datë 30.07.2022 “Për shpronësim për interes publik”.	PO	Nr.1923.Prot, datë 03.08.2022	Nr.531/1.Prot, datë 10.06.2022
5	Vendimi nr. 11 datë 24.02.2022 “Për shlyerjete detyrimeve të prapambetura për vitin 2022”.	PO	Nr.613.Prot, datë 01.03.2022	Nr.531/1.Prot, datë 10.06.2022
6	Vendimi nr. 16. datë 24.02.2022 Për fillimin e procedurave për ndryshimin e përgjegjësi së administrimit të pronave nga ministria e mbrojtjes në favor të Bashkisë Selenicë”.	PO	Nr.618.Prot datë 01.03.2022	Nr.531/1.Prot, datë 10.06.2022
7	Vendimi nr. 72 datë 30.11.2022 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Selenicë administrimin e tyre dhe penalitetet për kundërvajtjet administrative për vitin 2023”.	PO	Nr.2822.Prot datë 06.12.2022	Nr.643/1.Prot datë 20.07.2022
8	Vendimi nr. 18 datë 28.07.2023 “Miratimin e njësisë së procedurave të shpronësimit për interes publik të pasurisë is-pallati i kulturës në qytetin e Selenicës”.	PO	Nr.1731, prot., datë 03.08.2023	Nr.643/1.Prot datë 20.07.2022
9	Vendimi nr. 28 datë 27.04.2023 “Për mirtimin e sistemit të pikëzimit për banesat sociale”.	PO	Nr.1003, prot., datë 02.05.2023	Nr.643/1.Prot datë 20.07.2022
10	Vendimi nr.24 datë 20.03.2023 “Për dhënie me qira me afat 10 vjecar fond pyjor kullosor publik”	PO	Nr.726, prot., datë 23.03.2023	Nr.643/1.Prot datë 20.07.2022
11	Vendimi nr. 36 datë 23.11.2023 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Selenicë”.	PO	Nr.2653, prot., datë 01.12.2023	Nr.643/1.Prot datë 20.07.2022
12	Vendimi nr. 22 datë 20.03.2023 “Miratimin për dhënie në përdorim fond pyjor kullosor publik me afat 10 vjecar për shtrirje e projekt zbatimitndërtim murri pritës për reabilitimin e shkarjes së rrugës në fshatin Treblovë”.	PO	Nr.724 prot., datë 23.03.2023	Nr.643/1.Prot datë 20.07.2022
13	Vendimi nr. 18 datë 24.02.2023 “Përpëryshim nga taksa e tokës bujqësore”.	PO	Nr.586, prot., datë 02.03.2023	Nr.643/1.Prot datë 20.07.2022
14	Vendimi nr. 6 datë 26.01.2023 “Për kalimin në pronësi të z.L D sipërfaqen prej 400 m2 nga pasuria nr, 490/48 me vendndodhjen në zk.1265 Brataj”.	PO	Nr.270 prot.,datë 26.01.2023	Nr.643/1.Prot datë 20.07.2022

Burimi: Sektori Juridik, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Më hollësisht vendimet trajtuar si më poshtë vijon:

-Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se, 14 Vendimet e Këshillit Bashkiak (të konfirmuara), kanë bashkëlidhur projekt-vendimin si dhe relacionin përkatës por nuk janë të shoqëruara me procesverbalin e mbledhjes, në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut” aneksi nr.1, neni 4, pika b.

Në kushtet si më sipër, bazuar në pikën “c” të së njëjtës dispozitë, prefekti i qarkut duhet të kthente menjëherë aktin NJVV, duke e informuar se verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ do të bëhet vetëm pas paraqitjes së plotë të dokumentacionit.

-Nga auditimi i dokumentacionit 14 Vendimeve të Këshillit Bashkiak (të konfirmuara), rezulton se 7 prej tyre (sipas nr. rendor, në tabelën e mësipërme: 1, 3, 4, 8, 10, 12, 14) janë vendime me karakter individual dhe jo normativ.

Në kushtet si më sipër, duke vlerësuar dhe dhënë vlerësim pozitiv për ligjshmërinë e tyre, prefekti i qarkut Vlorë ka vepruar në mungesë të kompetencës, për sa kohë neni 16 dhe 17 i ligjit nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i njeh institucionit të Prefektit kompetencën për vlerësimin e ligjshmërisë vetëm për aktet me karakter normativ.

-Nga auditimi i dokumentacionit të Vendimeve të Këshillit Bashkiak (të konfirmuara), për vendimet me karakter individual, përveçse Prefekti ka konfirmuar ligjshmërinë e tyre në mungesë të kompetencës, e ka kryer atë edhe pse vendimet rezultojnë në kundërshtim me frymën e nenit 91 të Kodit Zgjedhor, sipas të cilit “*Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndalohet propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensioneve, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve, etj., përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore*” (sipas nr. rendor, në tabelën e mësipërme: 10, 12, 13, 14).

Nga auditimi i Vendime të Këshillit Bashkiak, të cilat nuk janë konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë, situara paraqitet si më poshtë:

VKB (të pa konfirmuara) Bashkia Selenicë

Nr. Rendor	Objekti i vendimit	Konfirmuar (po/jo)	Nr. Prot/Dataverifikimit	Motivacioni	Rishqyrtuar/konfirmuar
1	Vendimi nr. 27, datë 28.04.2022 “Për dhënie me qira me afat 10 vjeçar fond pyjor/kullosor publik dhe shprehjen e dakortësisë për heqjen nga fondi pyjor/kullosor”.	JO	Nr.1127/1.Prot, datë 28.04.2022	Nuk është respektuar procedura sipas nenit 41 e vijues të K.P.A	JO
2	Vendimi nr. 29, datë 31.03.2023 “Për kalimin nga përdorimi në pronësi të tokës bujqësore”.	JO	Nr.366/1 prot., datë 14.04.2023	Mungon dokumentacioni i saktë.	JO
3	Vendimi nr. 45, datë 27.06.2022 “Për miratim me shkrim të listës së sipërfaqeve për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik dhe vazhdimin e procedurave të prokurimit publik të vitin 2022”.	JO	Nr.530/1 prot., datë 01.06.2023	Vendimi i paqarte	JO
4	Vendimi nr. 10 datë 29.06.2023 “Për miratimin e projekt zbatimindërtim murrri pritës për rehabilitimin e shkarjes së rrugës në fshatin Treblovë”.	JO	Nr.634/1prot., datë 05.07.2023	Mungesë dokumentacioni	JO

Burimi: Sektori Juridik, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se vendimet e të kthyera për pabazueshmëri ligjore nuk janë rishqyrtuar nga njësia vendore dhe nuk janë paraqitur në institucionin e Prefektit në mospërputhje kjo të kërkesave të nenit 16 pika 2 germa b, e ligjit nr. 107/2016 “Për prefektin e Qarkut”, në të cilin përcaktohet se:

“Prefekti i qarkut bën verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore, pa penguar zbatimin e tyre, duke respektuar procedurën, Për çdo akt të regjistruar, prefekti i qarkut **detyrohet** të shprehet për ligjshmërinë e tij, brenda 10 ditëve nga data e regjistrimit. Në rastet kur vëren papajtueshmëri ligjore të aktit, prefektit të qarkut i **lind e drejta t’ia kthejë atë organit përkatës** të njësisë së vetëqeverisjes vendore, duke argumentuar shkeljet e vërejtura. Në këtë rast, organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore **rishqyrton aktin**; Vendimi, pas rishqyrtimit të aktit të kthyer nga prefekti i qarkut, **depozitohet pranë prefektit** të qarkut me të njëjtën procedurë dhe afat sipas përcaktimit të shkronjës “a”, të kësaj pike.

Vlerësimi ligjor i përputhshmërisë ose jo të aktit sa i përket moskonfirmimit është i rregullt, i shoqëruar me relacionin përkatës të nënshkruar nga punonjësit e sektorit juridik i cili ka kryer edhe argumentimin mbi shkeljet e vërejtura.

Nga ana e institucionit nuk ka vendime të dërguara në Gjykatën Administrative për pavlefshmëri.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin se, nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Vlorë, në lidhje me vendimet e dërguara nga Këshilli Bashkiak Selenicë, është dhënë vlerësim pozitiv për ligjshmërinë e vendimeve edhe në rastet kur këta të fundit:

-nuk kanë të dokumentuar që të jenë shoqëruar me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm të përcaktuar në rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”;

-janë marrë në kundërshtim me ligjin material, çka përbën shkak paligjshmërie sipas nenit 109, gërma “d” të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”;

-nuk kanë qenë në kompetencën e prefektit të qarkut Vlorë, për sa kohë neni 16 dhe 17 i ligjit nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i njeh institucionit të Prefektit kompetencën për vlerësimin e ligjshmërisë vetëm për aktet me karakter normativ.

Bashkia Sarandë (2022-2023)

Për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2023, Bashkia Sarandë, rezulton se në protokollin e institucionit janë depozituar (të hyra) gjithsej **136** akte administrative, nga të cilat janë konfirmuar për bazueshmëri ligjore **135** vendime të këshillit bashkiak, është kthyer për pabazueshmëri ligjore **1** vendim.

Grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej për verifikimin e ligjshmërisë së akteve me karakter normativ të depozituara në Prefektin e Qarkut Vlorë nga Bashkia Sarandë, përzgjedhi për auditim **11** Vendime të Këshillit Bashkiak (të konfirmuara) dhe **1** vendim (të pa konfirmuar) për periudhën 01.01.2022-31.12.2023, të paraqitura si më poshtë:

VKB (të konfirmuara) Bashkia Sarandë

Nr. Rendor	Objekti i vendimit	Konfirmuar (po/jo)	Nr. Prot/Dt. e paraqitjes	Nr. Prot/Dt. e dhënies së verifikimit
1	Vendimi nr. 178 datë 27.12.2022 “Për një shtesë në vendimin e Këshillit Bashkiak nr.162 datë 25.11.2022”.	PO	Nr.51/6.Prot, datë 06.01.2023	Nr.107/1.Prot, datë 08.02.2022
2	Vendimi nr. 91 datë 29.06.2022 “Për miratimin e kritereve të objekteve të miratuara për dhënie me qira”.	PO	Nr.2969/3.Prot, datë 04.07.2022	Nr.185/2.Prot, datë 02.03.2022
3	Vendimi nr. 125 datë 16.09.2022 “Për prishjen e shoqërisë Klubi Futbollit Butrinti Sh.a”.	PO	Nr.4011/3.Prot, datë 20.09.2022	Nr.185/2.Prot, datë 02.03.2022

4	Vendimi nr. 88 datë 29.06.2022 “Për miratimin e buxhetit faktik”.	PO	Nr.2969.Prot, datë 04.07.2022	Nr.531/1.Prot, datë 10.06.2022
5	Vendimi nr. 160 datë 25.11.2022 “Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2023”.	PO	Nr.5297/4.Prot, datë 01.12.2022	Nr.531/1.Prot, datë 10.06.2022
6	Vendimi nr. 46 datë 28.03.2022 Për miratimin e dhënies më qira të pasurisë llojit ndërtesë Lokal Rivierame sipërfaqe 338 m2 zk.8641 në pronësi të Bashkisë Sarandë” .	PO	Nr.1450/1.Prot datë 06.04.2022	Nr.531/1.Prot, datë 10.06.2022
7	Vendimi nr. 8 datë 27.01.2023 “Për miratimin e vendimit të kryetarit të bashkisë për rishikimin e planit të përgjithshëm vendor bashkia Sarandë me procedure të thjeshtuar”.	PO	Nr.544/8.Prot datë 31.01.2023	Nr.643/1.Prot datë 20.07.2022
8	Vendimi nr. 135 datë 27.10.2023 “Përcaktimin e disa kundërvajtjeve administrative dhe sanksionet që vendosen në to në territorin e Bashkisë Sarandë”.	PO	Nr.4802.Prot.datë 31.10.2023	Nr.915/2.Prot.datë 03.10.2024
9	Vendimi nr. 25 datë 23.02.2023 “Për miratimin e hartës së përgjithshme të plazheve të lejuara në territorin bregdetar të Bashkisë Sarandë”.	PO	Nr.1117/5.Prot.datë 01.03.2023	Nr.992/1.Prot, datë 28.10.2022
10	Vendimi nr. 47 datë 31.03.2023 “Për miratimin e buxhetit faktik 2022”,	PO	Nr.1713/3.Prot.datë 04.04.2023	Nr.992/1.Prot, datë 28.10.2022
11	Vendimi nr. 114 datë 28.07.2023 “Për disiplinimin e orareve të punës dhe mënyrës së funksionimit të njësive shërbimit, tregëtisë dhe veprimtarive të tjera në mjediset publike dhe private”.	PO	Nr.3622/6.Prot, datë 01.08.2023	Nr.992/1.Prot, datë 28.10.2022

Burimi: Sektori Juridik, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Më hollësisht vendimet trajtuar si më poshtë vijon:

-Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se, 11 Vendimet e Këshillit Bashkiak (të konfirmuara), kanë bashkëlidhur projekt-vendimin si dhe relacionin përkatës por nuk janë të shoqëruara me procesverbalin e mbledhjes, në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut” aneksi nr.1, neni 4, pika b.

Në kushtet si më sipër, bazuar në pikën “c” të së njëjtës dispozitë, prefekti i qarkut duhet të kthente menjëherë aktin NJVV, duke e informuar se verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ do të bëhet vetëm pas paraqitjes së plotë të dokumentacionit.

-Nga auditimi i dokumentacionit të Vendimeve të Këshillit Bashkiak (të konfirmuara), Prefekti ka konfirmuar ligjshmërinë edhe pse vendimi Vendimi nr. 46 datë 28.03.2022 “Për miratimin e dhënies më qira të pasurisë llojit ndërtesë Lokal Riviera me sipërfaqe 338 m2 zk.8641 në pronësi të Bashkisë Sarandë” rezultojn në kundërshtim me frymën e nenit 91 të Kodit Zgjedhor, sipas të cilit “Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndalohet propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensione, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve, etj., përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore”.

Nga auditimi i Vendime të Këshillit Bashkiak, të cilat nuk janë konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë, situara paraqitet si më poshtë:

VKB (të pa konfirmuara) Bashkia Sarandë

Nr. Rendor	Objekti i vendimit	Konfirmuar (po/jo)	Nr. Prot/Dataverifikimit	Motivacioni	Rishqyrtuar/konfirmuar
1	Vendimi nr.118, datë 21.07.2022 “Për rikonfirmim të vendimit të këshillit bashkiak nr.5 datë 25.06.1999”.	JO	Nr.185/2.Prot, datë 27.07.2022	Nuk është në përputhje me ligjin nr. 139/2015	JO

-Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se vendimi i kthyer për pabazueshmëri ligjore nuk është rishqyrtuar nga njësia vendore dhe nuk është paraqitur në institucionin e Prefektit në mospërputhje kjo të kërkesave të nenit 16 pika 2 germa b, e ligjit nr. 107/2016 “Për prefektin e Qarkut”, në të cilin përcaktohet se:

“Prefekti i qarkut bën verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhërësive me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore, pa penguar zbatimin e tyre, duke respektuar procedurën, Për çdo akt të regjistruar, prefekti i qarkut **detyrohet** të shprehet për ligjshmërinë e tij, brenda 10 ditëve nga data e regjistrimit. Në rastet kur vëren papajtueshmëri ligjore të aktit, prefektit të qarkut i **lind e drejta t’ia kthejë atë organit përkatës** të njësisë së vetëqeverisjes vendore, duke argumentuar shkeljet e vërejtura. Në këtë rast, organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore **rishqyrton aktin**; Vendimi, pas rishqyrtimit të aktit të kthyer nga prefekti i qarkut, **depozitohet pranë prefektit** të qarkut me të njëjtën procedurë dhe afat sipas përcaktimit të shkronjës “a”, të kësaj pike.

Vlerësimi ligjor i përputhshmërisë ose jo të aktit sa i përket moskonfirmimit është i rregullt, i shoqëruar me relacionin përkatës të nënshkruar nga punonjësit e sektorit juridik i cili ka kryer edhe argumentimin mbi shkeljet e vërejtura.

Nga ana e institucionit nuk ka vendime të dërguara në Gjykatën Administrative për pavlefshmëri.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin se, nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Vlorë, në lidhje me vendimet e dërguara nga Këshilli Bashkiak Sarandë, është dhënë vlerësim pozitiv për ligjshmërinë e vendimeve edhe në rastet kur këta të fundit:

-nuk kanë të dokumentuar që të jenë shoqëruar me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm të përcaktuar në rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”;

Bashkia Konispol (2022-2023)

Për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2023, Bashkia Konispol, rezulton se në protokollin e institucionit janë depozituar (të hyra) gjithsej **62** akte administrative, nga të cilat janë konfirmuar për bazueshmëri ligjore **61** vendime të këshillit bashkiak, është kthyer për pabazueshmëri ligjore **1** vendim.

Grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej për verifikimin e ligjshmërisë së akteve me karakter normativ të depozituara në Prefektin e Qarkut Vlorë nga Bashkia Konispol, përzgjedhi për auditim **15** Vendime të Këshillit Bashkiak (të konfirmuara) dhe **1** vendim (të pa konfirmuara) për periudhën 01.01.2022-31.12.2023, të paraqitura si më poshtë:

VKB (të konfirmuara) Bashkia Konispol

Nr. Rendor	Objekti i vendimit	Konfirmuar (po/jo)	Nr. Prot/Dt. e paraqitjes	Nr. Prot/Dt. e dhënies së verifikimit
1	Vendimi nr. 10 datë 23.03.2022 “Për shpronësimin e disa pasurive pronë private për interes public.	PO	Nr.508.Prot, datë 01.02.2022	Nr.107/1.Prot, datë 08.02.2022
2	Vendimi nr. 26 datë 29.06.2022 “Për miratim në parim të kërkesave “G&E” sh.p.k, dhe E P”, sh.p.kpër dhënie të një sipërfaqe toke për ndërtimin e impianteve të prodhimit të energjisë nga burime të rinovueshme”.	PO	Nr.788.Prot, datë 05.07.2022	Nr.185/2.Prot, datë 02.03.2022
3	Vendimi nr. 31 datë 31.08.2022 “Për miratimin e dhënies me qira të sipërfaqeve pyjore dhe kullimore në Bashkinë Konispol”	PO	Nr.943.Prot, datë 31.08.2022	Nr.185/2.Prot, datë 02.03.2022
4	Vendimi nr. 33 datë 31.08.2022 “Për miratimin e dhënies me qira të sipërfaqeve pyjore dhe kullimore në Bashkinë Konispol”	PO	Nr.943 prot., datë 31.08.2022	Nr.185/2.Prot, datë 02.03.2022
5	Vendimi nr. 30 datë 27.07.2022 “Për përcaktimin e vlerës së shpronësimit të disa pasurive pronë private për interes publik”.	PO	Nr.868/3.Prot, datë 02.08.2022	Nr.531/1.Prot, datë 10.06.2022
6	Vendimi nr. 34 datë 31.08.2022 “Për dhënie e miratimit për riorganizimin e shoqërisë aksionere: Ujësjellës Kanalizime Konispol”.	PO	Nr.944.Prot, datë 02.09.2022	Nr.531/1.Prot, datë 10.06.2022
7	Vendimi nr. 36 datë 28.09.2022 Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi 6% për periudhën 1-31 gusht 2022”.	PO	Nr.1054.Prot datë 03.10.2022	Nr.531/1.Prot, datë 10.06.2022
8	Vendimi nr. 47 datë 06.10.2022 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2023”.	PO	Nr.1339.Prot datë 13.12.2022	Nr.643/1.Prot datë 20.07.2022
9	Vendimi nr. 41 datë 26.10.2022 “Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë Konispol për vitin 2022sipas ndryshimeve të V.K.M nr. 652, datë 28.09.2022”.	PO	Nr.1192.Prot.datë 03.11.2022	Nr.915/2.Prot.datë 03.10.2024
10	Vendimi nr. 24 datë 30.11.2023 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2024”.	PO	Nr.1352 prot., datë 05.12.2023	Nr.915/2.Prot.datë 03.10.2024
11	Vendimi nr. 30 datë 30.11.2023 “Për përdorimin e fondit të emergjencave ”.	PO	Nr.1358 prot., datë 05.12.2023	Nr.915/2.Prot.datë 03.10.2024
12	Vendimi nr. 36 datë 29.12.2023 “Për miratimin e buxhetit për vitin 2024 të bashkisë Konispol”.	PO	Nr.35 prot., datë 08.01.2024	Nr.915/2.Prot.datë 03.10.2024
13	Vendimi nr. 9 datë 27.7.2023 “Për miratimin e nivelit të pagave dhe shpërblimeve të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar nëpunës civil dhe të punonjësve të administratës Bashkisë Konispol”.	PO	Nr.820 prot., datë 31.07.2023	Nr.915/2.Prot.datë 03.10.2024
14	Vendimi nr. 15 datë 29.09.2023 “Për një ndryshim në buxhetin e vitit 2023”.	PO	Datë 04.10.2023	Nr.915/2.Prot.datë 03.10.2024
15	Vendimi nr. 18 datë 29.09.2023 “Për miratimin e dhënies me qira të sipërfaqeve pyjore dhe kullimore në Bashkinë Konispol”.	PO	Nr.1029 prot., datë 04.10.2023	Nr.915/2.Prot.datë 03.10.2024

Burimi: Sektori Juridik, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Më hollësisht vendimet trajtuar si më poshtë vijon:

-Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se, 15 Vendimet e Këshillit Bashkiak (të konfirmuara), kanë bashkëlidhur projekt-vendimin si dhe relacionin përkatës por nuk janë të shoqëruara me procesverbalin e mbledhjes, në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175

datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut” aneksi nr.1, neni 4, pika b.

Në kushtet si më sipër, bazuar në pikën “c” të së njëjtës dispozitë, prefekti i qarkut duhet të kthente menjëherë aktin NJVV, duke e informuar se verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ do të bëhet vetëm pas paraqitjes së plotë të dokumentacionit.

-Nga auditimi i dokumentacionit 15 Vendimeve të Këshillit Bashkiak (të konfirmuara), rezulton se 4 prej tyre (sipas nr. rendor, në tabelën e mësipërme: 1, 2, 5, 7) janë vendime me karakter individual dhe jo normativ.

Në kushtet si më sipër, duke vlerësuar dhe dhënë vlerësim pozitiv për ligjshmërinë e tyre, prefekti i qarkut Vlorë ka vepruar në mungesë të kompetencës, për sa kohë neni 16 dhe 17 i ligjit nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i njeh institucionit të Prefektit kompetencën për vlerësimin e ligjshmërisë vetëm për aktet me karakter normativ.

Nga auditimi i Vendime të Këshillit Bashkiak, të cilat nuk janë konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë, situara paraqitet si më poshtë:

VKB (të pa konfirmuara) Bashkia Konispol

Nr. Rendor	Objekti i vendimit	Konfirmuar (po/jo)	Nr. Prot/Dataverifikimit	Motivacioni	Rishqyrtuar/konfirmuar
1	Vendimi nr.7, datë 23.02.2022 “Për kundërshtim të reformës së ndërrmarjes UK-Konispol dhe krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta”.	JO	Nr.185/2.Prot, datë 02.03.2022	Nuk është respektuar procedura sipas neni 41 e vijues të K.P.A	JO

-Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se vendimi e kthyer për pabazueshmëri ligjore nuk është rishqyrtuar nga njësia vendore dhe nuk janë paraqitur në institucionin e Prefektit në mospërputhje kjo të kërkesave të nenit 16 pika 2 germa b, e ligjit nr.107/2016 “Për prefektin e Qarkut”, në të cilin përcaktohet se:

“Prefekti i qarkut bën verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore, pa penguar zbatimin e tyre, duke respektuar procedurën, Për çdo akt të regjistruar, prefekti i qarkut **detyrohet** të shprehet për ligjshmërinë e tij, brenda 10 ditëve nga data e regjistrimit. Në rastet kur vëren papajtueshmëri ligjore të aktit, prefektit të qarkut i **lind e drejta t’ia kthejë atë organit përkatës** të njësisë së vetëqeverisjes vendore, duke argumentuar shkeljet e vërejtura. Në këtë rast, organi i njësisës së vetëqeverisjes vendore **rishqyrton aktin**; Vendimi, pas rishqyrtimit të aktit të kthyer nga prefekti i qarkut, **depozitohet pranë prefektit** të qarkut me të njëjtën procedurë dhe afat sipas përcaktimit të shkronjës “a”, të kësaj pike.

Vlerësimi ligjor i përputhshmërisë ose jo të aktit sa i përket moskonfirmimit është i rregullt, i shoqëruar me relacionin përkatës të nënshkruar nga punonjësit e sektorit juridik i cili ka kryer edhe argumentimin mbi shkeljet e vërejtura.

Nga ana e institucionit nuk ka vendime të dërguara në Gjykatën Administrative për pavlefshmëri.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin se, nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Vlorë, në lidhje me vendimet e dërguara nga Këshilli Bashkiak Konispol, është dhënë vlerësim pozitiv për ligjshmërinë e vendimeve edhe në rastet kur këta të fundit:

-nuk kanë të dokumentuar që të jenë shoqëruar me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm të përcaktuar në rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”;

-nuk kanë qenë në kompetencën e prefektit të qarkut Vlorë, për sa kohë neni 16 dhe 17 i ligjit nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i njeh institucionit të Prefektit kompetencën për vlerësimin e ligjshmërisë vetëm për aktet me karakter normativ.

Bashkia Finiq (2022-2023)

Për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2023, Bashkia Finiq, rezulton se në protokollin e institucionit janë depozituar (të hyra) gjithsej **116** akte administrative, nga të cilat janë konfirmuar për bazueshmëri ligjore **116** vendime të këshillit bashkiak, janë kthyer për pabazueshmëri ligjore **0** vendime.

Grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej për verifikimin e ligjshmërisë së akteve me karakter normativ të depozituara në Prefektin e Qarkut Vlorë nga Bashkia Finiq, përzgjedhi për auditim **13** Vendime të Këshillit Bashkiak (të konfirmuara) dhe **0** vendime (të pa konfirmuara) për periudhën 01.01.2022-31.12.2023, të paraqitura si më poshtë:

VKB (të konfirmuara) Bashkia Finiq

Nr. Rendor	Objekti i vendimit	Konfirmuar (po/jo)	Nr. Prot/Dt. e paraqitjes	Nr. Prot/Dt. e dhënies së verifikimit
1	Vendimi nr. 22 datë 02.06.2022 “Për miratimin e fillimit të procedurave për shpronësim të ish-mapos së vjetër për interes publik për ndërtimin e një sheshi rekreativ në qendër të fshatit Finiq”.	PO	Nr.1132.Prot, datë 28.04.2022	Nr.107/1.Prot, datë 08.02.2022
2	Vendimi nr. 23 datë 02.06.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në buxhetin e bashkisë Finiq për vitin 2022”.	PO	Nr.1133.Prot, datë 28.04.2022	Nr.185/2.Prot, datë 02.03.2022
3	Vendimi nr. 25 datë 07.07.2022 “Përmiratimin e buhetit afatmsëm të bashkisë Finiq për periudhën 2023-2025”.	PO	Nr.1640.Prot, datë 27.06.2022	Nr.185/2.Prot, datë 02.03.2022
4	Vendimi nr. 32 datë 22.09.2022 “Për miratimin e ndryshimit të sipërfaqes së tokës së dhënë me qira për 99 vjet dhe ndryshimin e kontratës së lidhur ndërmjet ish-komunës Finiq dhe shtetasit Vasil Babi fshati Vrion”.	PO	Nr.1923.Prot, datë 03.08.2022	Nr.531/1.Prot, datë 10.06.2022
5	Vendimi nr. 45 datë 03.11.2022 “Për miratimin e nivelit të pagave e shpërblimeve të punonjësve të bashkisë Finiq e institucioneve në vartësi dhe personave të tjerë të zgjedhur ose të emëruar për vitin 2022”.	PO	Nr.613.Prot, datë 01.03.2022	Nr.531/1.Prot, datë 10.06.2022
6	Vendimi nr. 47 datë 29.12.2022 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore të bashkisë Finiq për vitin 2023”.	PO	Nr.618.Prot datë 01.03.2022	Nr.531/1.Prot, datë 10.06.2022
7	Vendimi nr. 52 datë 29.12.2022 “Për korrigjim gabimi për prishjen e kontratës së tokës të z.Vangjel Rubati e dhënë me qira për 99 vjet”.	PO	Nr.2822.Prot datë 06.12.2022	Nr.643/1.Prot datë 20.07.2022
8	Vendimi nr. 8 datë 02.03.2023 “Për dhënie në përdorim të territorit publik me qëllim studimi për park energjitik me erë”.			
9	Vendimi nr. 10 datë 25.04.2023 “Miratimi i listës së objekteve kullosore -pyjore të gatshëm për kullotje për sezonin veror 2023”			
10	Vendimi nr. 34 datë 07.09.2023 “Për heqjen jashtë përdorimit të aktivave që nuk janë në gjendje pune nga inventari i bashkisë”.			
11	Vendimi nr. 49 datë 07.12.2023 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore të bashkisë Finiq për vitin 2024”.			

12	Vendimi nr. 51 datë 07.12.2023 “Për prishjen e njëanshme të kontratës së tokës të dhënë më qira për një afat 10-35-99 vjeçar”.			
13	Vendimi nr. 57 datë 21.12.2023 “Mirati i buxhetit të bashkisë Finiq për vitin 2024”.			

Burimi: Sektori Juridik, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Më hollësisht vendimet trajtuar si më poshtë vijon:

-Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se, 13 Vendimet e Këshillit Bashkiak (të konfirmuara), kanë bashkëlidhur vendimin si dhe relacionin përkatës por nuk janë të shoqëruara me procesverbalin e mbledhjes dhe projekt-vendimin (me përjashtim të vendimit nr. 34 datë 07.09.2023), në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut” aneksi nr.1, neni 4, pika b.

Në kushtet si më sipër, bazuar në pikën “c” të së njëjtës dispozitë, prefekti i qarkut duhet të kthente menjëherë aktin NJVV, duke e informuar se verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ do të bëhet vetëm pas paraqitjes së plotë të dokumentacionit.

-Nga auditimi i dokumentacionit 13 Vendimeve të Këshillit Bashkiak (të konfirmuara), rezulton se 5 prej tyre (sipas nr. rendor, në tabelën e mësipërme: 1, 4, 7, 8, 12) janë vendime me karakter individual dhe jo normativ.

Në kushtet si më sipër, duke vlerësuar dhe dhënë vlerësim pozitiv për ligjshmërinë e tyre, prefekti i qarkut Vlorë ka vepruar në mungesë të kompetencës, për sa kohë neni 16 dhe 17 i ligjit nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i njeh institucionit të Prefektit kompetencën për vlerësimin e ligjshmërisë vetëm për aktet me karakter normativ.

-Nga auditimi i dokumentacionit të Vendimeve të Këshillit Bashkiak (të konfirmuara), për vendimet me karakter individual, përveçse Prefekti ka konfirmuar ligjshmërinë e tyre në mungesë të kompetencës, e ka kryer atë edhe pse vendimet rezultojnë në kundërshtim me frymën e nenit 91 të Kodit Zgjedhor, sipas të cilit “Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndalohet propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensioneve, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve, etj., përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore” (sipas nr. rendor, në tabelën e mësipërme: 8).

-Nga auditimi i Vendimit nr. 51 datë 07.12.2023 “Për prishjen e njëanshme të kontratës së tokës të dhënë më qira për një afat 10-35-99 vjeçar”, rezulton se vendimi është konfirmuar në mospërputhje me nenin (54) të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i cili përcakton detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak, pasi në asnjë pike të saj dispozita nuk përcakton si kompetencë të këshillit bashkiak zgjidhjen e njëanshme të kontratës.

Gjithashtu vendimi është në kundërshtim me Ligjin nr.7850, datë 29.7.1994, i ndryshuar “Kodi Civil”. Referuar nenit 690 të Kodit Civil, “Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Ajo mund të priset ose të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve ose për shkaqe të parashikuara me ligj”. Neni 698 i Kodit Civil përcakton se: “Në kontrata me detyrime të ndërsjella, kur njëra nga palët kontraktuese nuk përmbush detyrimet e veta, pala tjetër kontraktuese, sipas rastit, mund të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ose zgjidhjen e kontratës, përveç shpërblimit të dëmit”.

Referuar dispozitave të sipërcituara, zgjidhja e një kontrate të lidhur rregullisht ka forcën e ligjit dhe si e tillë nuk mund të zgjidhet pa pëlqimin e ndërsjellë të palëve dhe në mungesë të një pëlqimi të tillë zgjidhja kërkohet dhe është kompetence vetëm e gjykatës.

Nga ana e institucionit nuk ka vendime të dërguara në Gjykatën Administrative për pavlefshmëri.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin se, nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Vlorë, në lidhje me vendimet e dërguara nga Këshilli Bashkiak Finiq, është dhënë vlerësim pozitiv për ligjshmërinë e vendimeve edhe në rastet kur këta të fundit:

- nuk kanë të dokumentuar që të jenë shoqëruar me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm të përcaktuar në rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”;
- janë marrë në kundërshtim me ligjin material, çka përbën shkak paligjshmërie sipas nenit 109, gërma “d” të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”;
- nuk kanë qenë në kompetencën e prefektit të qarkut Vlorë, për sa kohë neni 16 dhe 17 i ligjit nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i njuh institucionit të Prefektit kompetencën për vlerësimin e ligjshmërisë vetëm për aktet me karakter normativ.

Bashkia Delvinë (2022-2023)

Për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2023, Bashkia Delvinë, rezulton se në protokollin e institucionit janë depozituar (të hyra) gjithsej **74** akte administrative, nga të cilat janë konfirmuar për bazueshmëri ligjore **74** vendime të këshillit bashkiak, janë kthyer për pabazueshmëri ligjore **0** vendime.

Grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej për verifikimin e ligjshmërisë së akteve me karakter normativ të depozituara në Prefektin e Qarkut Vlorë nga Bashkia Delvinë, përzgjodhi për auditim **9** Vendime të Këshillit Bashkiak (të konfirmuara) për periudhën 01.01.2022-31.12.2023, të paraqitura si më poshtë:

VKB (të konfirmuara) Bashkia Delvinë

Nr. Rendor	Objekti i vendimit	Konfirmuar (po/jo)	Nr. Prot/Dt. e paraqitjes	Nr. Prot/Dt. e dhënies së verifikimit
1	Vendimi nr. 4 datë 02.02.2022 “Për përdorimin e fondit të emergjencave civile”.	PO	Nr.279/5.Prot, datë 04.02.2022	Nr.107/1.Prot, datë 08.02.2022
2	Vendimi nr. 13 datë 20.04.2022 “Për ndarjen e kufijëve të njësisve administrative dhe fshatrat në përbërje të tyre”.	PO	Nr.904/8.Prot, datë 20.04.2022	Nr.185/2.Prot, datë 02.03.2022
3	Vendimi nr. 15 datë 20.04.2022 “Për miratimin e rrugës së kalimit për përdorim të përshtatshëm të pronës së znj. M H dhe z. G K”.	PO	Nr.904/10.Prot, datë 20.04.2022	Nr.185/2.Prot, datë 02.03.2022
4	Vendimi nr. 26 datë 28.06.2022 “Për dhënien e pëlqimit për shitje në ankand të aksioneve të klubit të futbollit Delvina S.H.A”.	PO	Nr.1479.Prot, datë 29.06.2022	Nr.531/1.Prot, datë 10.06.2022
5	Vendimi nr. 55 datë 30.11.2022 “Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2023”	PO	30.11.2022	Nr.531/1.Prot, datë 10.06.2022
6	Vendimi nr. 27 datë 28.06.2022 Për dhënien e pëlqimit shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime sh.a Delvinë për kryerjen e procedurave për shpronësim apo blerje pasurie të cilat janë çenuar nga ndërtimi i ujësjellësit të ri në fshatin Vanë”	PO	19.07.2022	Nr.531/1.Prot, datë 10.06.2022

7	Vendimi nr. 32 datë 19.07.2022 “Për miratimin e planit të masave për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura për dalje nga situata e problemeve financiare”.	PO	Nr.3252.Prot datë 06.07.2022	Nr.643/1.Prot datë 20.07.2022
8	Vendimi nr. 42 datë 30.11.2023 “Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2024”.	PO	Nr.2681/9.Prot.datë 30.11.2023	Nr.915/2.Prot.datë 03.10.2024
9	Vendimi nr. 29 datë 28.08.2023 “Për miratimin e planit të masave për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”.	PO	Nr.1827/6.Prot.datë 28.08.2023	Nr.992/1.Prot, datë 28.10.2022

Burimi: Sektori Juridik, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Më hollësisht vendimet trajtuar si më poshtë vijon:

-Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se 9 Vendimet e Këshillit Bashkiak (të konfirmuara), kanë bashkëlidhur projekt-vendimin si dhe relacionin përkatës por nuk janë të shoqëruara me procesverbalin e mbledhjes në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut” aneksi nr.1, neni 4, pika b.

Në kushtet si më sipër, bazuar në pikën “c” të së njëjtës dispozitë, prefekti i qarkut duhet të kthente menjëherë aktin NJVV, duke e informuar se verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ do të bëhet vetëm pas paraqitjes së plotë të dokumentacionit.

-Nga auditimi i dokumentacionit 9 Vendimeve të Këshillit Bashkiak (të konfirmuara), rezulton se 1 prej tyre (sipas nr. rendor, në tabelën e mësipërme: 3) është vendim me karakter individual dhe jo normativ.

Në kushtet si më sipër, duke vlerësuar dhe dhënë vlerësim pozitiv për ligjshmërinë e tyre, prefekti i qarkut Vlorë ka vepruar në mungesë të kompetencës, për sa kohë neni 16 dhe 17 i ligjit nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i njeh institucionit të Prefektit kompetencën për vlerësimin e ligjshmërisë vetëm për aktet me karakter normativ.

Nga ana e institucionit nuk ka vendime të dërguara në Gjykatën Administrative për pavlefshmëri. Sa më sipër arrihet në konkluzionin se, nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Vlorë, në lidhje me vendimet e dërguara nga Këshilli Bashkiak Delvinë, është dhënë vlerësim pozitiv për ligjshmërinë e vendimeve edhe në rastet kur këta të fundit:

-nuk kanë të dokumentuar që të jenë shoqëruar me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm të përcaktuar në rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”;

-nuk kanë qenë në kompetencën e prefektit të qarkut Vlorë, për sa kohë neni 16 dhe 17 i ligjit nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i njeh institucionit të Prefektit kompetencën për vlerësimin e ligjshmërisë vetëm për aktet me karakter normativ.

Në përfundim, për sa konstatuar më sipër nga grupi i auditimit, ngarkohet me përgjegjësi: z. O. Z., znj. S. H, znj. I. D, znj. Z. J, në cilësinë punonjësve të sektorit juridik si dhe z. F. M, në cilësinë e Titullarit (ish-prefekt).

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, duke përjashtuar objeksionet e trajtuara nga grupi i auditimit në fazën e akt konstatimeve, nga subjekti i audituar, nuk është paraqitur observacion “Mbi Projekt Raportin e Auditimit”.

-Mbi administrimin e dokumentacionit dhe praktikave të kryera në funksion të verifikimit të ligjshmërisë së akteve, në zbatim të nenit 16 dhe 17 të ligjit nr. 107/2016, “Për Prefektin e Qarkut”.

Gjatë auditimit të kryer është konstatuar se, aktet e ardhura për verifikimin e ligjshmërisë në Institucionin e Prefektit të Qarkut Vlorë nga NJVV, regjistrohen në librin e protokollit të institucionit. Gjithashtu regjistrohen në librin e protokollit edhe shkresat me të cilat Prefekti shprehet për ligjshmërinë e këtyre akteve.

Aktet e ardhura për verifikim dhe konfirmimi i tyre nga ana e Institucionit të Prefektit nuk janë të administruara në dosje të plota dhe të veçanta sipas natyrës së tyre. Këto akte (shkresa) janë arkivuar në zyrën e protokoll-arkivash së Institucionit të Prefektit dhe i janë vënë në dispozicion grupit të auditimit rast pas rasti nga punonjësja e protokollit.

Pranë institucionit të Prefektit të Qarkut Vlorë nuk ka një regjistër shkresor apo elektronik në të cilin të pasqyrohet në mënyrë të detajuar periodike apo të pëgjithshme aktiviteti i Prefektit në funksion të verifikimit të ligjshmërisë së akteve.

Si konkluzion, mungesa e krijimit dosjeve të plota dhe të veçanta sipas natyrës së tyre si dhe mungesa e njëregjistri shkresor apo elektronik në të cilin të pasqyrohet në mënyrë të detajuar periodike apo të pëgjithshme aktiviteti i Prefektit në funksion të verifikimit të ligjshmërisë së akteve mbartin riskun e humbjes ose tjetërsimit të gjurmës së auditimit, ose te çfarëdo dokumentacioni që është pjesë e procesit të verifikimit të ligjshmërisë.

Gjithashtu, referuar ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*”, i ndryshuar dhe Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, Veprimtaria e Kontrollit, si një prej pesë komponentëve të MFK, përmban detyrimin e hartimit të procedurave për dokumentimin, arkivimin dhe ruajtjen e informacionit, të cilat duhet të vendosen për të mbështetur kryerjen e operacioneve dhe kontrollimin e proceseve në njësinë publike.

Konkretisht neni 19 i ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*”, i ndryshuar, përcakton se: “*Titullarët e njësive të sektorit publik zbatojnë menaxhimin financiar dhe kontrollin nëpërmjet këtyre komponentëve të ndërlidhur me njëri-tjetrin: 1. Mjedisi i kontrollit. 2. Menaxhimi i riskut. 3. Veprimtaritë e kontrollit. 4. Informacioni dhe komunikimi. 5. Monitorimi*”.

Gjithashtu, për sa më sipër, neni 23 i ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*”, i ndryshuar, përcakton se: “*Titullarët e njësive publike miratojnë dhe vënë në funksionim sisteme informacioni dhe komunikimi, që sigurojnë:*

1. Identifikimin, mbledhjen dhe përhapjen e një informacioni të vërtetë dhe të besueshëm në një format të përshtatshëm, brenda afateve të duhura, duke bërë të mundur që çdo punonjës të marrë përsipër përgjegjësitë përkatëse.

2. Një komunikim efektiv, si vertikal, ashtu edhe horizontal, në të gjitha nivelet e hierarkisë së njësisë.

3. Ngritjen dhe zhvillimin e një sistemi të përshtatshëm të informacionit për menaxhimin e njësisë që ka si qëllim shpërndarjen e udhëzimeve dhe urdhrave të qartë dhe të saktë për rolet e çdo punonjësi të përfshirë në menaxhimin financiar dhe kontrollin.

4. Ngritjen e një sistemi për dokumentimin dhe qarkullimin e dokumenteve, që përmbajnë rregullat për përgatitjen, formatimin, lëvizjen, përdorimin dhe arkivimin e dokumenteve, në bazë të rregullave të nxjerra nga Ministri i Financave.

5. Dokumentimin e të gjitha këtyre veprimtarive, proceseve dhe transaksioneve, me qëllim që të sigurohet gjurma e duhur e auditimit për vijueshmërinë dhe monitorimin.

6. Ngritjen e një sistemi deklarimi efikas dhe të përpiktë, duke përfshirë nivelet dhe afatet për deklarimin, llojet e deklaratave që i dorëzohen menaxhimit, format e deklaratave për rastet e zbulimit të gabimeve, të parregullsive, të abuzimit, të mashtrimit ose të përvetësimit”.

Në përfundim, për sa konstatuar më sipër nga grupi i auditimit, ngarkohet me përgjegjësi:

z. F. M, në cilësinë e Titullarit (ish-prefekt).

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, duke përjashtuar objeksionet e trajtuara nga grupi i auditimit në fazën e akt konstatimeve, nga subjekti i audituar, nuk është paraqitur observacion “Mbi Projekt Raportin e Auditimit”.

-Mbi verifikimin e ligjshmërisë së akteve me karakter normativ drejtpërdrejt dhe sistematikisht në organin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, në zbatim të nenit 17 të ligjit nr. 107/2016, “Për Prefektin e Qarkut”.

Dispozita e sipërcituar (neni 17) përcakton se:

“1. Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e akteve me karakter normativ drejtpërdrejt dhesistematikisht në organin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, kur nuk përcaktohet ndryshe në akte të tjera ligjore, jo më pak se një herë në 3 muaj.

2. Në rast se gjatë verifikimit në vend të ligjshmërisë prefekti i qarkut konstaton akte, të cilat nuk janë depozituar tek ai, sipas procedurës së parashikuar në nenin 16, të këtij ligji, kërkon pavlefshmërinë e tyre në gjykatën kompetente për çështjet administrative”.

Referuar Rregullores së Brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 nenit 5 (aneksi I) “*Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i qarkut*”, ndër të tjera, rezulton se, Prefekti i qarkut bën verifikimin e ligjshmërisë së akteve drejtpërdrejt dhe sistematikisht në organin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, duke respektuar procedurën e mëposhtme:

a. Korrespondenca në kuadër të procesit të verifikimit midis prefektit të qarkut dhe njërive tëvetëqeverisjes vendore do të bëhet në formë shkresore, kur nuk parashikohet ndryshe në ligj;

b. Prefekti i qarkut me urdhër të veçantë cakton grupin e punës, i cili do të kryejë procedurën e verifikimit pranë njërive të vetëqeverisjes vendore duke përcaktuar dhe objektin e verifikimit;

c. Grupi i punës fillon procesin e verifikimit me dërgimin e njoftimit, njësisë së vetëqeverisjes vendore me formë shkresore, i cili do të përmbajë: i. njësinë e vetëqeverisjes vendore/subjektin e verifikimit; ii. bazën ligjore mbi verifikimin; iii. llojin e verifikimit; iv. arsyet e inicimit të verifikimit; v. periudha që do të verifikohet; vi. afatet e kryerjes së verifikimit; vii. përbërjen e grupit të punës;

d. Grupi i punës është përgjegjës për ndjekjen e procesit të administrimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit gjatë kryerjes së verifikimit në vend me qëllim evidentimin e të gjitha akteve me karakter normativ;

e. Gjatë procesit të verifikimit në vend në institucionin e NJVV, grupi i punës mban një akt konstatimi, i cilinëshkruhet dhe nga përfaqësuesit e NJVV-së;

f. Në rast se gjatë verifikimit në vend të ligjshmërisë prefekti i qarkut konstaton akte, të cilat nuk janë depozituar tek ai, sipas procedurës së parashikuar në nenin 16, të këtij ligji, kërkonpavlefshmërinë e tyre në gjykatën kompetente për çështjet administrative;

g. Në përfundim të procedurës së kryerjes së verifikimit në vend të akteve, prefekti i qarkut dërgon konkluzionet së bashku me rekomandimet përkatëse pranë NJVV-së objekt verifikimi.

Për periudhën 01.01.2022- 31.12.2023 procedura e kontrollit në vend të akteve pranë njërive vendore është si më poshtë:

Për vitin 2022, grupi të auditimit i është vënë në dispozicion dokumentacioni përkatësisht për periudhat si vijon:

Për verifikimin e periudhës Janar- Mars 2022:

-Raport-Kontrolli, i miratuar nga prefekti i qarkut, nr. 420 datë 29.04.2022. Referuar përmbajtjes së këtij raporti, grupi i punës ka arritur në konkluzionin se: *“Në të gjitha Bashkitë është punuar me kujdes, si me konceptimin e vendimeve dhe relacionet shpjeguese, mbi çdo vendim të marrë. Nuk u konstatua asnjë rast që të mos jenë dërguar për shprehje të ligjshmëriesë akte me karakter normativ për të marrë vlerësimin ligjor pranë Instirucionit të Prefektit të Qarkut. Libri i regjistrimit të vendimeve ishte në përputhje me atë të proces-verbaleve”;*

-Proces-Verbali i datës 20.04.2022 *“Mbi verifikimin e akteve të Bashkisë Konispol”*, referuar të cilit nga grupi i punës është konstatuar se gjatë kësaj periudhe janë nxjerrë në tërësi 6 akte;

-Proces-Verbali i datës 20.04.2022 *“Mbi verifikimin e akteve të Bashkisë Selenicë”*, referuar të cilit nga grupi i punës është konstatuar se gjatë kësaj periudhe janë nxjerrë në tërësi 16 akte;

-Proces-Verbali i datës 21.04.2022 *“Mbi verifikimin e akteve të Bashkisë Vlorë”*, referuar të cilit nga grupi i punës është konstatuar se gjatë kësaj periudhe janë nxjerrë në tërësi 23 akte;

-Proces-Verbali i datës 21.04.2022 *“Mbi verifikimin e akteve të Bashkisë Himarë”*, referuar të cilit nga grupi i punës është konstatuar se gjatë kësaj periudhe janë nxjerrë në tërësi 14 akte;

-Proces-Verbali i datës 20.04.2022 *“Mbi verifikimin e akteve të Bashkisë Delvinë”*, referuar të cilit nga grupi i punës është konstatuar se gjatë kësaj periudhe janë nxjerrë në tërësi 10 akte;

-Proces-Verbali i datës 20.04.2022 *“Mbi verifikimin e akteve të Bashkisë Sarandë”*, referuar të cilit nga grupi i punës është konstatuar se gjatë kësaj periudhe janë nxjerrë në tërësi 14 akte;

-Proces-Verbali i datës 21.04.2022 *“Mbi verifikimin e akteve të Qarkut Vlorë”*, referuar të cilit nga grupi i punës është konstatuar se gjatë kësaj periudhe janë nxjerrë në tërësi 13 akte;

-Proces-Verbali i datës 20.04.2022 *“Mbi verifikimin e akteve të Bashkisë Finiq”*, referuar të cilit nga grupi i punës është konstatuar se gjatë kësaj periudhe janë nxjerrë në tërësi 17 akte;

Për verifikimin e periudhës Tetor- Dhjetor 2022:

-Raport-Kontrolli, i miratuar nga prefekti i qarkut, nr. 276 datë 16.03.2022. Referuar përmbajtjes së këtij raporti, grupi i punës ka arritur në konkluzionin se: *“Nuk u konstatuan problematika gjatë procedurës së verifikimit të akteve në vend”;*

-Proces-Verbali i datës 16.02.2023 *“Mbi verifikimin e akteve të Bashkisë Konispol”*, referuar të cilit nga grupi i punës është konstatuar se gjatë kësaj periudhe janë nxjerrë në tërësi 15 akte;

-Proces-Verbali i datës 21.02.2023 *“Mbi verifikimin e akteve të Bashkisë Selenicë”*, referuar të cilit nga grupi i punës është konstatuar se gjatë kësaj periudhe janë nxjerrë në tërësi 21 akte;

-Proces-Verbali i datës 06.03.2023 *“Mbi verifikimin e akteve të Bashkisë Vlorë”*, referuar të cilit nga grupi i punës është konstatuar se gjatë kësaj periudhe janë nxjerrë në tërësi 7 akte;

-Proces-Verbali i datës 22.02.2023 *“Mbi verifikimin e akteve të Bashkisë Himarë”*, referuar të cilit nga grupi i punës është konstatuar se gjatë kësaj periudhe janë nxjerrë në tërësi 26 akte;

-Proces-Verbali i datës 16.02.2023 *“Mbi verifikimin e akteve të Bashkisë Delvinë”*, referuar të cilit nga grupi i punës është konstatuar se gjatë kësaj periudhe janë nxjerrë në tërësi 17 akte;

-Proces-Verbali i datës 16.02.2023 *“Mbi verifikimin e akteve të Bashkisë Sarandë”*, referuar të cilit nga grupi i punës është konstatuar se gjatë kësaj periudhe janë nxjerrë në tërësi 38 akte;

-Proces-Verbali i datës 06.03.2023 *“Mbi verifikimin e akteve të Qarkut Vlorë”*, referuar të cilit nga grupi i punës është konstatuar se gjatë kësaj periudhe janë nxjerrë në tërësi 10 akte;

-Proces-Verbali i datës 10.02.2023 “Mbi verifikimin e akteve të Bashkisë Finiq”, referuar të cilit nga grupi i punës është konstatuar se gjatë kësaj periudhe janë nxjerrë në tërësi 17 akte;

Për vitin 2023, grupi të auditimit i është vënë në dispozicion dokumentacioni përkatësisht për periudhat si vijon:

Për verifikimin e periudhës Janar- Mars 2023:

-Plani i punës i miratuar nga prefekti i qarkut, nr. 547 datë 05.06.2023;

-Raport-Kontrolli, i miratuar nga prefekti i qarkut, nr. 547/1 datë 07.08.2023. Referuar përmbajtjes së këtij raporti, grupi i punës ka arritur në konkluzionin se: “Nuk u konstatuan problematika gjatë procedurës së verifikimit të akteve në vend”;

-Proces-Verbali i datës 07.06.2023 “Mbi verifikimin e akteve të Bashkisë Konispol”, referuar të cilit nga grupi i punës është konstatuar se gjatë kësaj periudhe janë nxjerrë në tërësi 5 akte;

-Proces-Verbali i datës 09.06.2023 “Mbi verifikimin e akteve të Bashkisë Selenicë”, referuar të cilit nga grupi i punës është konstatuar se gjatë kësaj periudhe janë nxjerrë në tërësi 25 akte;

-Proces-Verbali i datës 09.06.2023 “Mbi verifikimin e akteve të Bashkisë Himarë”, referuar të cilit nga grupi i punës është konstatuar se gjatë kësaj periudhe janë nxjerrë në tërësi 12 akte;

-Proces-Verbali i datës 07.06.2023 “Mbi verifikimin e akteve të Bashkisë Delvinë”, referuar të cilit nga grupi i punës është konstatuar se gjatë kësaj periudhe janë nxjerrë në tërësi 7 akte;

-Proces-Verbali i datës 08.06.2023 “Mbi verifikimin e akteve të Bashkisë Sarandë”, referuar të cilit nga grupi i punës është konstatuar se gjatë kësaj periudhe janë nxjerrë në tërësi 43 akte;

-Proces-Verbali i datës 09.06.2023 “Mbi verifikimin e akteve të Qarkut Vlorë”, referuar të cilit nga grupi i punës është konstatuar se gjatë kësaj periudhe janë nxjerrë në tërësi 17 akte;

-Proces-Verbali i datës 08.06.2023 “Mbi verifikimin e akteve të Bashkisë Finiq”, referuar të cilit nga grupi i punës është konstatuar se gjatë kësaj periudhe janë nxjerrë në tërësi 8 akte;

Për verifikimin e periudhës Prill-Qershor 2023:

-Plani i punës i miratuar nga prefekti i qarkut, nr. 720 datë 01.08.2023;

-Raport-Kontrolli, i miratuar nga prefekti i qarkut, nr. 547/2 datë 11.08.2023. Referuar përmbajtjes së këtij raporti, grupi i punës ka arritur në konkluzionin se: “Nuk u konstatuan problematika gjatë procedurës së verifikimit të akteve në vend”;

-Proces-Verbali i datës 07.08.2023 “Mbi verifikimin e akteve të Bashkisë Vlorë”, referuar të cilit nga grupi i punës është konstatuar se gjatë kësaj periudhe janë nxjerrë në tërësi 16 akte;

-Proces-Verbali i datës 04.08.2023 “Mbi verifikimin e akteve të Bashkisë Konispol”, referuar të cilit nga grupi i punës është konstatuar se gjatë kësaj periudhe janë nxjerrë në tërësi 10 akte;

-Proces-Verbali i datës 07.08.2023 “Mbi verifikimin e akteve të Bashkisë Selenicë”, referuar të cilit nga grupi i punës është konstatuar se gjatë kësaj periudhe janë nxjerrë në tërësi 17 akte;

-Proces-Verbali i datës 04.08.2023 “Mbi verifikimin e akteve të Bashkisë Himarë”, referuar të cilit nga grupi i punës është konstatuar se gjatë kësaj periudhe janë nxjerrë në tërësi 13 akte;

-Proces-Verbali i datës 03.08.2023 “Mbi verifikimin e akteve të Bashkisë Delvinë”, referuar të cilit nga grupi i punës është konstatuar se gjatë kësaj periudhe janë nxjerrë në tërësi 10 akte;

-Proces-Verbali i datës 04.08.2023 “Mbi verifikimin e akteve të Bashkisë Sarandë”, referuar të cilit nga grupi i punës është konstatuar se gjatë kësaj periudhe janë nxjerrë në tërësi 64 akte;

-Proces-Verbali i datës 03.08.2023 “Mbi verifikimin e akteve të Bashkisë Finiq”, referuar të cilit nga grupi i punës është konstatuar se gjatë kësaj periudhe janë nxjerrë në tërësi 12 akte;

Për verifikimin e periudhës Korrik-Shtator 2023:

-Plani i punës i miratuar nga prefekti i qarkut, nr. 995 datë 13.11.2023;

-Raport-Kontrolli, i miratuar nga prefekti i qarkut, nr. 1096 datë 29.12.2023. Referuar përmbajtjes së këtij raporti, grupi i punës ka arritur në konkluzionin se: “Nuk u konstatuan problematika gjatë procedurës së verifikimit të akteve në vend”;

-Proces-Verbali i datës 17.11.2023 “Mbi verifikimin e akteve të Bashkisë Vlorë”, referuar të cilit nga grupi i punës është konstatuar se gjatë kësaj periudhe janë nxjerrë në tërësi 35 akte;

-Proces-Verbali i datës 14.11.2023 “Mbi verifikimin e akteve të Bashkisë Konispol”, referuar të cilit nga grupi i punës është konstatuar se gjatë kësaj periudhe janë nxjerrë në tërësi 14 akte;

-Proces-Verbali i datës 01.12.2023 “Mbi verifikimin e akteve të Bashkisë Selenicë”, referuar të cilit nga grupi i punës është konstatuar se gjatë kësaj periudhe janë nxjerrë në tërësi 25 akte;

-Proces-Verbali i datës 15.11.2023 “Mbi verifikimin e akteve të Bashkisë Himarë”, referuar të cilit nga grupi i punës është konstatuar se gjatë kësaj periudhe janë nxjerrë në tërësi 15 akte;

-Proces-Verbali i datës 14.11.2023 “Mbi verifikimin e akteve të Bashkisë Delvinë”, referuar të cilit nga grupi i punës është konstatuar se gjatë kësaj periudhe janë nxjerrë në tërësi 14 akte;

-Proces-Verbali i datës 14.11.2023 “Mbi verifikimin e akteve të Bashkisë Sarandë”, referuar të cilit nga grupi i punës është konstatuar se gjatë kësaj periudhe janë nxjerrë në tërësi 22 akte;

-Proces-Verbali i datës 14.11.2023 “Mbi verifikimin e akteve të Bashkisë Finiq”, referuar të cilit nga grupi i punës është konstatuar se gjatë kësaj periudhe janë nxjerrë në tërësi 21 akte;

Për verifikimin e periudhës Tetor-Dhjetor 2023:

-Plani i punës i miratuar nga prefekti i qarkut, nr. 253 datë 12.03.2024;

-Raport-Kontrolli, i miratuar nga prefekti i qarkut, nr. 297 datë 29.03.2024. Referuar përmbajtjes së këtij raporti, grupi i punës ka arritur në konkluzionin se: “Nuk u konstatuan problematika gjatë procedurës së verifikimit të akteve në vend”;

-Proces-Verbali i datës 13.03.2024 “Mbi verifikimin e akteve të Bashkisë Vlorë”, referuar të cilit nga grupi i punës është konstatuar se gjatë kësaj periudhe janë nxjerrë në tërësi 19 akte;

-Proces-Verbali i datës 13.03.2024 “Mbi verifikimin e akteve të Bashkisë Konispol”, referuar të cilit nga grupi i punës është konstatuar se gjatë kësaj periudhe janë nxjerrë në tërësi 14 akte;

-Proces-Verbali i datës 13.03.2024 “Mbi verifikimin e akteve të Bashkisë Selenicë”, referuar të cilit nga grupi i punës është konstatuar se gjatë kësaj periudhe janë nxjerrë në tërësi 17 akte;

-Proces-Verbali i datës 20.03.2024 “Mbi verifikimin e akteve të Bashkisë Himarë”, referuar të cilit nga grupi i punës është konstatuar se gjatë kësaj periudhe janë nxjerrë në tërësi 18 akte;

-Proces-Verbali i datës 13.03.2024 “Mbi verifikimin e akteve të Bashkisë Delvinë”, referuar të cilit nga grupi i punës është konstatuar se gjatë kësaj periudhe janë nxjerrë në tërësi 14 akte;

-Proces-Verbali i datës 13.03.2024 “Mbi verifikimin e akteve të Bashkisë Sarandë”, referuar të cilit nga grupi i punës është konstatuar se gjatë kësaj periudhe janë nxjerrë në tërësi 34 akte;

-Proces-Verbali i datës 13.03.2024 “Mbi verifikimin e akteve të Bashkisë Finiq”, referuar të cilit nga grupi i punës është konstatuar se gjatë kësaj periudhe janë nxjerrë në tërësi 20 akte;

-Proces-Verbali i datës 13.03.2024 “Mbi verifikimin e akteve të Qarkut Vlorë”, referuar të cilit nga grupi i punës është konstatuar se gjatë kësaj periudhe janë nxjerrë në tërësi 8 akte;

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

-Nga auditimi i procedurës së ndjekur konstatohet se, për aktet e kthyera për rishqyrtim, nuk është kryer kontrolli nga ana e grupit të punës, sa i përket procedurës së ndjekur me këto akte (*dërgimit në afat të aktit në njësitë vendore, regjistrimit ose jo të tyre si dhe arsyen e mos rishqyrtimit të akteve nga njësitë vendore*), në përmbushje kjo të kërkesave të nenit 16 pika 2 germa (b), e ligjit

nr.107/2016 “Për prefektin e Qarkut”, me pasojë kjo në mos monitorimin e procesit dhe mosfunksionimin si duhet të sistemit të kontrollit të procedurës mbi aktet normative;

- Grupi i punës nuk ka kryer një verifikim të plotë mbi dokumentacionet shoqëruese që duhet të përmbajnë vendimet e këshillit të cilat depozitohen pranë Prefektit të Qarkut, siç janë: procesverbalet e dëgjësive publike, në ato raste kur kërkohet nga ligji; relacionet përkatëse që shpjegojnë respektimin e procedurave ligjore; pasqyrat përkatëse (në rastin e vendimmarrjes me karakter financiar) etj.

-Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se, në përfundim të procedurës së kryerjes së verifikimit në vend të akteve, prefekti i qarkut nuk ka dërguar konkluzionet së bashku me rekomandimet përkatëse pranë NJVV-së objekt verifikimi, në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr.1, neni (5) pika 2 (g).

Në përfundim, për sa konstatuar më sipër nga grupi i auditimit, ngarkohet me përgjegjësi: z. O. Z., znj. S. H, znj. I. D, znj. Z. J, në cilësinë punonjësve të sektorit juridik si dhe z. F. M, në cilësinë e Titullarit (ish-prefekt).

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, duke përjashtuar objeksionet e trajtuara nga grupi i auditimit në fazën e akt konstatimeve, nga subjekti i audituar, nuk është paraqitur observacion “Mbi Projekt Raportin e Auditimit”.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE.

1. Gjetje nga auditimi:Nga analiza e kryer në lidhje me respektimin e disiplinës buxhetore në artikuj, n/artikuj për mallra e shërbime gjatë periudhës së audituar rezulton se, fondet e akorduara në planin financiar dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, nuk janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, llogaria dhe nën llogaria sipas shërbimeve, pasi në pesë raste rezultoi mos realizim i fondeve të planifikuara sipas n/llogarive. *Këto veprime nuk janë në përputhje me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, kërkesat e udhëzimit të MF nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” udhëzimit nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, si dhe udhëzimit të MB nr. 459, datë 16.08.2013 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit në sistemin e MB”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 17-30, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi:Prefekti i Qarkut Vlorë, Sektori Financës, të marrë masat e duhura për detajimin e saktë të nevojave për mallra e shërbime që ka institucioni dhe fondet buxhetore për plotësimin e nevojave, të detajuara sipas zërave buxhetor gjatë hartimit për planifikimin e buxhetit dhe të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme realizimin korrekt të fondeve sipas nën zërave buxhetorë.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi:Për periudhën 2022-2023 Institucioni Prefektit (3 ZGJC Vlorë, Sarandë dhe Delvinë) është furnizuar direkt nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile me bazë materiale dhe me certifikata të cilat janë të dokumentuara me hyrje/dalje malli nga sektori financës në Institucionin e Prefektit, por nuk është dokumentuar dhe administruar akti i konfirmimit me Drejtorinë e buxhetit dhe menaxhimin financiar në MB, *veprim i cili nuk është në përputhje të kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 26.06.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe*

Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 17-30, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Prefekti i Qarkut Vlorë, Sektori i Financës, të marrë masat e menjëhershme për të rakorduar me Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimin Financiar në MB duke dokumentuar procesin me mbajtjen e aktit të rakordimit me ZGJC dhe konfirmim marrjen e mallit me Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimin Financiar për materialet e marra pa pagesë nga MB.

Deri në datën 31.12.2024

3. Gjetje nga auditimi: Institucioni i Prefektit të Qarkut Vlorë nuk ka identifikuar dhe hartuar një strategji për menaxhimin e riskut, nuk ka hartuar regjistër risku për gjithë sektorët (vetëm sektori i financës dhe shërbimeve të brendshme), dhe nuk ka regjistër përmbledhës të riskut. Kjo mangësi ka sjellë mungesën e vlerësimit si duhet dhe raportimit të riskut, për rrjedhojë dhe mangësi të aktiviteteve të kontrollit për minimizimin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave të sektorëve, zyrave, veprim i cili nuk është në përputhje me nenin 8, pika “a”, nenin 9, 11 dhe 21, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar dhe manualin e menaxhimin financiar dhe kontrollit. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 17-30, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Prefekti i Qarkut Vlorë, të marrë masat e duhura që, të hartojë dhe miratojë regjistrin e riskut me përgjegjësi për çdo sektor dhe në rang Institucioni dhe të kryhet raportimi hierarkik për funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të sistemit të kontrollit të brendshëm institucional.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Institucioni i Prefektit të Qarkut Vlorë, për veprimtarinë e Emergjencave dhe Mbrojtjes Civile, nuk ka hartuar për vitin 2022 dhe vitin 2023 raport mbi bashkërendimin dhe bashkëpunimin e veprimtarisë me degët territoriale që veprojnë në qark, raport të cilin duhet t’ia paraqiste ministrisë përgjegjëse dhe kryeministrisë, pra Komitetit të Mbrojtjes Civile. Mungojnë gjithashtu raportet periodike të cilat duhet të paraqiteshin në institucionet raportuese dhe Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile. Veprim i cili nuk është në përputhje me Ligjin nr. 45 datë 18.07.2019 “Për Mbrojtjen civile”, nenin 20, Ligjin nr. 107/2016, datë 27.10.2016, “Për Prefektin e Qarkut”, neni 8, pika c, nenin 10 pika 1/d.. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 17-30, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Prefekti i Qarkut Vlorë, Sektori i Emergjencave dhe Mbrojtjes Civile, të marrë masat e duhura që, të hartojë raportet periodikë dhe vjetore dhe t’i dërgojë pranë institucioneve raportuese me qëllim bashkërendimin dhe rritjen e efektivitetit në funksion të misionit dhe përmbushjes së detyrave institucionale.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të procedurave të blerjeve me vlera të vogla konstatohet se: Nga titullari i Autoritetit Kontraktor nuk është caktuar person përgjegjës për prokurimet i cili administron në mënyrë të vazhdueshme procesin dhe procedurat e prokurimit që kryhen nga institucioni i Prefektit të Qarkut Vlorë, në cilësinë e personit përgjegjës për menaxhimin e fondeve. Veprim i cili nuk është në përputhje me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 21, pikat 2 dhe 4, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenin 74, pika 1.

-Në 6 procedura prokurimi për periudhën 01.01.2022-31.12.2022 dhe në 14 procedura për periudhën 01.01.2023-31.12.2023, është caktuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, Prefekti i

Qarkut Vlorë, zj. L. S si Kryetare e komisionit të procedurave blerje me vlerë të vogël, e cila është me pozicion pune Përgjegjëse e Sektorit të Financës në cilësinë e nëpunësit zbatues. Zj. S. kryen kontrollin pas faktit bazuar në dokumentacionin mbështetës për kryerjen e një transaksioni financiar. Pra veprimtaria e kontrollit pas faktit nuk duhet të kryhet nga persona të cilët kanë marrë pjesë në kontrollin para faktit, e cila është njëkohësisht dhe anëtar dhe sekretar i Grupit të Menaxhimit Strategjik të institucionit. Çdo urdhër i titullarit për caktimin e në komisione të nëpunësit zbatues i cili bie ndesh me veprimtarinë, duhet të refuzohet nga ky i fundit, gjë e cila nuk rezulton të jetë kundërshtuar në asnjë rast. *Veprime të cilat nuk janë në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 4, pikat 16, 17 e 18, neni 12, pika 3, gërma e), neni 22, pika 5, Rregulloren e brendshme TIP të Prefektit të Qarkut Vlorë miratuar me urdhrin nr. 175, datë 09.07.2020 nga Ministri i Brendshëm, dërguar me shkresën nr. 3825/2prot, datë 16.07.2020, administruar nga PFV me praktikën nr. 763prot, datë 20.07.2020, neni 14 pika i. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 31-36, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1. Rekomandimi: Institucioni i Prefektit të Qarkut Vlorë, të marrë masat e duhura që:

a- Të caktojë personin përgjegjës për prokurimet me qëllim përmirësimin në planifikimin e nevojave, rritjen e efikasitetit dhe efikasitetit në procedurat e prokurimit publik.

b- Të krijojë komisionet e blerjeve me vlera të vogla, duke shmangur konfliktin e interesit me anëtarë, në përputhje me kuadrin ligjor të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të procedurave të blerjeve me vlera të vogla konstatohet se: Në 3 procedura prokurimi rezulton të jenë shmangur zhvillimi i procedurave standard të prokurimit blerje me vlerë të vogël me shpallje në buletin e APP dhe nuk janë kryer nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimeve, duke copëzuar fondet dhe duke kryer me procedura blerje me vlera të vogla në mënyrë shkrese sipas modelit për shpenzimet deri në 100,000 lekë. Nga sa më sipër rezulton se të dhënat e regjistrit të parashikimeve të miratuara nga Titullari i Autoritetit kontraktor, nuk janë siguruar në mënyrë të tillë që, të analizoheshin sipas nevojave të paraqitura, me qëllim shmangien e copëzimit të fondeve për grup mallrat/shërbimet e ngjashme dhe kryerjen e tyre me procedura të rregullta konkurruese sipas kufijve monetarë. Pra nëse do të përlllogariteshin drejtë nga personat përgjegjës të prokurimeve të dhënat e administruara, procedurat e blerjeve me vlera të vogla ku natyra dhe sasia e planifikuar kanë të njëjtin funksion apo të ngjashëm këto procedura do të kryheshin me procedura normale prokurimi nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimeve. Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenin 11, pika 5, neni 12, “Metoda të zbatueshme në përlllogaritjen e vlerës së kontratës, pika 3, nenin 56, pika 2 paragrafi i II-të, Udhëzimin nr. 05, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, pika 3, Nenin 74 “Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit”, pika 3. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 31-36, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandimi: Institucioni i Prefektit të Qarkut Vlorë, Sektori i Prokurimeve të marrë masat e duhura, në hartimin e regjistrave të prokurimit dhe të analizojnë dhe grupojë emërtimin e procedurave, me qëllim shmangien e copëzimit të fondeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se, në 14 (katërbëdhjetë) raste të audituara për procedurat e prokurimit të zhvilluara në vitet 2022-2023, nga Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël, në cilësinë e KVO-së nuk janë plotësuar deklaratat mbi konfliktin e interesave, mosveprim i cili bie në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 13, pika 5, si dhe neni 73, pika 4. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 31-36, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandimi: Çdo anëtar i Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël, në cilësinë e KVO-së, në çdo rastapo për çdo procedurë që do të zhvillojë në vijim, në momentin e hapjes së ofertave dhe pas njohjes/verifikimit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në garë, duhet të nënshkruajë një deklaratë përmes së cilës deklaron se nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit me ofertuesit pjesëmarrës.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Për periudhën 2022-2023, nga bashkitë dhe Këshilli i Qarkut Vlorë, janë përcjellë për vlerësim pranë Prefektit të Qarkut Vlorë 793 vendime, nga të cilat rezulton se 778 janë konfirmuar si në përputhje me kuadrin rregullator. Nga auditimi i dokumentacionit të 93 vendimeve të konfirmuara me vlerësim pozitiv për ligjshmërinë, në 60 raste, Vendimet e Këshillit Bashkiak kanë bashkëlidhur projekt-vendimin si dhe relacionin përkatës por nuk dokumentohet që të jenë shoqëruar me procesverbalin e mbledhjes, në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut” aneksi nr.1, neni 4, pika b. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 37-65, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1. Rekomandimi: Prefekti i Qarkut Vlorë, në të ardhmen, të japë vlerësim pozitiv për ligjshmërinë e vendimeve të dërguara nga Këshillat Bashkiakë vetëm pasi të sigurojë dhe konkludojë se këta të fundit janë të shoqëruar me: Procesverbalin e mbledhjes së këshillit; Procesverbalin e dëgjësës publike, në ato raste kur kërkohet nga ligji; Relacioni përkatës që shpjegon respektimin e procedurës ligjore; Projektvendim; Certifikatën e pronësisë në mungesë të saj statusin juridik nga ASHK-ja (në vendimmarrjet e pronave), plan vendosjet; Pasqyrat përkatëse (në rastin e vendimmarrjes me karakter financiar); Dokumentacionin përkatës sipas standardit të kërkuar (në rastin e vendimmarrjes për emergjencat civile), etj.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Për periudhën 2022-2023, nga bashkitë dhe Këshilli i Qarkut Vlorë, janë përcjellë për vlerësim pranë Prefektit të Qarkut Vlorë 793 vendime, nga të cilat rezulton se 778 janë konfirmuar si në përputhje me kuadrin rregullator. Nga auditimi i dokumentacionit të 93 vendimeve të konfirmuara me vlerësim pozitiv për ligjshmërinë, në 28 raste, rezulton se janë vendime me karakter individual dhe jo normativ. Në këto raste, Prefekti i Qarkut Vlorë ka vlerësuar dhe dhënë vlerësim pozitiv për ligjshmërinë e vendimeve në mungesë të kompetencës, për sa kohë neni 16 dhe 17 i ligjit nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i njeh institucionit të Prefektit kompetencën për vlerësimin e ligjshmërisë vetëm për aktet me karakter normativ. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 37-65, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1. Rekomandimi: Prefekti i Qarkut Vlorë, në të ardhmen, të japë vlerësim pozitiv për ligjshmërinë e vendimeve të dërguara nga Këshillat Bashkiakë, vetëm pasi të sigurojë dhe konkludojë se këta të fundit janë akte me karakter normativ dhe jo individual, në përputhje me nenin 3 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Për periudhën 2022-2023, nga bashkitë dhe Këshilli i Qarkut Vlorë, janë përcjellë për vlerësim pranë Prefektit të Qarkut Vlorë 793 vendime, nga të cilat rezulton se 778 janë konfirmuar si në përputhje me kuadrin rregullator. Nga auditimi i dokumentacionit të 93 vendimeve të konfirmuara me vlerësim pozitiv për ligjshmërinë, **në 9 raste**, rezulton se, Prefekti i Qarkut Vlorë nuk ka vlerësuar paraprakisht nëse vendimet e këshillave bashkiakë janë në përputhje me nenin 91, pika 4 e Kodit Zgjedhor. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 37-65, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1. Rekomandimi: Prefekti i Qarkut Vlorë të marrë masa që për periudhën 4 muaj para zgjedhjeve, si dhe gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, të përfshijë si kriter vlerësimi të ligjshmërisë, së vendimeve, urdhrave dhe urdhërësive me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore, përcaktimet e nenit 91, pika 4 e Kodit Zgjedhor, me qëllim shmangien e vendimmarrjeve që bien ndesh me këto përcaktime, përgjatë periudhave zgjedhore.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Për periudhën 2022-2023, nga bashkitë dhe Këshilli i Qarkut Vlorë, janë përcjellë për vlerësim pranë Prefektit të Qarkut Vlorë 793 vendime, nga të cilat rezulton se 778 janë konfirmuar si në përputhje me kuadrin rregullator. Nga auditimi i dokumentacionit të 93 vendimeve të konfirmuara, **në 3 raste**, rezulton se, Prefekti i Qarkut Vlorë ka dhënë vlerësim pozitiv për ligjshmërinë e vendimeve kur këta të fundit rezultojnë në kundërshtim me ligjin material, në mospërputhje me nenin 109 “Paligjshmëria e aktit administrativ” të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 37-65, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1. Rekomandimi: Prefekti i Qarkut Vlorë, në të ardhmen, të japë vlerësim pozitiv për ligjshmërinë e vendimeve të dërguara nga Këshillat Bashkiakë vetëm pasi të sigurojë dhe konkludojë se këta të fundit, duke i vlerësuar rast pas rasti, nuk janë në kundërshtim me ligjin material, në mospërputhje me nenin 109 “Paligjshmëria e aktit administrativ” të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”.

Menjëherë dhe në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi është konstatuar se, pranë institucionit të Prefektit të Qarkut Vlorë nuk ka një regjistër shkresor apo elektronik në të cilin të pasqyrohet në mënyrë të detajuar periodike apo të përgjithshme aktiviteti i prefektit në funksion të verifikimit të ligjshmërisë së akteve, në mospërputhje me nenin 19 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 37-65, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1. Rekomandimi: Prefekti i Qarkut Vlorë, të krijojë një regjistër shkresor apo elektronik në të cilin të pasqyrohet në mënyrë të detajuar periodike apo të përgjithshme aktiviteti i prefektit në funksion të verifikimit të ligjshmërisë së akteve. Regjistri duhet të ketë në përbërjen e tij të gjithë elementët bazë me anë të të cilëve të sigurohet dokumentimi i të gjitha veprimtarive dhe gjurma e duhur e auditimit për vijueshmërinë dhe monitorimin.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi verifikimin e ligjshmërisë së akteve me karakter normativ drejtpërdrejt dhe sistematikisht në organin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, në zbatim

të nenit 17 të ligjit nr. 107/2016, “Për Prefektin e Qarkut”, për vitet 2022-2023 është konstatuar se:

-Për aktet e kthyera për rishqyrtim, nuk është kryer kontrolli nga ana e grupit të punës, sa i përket procedurës së ndjekur me këto akte (dërgimit në afat të aktit në njësitë vendore, regjistrimit ose jo të tyre si dhe arsyen e mos rishqyrtimit të akteve nga njësitë vendore), në përmbushje kjo të kërkesave të nenit 16 pika 2 germa (b), e ligjit nr.107/2016 “Për prefektin e Qarkut”;

-Grupi i punës nuk ka dokumentuar kryerjen e verifikimit mbi dokumentacionet shoqëruese që duhet të përmbajnë vendimet e këshillit të cilat depozitohen pranë Prefektit të Qarkut, siç janë: procesverbalet e dëgjësive publike, në ato raste kur kërkohet nga ligji; relacionet përkatëse që shpjegojnë respektimin e procedurave ligjore; pasqyrat përkatëse (në rastin e vendimmarrjes me karakter financiar) etj.

-Në përfundim të procedurës së kryerjes së verifikimit në vend të akteve, prefekti i qarkut nuk ka dërguar konkluzionet së bashku me rekomandimet përkatëse pranë NJVV-së objekt verifikimi, në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr.1, neni (5) pika 2 (g). (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 37-65, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1. Rekomandimi: Prefekti i Qarkut Vlorë, të verifikojë ligjshmërinë e akteve me karakter normativ drejtpërdrejt dhe sistematikisht në organin e njësisë së vetëqeverisjes vendore jo më pak se një herë në 3 muaj. Në përfundim të procedurës së kryerjes së verifikimit në vend të akteve dhe dokumentimit të saj, prefekti i qarkut të dërgojë konkluzionet së bashku me rekomandimet përkatëse pranë NJVV-së objekt verifikimi.

Menjëherë dhe në vijimësi

B. MASA DISIPLINORE.

Mbështetur në nenin 15 të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neneve, 57, 58, 59 të Ligjit nr. 152/2013 datë 17.10.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Kreut II, pika 2 të VKM nr. 115 datë 05.03.2015 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil”, të ndryshuar, **i rekomandojmë Prefektit të Qarkut Vlorë**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, për periudhën 01.01.2022 deri më 31.12.2023, si dhe të fillojnë procedurat për dhënien e masave, për **5 (pesë)** punonjësit, si më poshtë:

a) Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet, germa (c) neni 58.

1. **Z. O. Z.**, me detyrë Përgjegjës i Sektorit Juridik.
2. **Znj. S. H.**, me detyrë Specialiste në Sektorin Juridik.
3. **Znj. I. D.**, me detyrë Specialiste në Sektorin Juridik.
4. **Znj. Z. J.**, me detyrë Specialiste në Sektorin Juridik.
5. **Znj. L. S.**, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Financës.

-Në lidhje me punonjësit e sektorit juridik, për mangësitë dhe parregullsitë e konstatuara gjatë procedurës së verifikimit të ligjshmërisë së akteve normative dhe mungesës së administrimit të

dokumentacionit tekniko ligjor për verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore, në kundërshtim me germën (a) neni 8 dhe neni 16 të Ligjit nr. 107/2016, datë 27.10.2016 “Për Prefektin”, trajtuar gjerësisht në faqet 37-65, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

-Në lidhje me Përgjegjësen e Sektorit të Financës, për mangësitë dhe parregullsitë e konstatuara në cilësinë e nëpunësit zbatues në hartimin, miratimin dhe zbatimin e buxhetit, planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit, trajtuar gjerësisht në faqet 17-36, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

B/1. Për të gjithë punonjësit e tjerë, të cilët janë trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për të cilët nga KLSH-ja nuk është rekomanduar dhënia e masës disiplinore konkrete, pasi shkeljet e konstatuara dhe të evidentuara janë nën materialitetin e përcaktuar nga grupi i të Auditimit, **lihet në kompetencë dhe vlerësim të Prefektit të Qarkut Vlorë**, fillimi ose jo të procedurave disiplinore në referim të Ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” dhe VKM nr. 115, datë 05.3.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil” dhe shkronja “e” dhe “ç” të nenit 11, kreun IV, dhe nenin 37 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, bazuar në kontratën individuale të punës.

B.2. Mbështetur në nenin 15 të Ligjit nr. 154 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 5 të Ligjit nr. 107, datë 27.10.2016 “Për Prefektin” dhe Urdhrin nr.175 datë 09.07.2020 të Ministrisë të Brendshme “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Prefektit të Qarkut si dhe aneksin i të rregullave për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut”, **i rekomandojmë Ministrinë të Brendshme**, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për ish-Prefektin e Qarkut Vlorë **Z. F. M.**, për mangësitë dhe parregullsitë e konstatuara gjatë procedurës së verifikimit të ligjshmërisë së akteve normative dhe mungesës së administrimit të dokumentacionit tekniko ligjor për verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore, në zbatim të germa (a) nenit 8 dhe neni 16 të Ligjit nr. 107, datë 27.10.2016 “Për Prefektin”, trajtuar gjerësisht në faqet 17 - 65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

V. ANEKSET

Aneksi nr. 1

- Materialiteti dhe faktorët e riskut për subjektin Prefektura Qarku Vlorë.

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal nivelin të devijimit që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 1% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar. Nën gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës ka ulur gamën e gabimeve për tu konsideruar, duke marrë në konsideratë pragun e materialitetit prej 1%, pasi gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është konkluduar që sistemet e kontrollit të brendshëm kanë risk të ulët. Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti dhe verifikimin e tyre me evidencat periodike me Thesarin, si dhe dokumentacionin shoqërues (praktikën e urdhër transfertave).

Konkretisht, mbi transaksionet u aplikuan:

- teste të kontrolleve për të verifikuar se si kanë funksionuar sistemet e kontrollit të brendshëm (trajtuar gjerësisht në pikën e programit mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin); dhe
- teste të detajeve.

Nën gjykimin profesional të Audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë dy elementë:

- ✓ Risku i lidhur me shpenzimin specifik, nga ku nën gjykimin profesional të audituesit niveli i riskut për shpenzime që lidhen me llogaritë u vlerësua nga 0.7 deri 2; dhe
 - ✓ Pesha specifike që ky zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.
- Për të përzgjedhur minimumin e çështjeve për auditim, mbi këta zëra shpenzimesh, u aplikuan format e përlllogaritjes si më poshtë:

Prefektura Vlorë 2022-2023			
Emërtimi i Shpenzimeve	Vlera e Popullatës	Faktori i Riskut (mund të jetë 0.7 ose 2 ose 3)	Çështje për tu shqyrtuar
Paga 600	51.054	0,7	30
Sigurime shoqërore 601	8.441	0,7	5
Shp. Operat 602	12.116	0,7	7
Transferta Korrente të brendshme 604	-	-	0
Transferta për familje dhe individe 606	563	-	0
Investime 230-231	997	2,0	2
Total	73.171		
Materialiteti në %	0		
Materialiteti në vlerë	1.463		
Kalkulimi i precizionit			
Materialiteti	1.463		
Gabimi i lejuar (10% - 20%)	146		
Nëntotali	1.317		
Precizioni i planifikuar (80-90%)	1		
Vlera e precizionit	1.185		

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

GRUPI I AUDITIMIT

1. **K.T. , përgjegjës i grupit të auditimit.**
2. **E. M. , auditues.**

DREJTORI I DEPARTAMENTIT

J. T.

